



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Inxhinieri  
Tekstile e Modë”  
i  
Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i  
Tiranës”**

### Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Silvana Nini

2. Dr. Dorina Arapi

Dhjetor 2022

## TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

**Për programin e studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Tekstile e Modë”  
ofruar nga Insitucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti Politeknik i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Tekstil dhe Modë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në “Inxhinieri Tekstile e Modë”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	Shkresë MASH Nr. 1583/1 Prot, datë 12.05.2006
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 214, datë 12.05.2021
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i parë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite (6 semestra)
10	Kreditet në total (ECTS):	180 kredite
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	10 PAE/ 5 PAK
18	Numri i studentëve: (3 vitet e fundit akademike)	174 Student
19	Komente / të tjera:	-

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në “**Inxhinieri Tekstile e Modë**”, është hapur me Shkresë MASH Nr. 1583/1 Prot, datë 12.05.2006 (për miratimin e diplomave).

Programi ofrohet nga Departamenti Tekstil dhe Modë, njësi e Fakultetit Inxhinieri Mekanike, dhe është riemërtuar me vendim Senati nr. 13 më datë 4 maj 2005 dhe është miratuar me Shkresë MASH Nr. 1583/1 Prot, datë 12.05.2006 (për miratimin e diplomave).

Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Modë, realizohet dhe drejtohet nga departamenti i Tekstilit dhe Modës, FIM, UPT në tre vite, në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, dhe në total ka 180 ECTS, prej të cilave 36 ECTS Disiplina të formimit të përgjithshëm, 96 ECTS- Disiplina të formimit karakterizues.

Studimet në këtë program përmbajnë bazat e nevojshme shkencore, si dhe aftësinë metodike të një kualifikimi të mundshëm profesional në fushën e inxhinierisë tekstile dhe në stilim dhe modë. Te diplomuarit kanë aftësi për t'u punësuar në zbatimin e projekteve inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve inxhinierike tekstile, në projektimin dizenjimin dhe stilimin e veshjeve, si në kompanitë e prodhimit të veshjeve në vend, atelie të punësuar ose vetëpunësuar, në çdo institucion shtetëror sipas fushës së ekspertizës.

Takimet me dekanin dhe stafin akademik të programeve, stafin ndihmës akademik dhe studentët, dhanë një panoramë të qartë mbi punën, rezultatet dhe pritshmëritë dhe një vizion të qartë mbi këtë program studimi.

## **Përshkrimi i procesit të vlerësimit të jashtëm;**

Mbas aplikimit për nisjen e procedurës së akreditimit të programit "**Inxhinieri Tekstile e Modë**", të Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Urdhërit nga ASCAL për kryerjen e vlerësimit të këtij programi studimi u përcaktuan edhe ekspertët e vlerësimit të jashtëm :

- 1) Dr. Silvana Nini
- 2) Dr. Dorina Arapi

Fazat e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programit të studimit "**Inxhinieri Tekstile e Modë**" janë paraqitur si më poshtë:


Grupi i punës së vlerësimit të jashtëm bëri vlerësimin mbi bazë dokumentacioni të paraqitur nga Institucioni aplikues, Universitetit Politeknik të Tiranës. Aprovimi i agjendës së vizitës në IAL u bë ndërmjet dy anëtarëve të Grupit të Vlerësimit të jashtëm dhe koordinatores teknike të ASCAL. Vizita në institucion u krye në datat 25 korrik 2022, sipas përcaktimit në agjendë. Grupi i vlerësimit të jashtëm realizoi me përpikmëri takimet e caktuara sipas agjendës. Më datë 25 korrik 2022 u realizuan këto takime:

- Takimi me Dekanin e Fakultetit Inxhinieri Mekanike
- Përgjegjësën e Departamentit të **Inxhinieri Tekstile e Modë**;
- Takimi me Grupin e vetëvlerësimit;
- Takimi me Përfaqësues të Drejtorisë të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë
- Takimi me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi (të brendshëm dhe të jashtëm);
- Takimi me studentët e këtij program studimi;
- Takimi me përfaqësues të zyrës së këshillimit të karrierës dhe kujdesit ndaj studentit;
- Vizitë në sekretarinë mësimore;
- Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) Vizitë në Bibliotekë;
- Takimi përmbyllës me Përgjegjësën e Departamentit;

Më datë 30/11/2022, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 186/40 Prot., datë 30/11/2022, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

UPT kthehu përgjigje, përmes AMS, më datë 19/12/2022 dhe me shkresë zyrtare Nr. 2903/1 Prot., datë 19/12/2022.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



## Vlerësimi i programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Inxhinieri Tekstile e Modë”

### I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	<p>Departamenti Inxhinieri Tekstile e Modë është njësi bazë që zhvillon programin e studimit Bsc Inxhinieri Testile e Modë, dhe është një nga deaprtamentet e fakultetit Inxhinieri Mekanike, pjesë e institucionit shtetëror i arsimit të lartë, Universiteti Politeknik i Tiranës, që organizon studime universitare të ciklit të parë, të dytë e të tretë. UPT është një institucion autonom që kryen veprimtari të pavarura akademike, administrative, ekonomike dhe të menaxhimit financiar bazuar mbi parimin e vetëqeverisjes, lirisë akademike dhe të përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligi për Arsimin e Lartë dhe Statuti i Universitetit.</p> <p>Programi i studimit BA Inxhinieri Tekstile e Modë është në përputhje me prioritetet e strategjinë e shtetit shqiptar mbi arsimin dhe kulturën dhe i përmbahet një misioni të bazuar në synime, objektiva dhe vlera mbështetëse kombëtare.</p> <p><b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b> <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b> <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b> <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b> <a href="https://www.fim.edu.al/fim">https://www.fim.edu.al/fim</a> <a href="https://www.fim.edu.al/fim/departamenti-i-tekstilit-dhe-modes">https://www.fim.edu.al/fim/departamenti-i-tekstilit-dhe-modes</a> <a href="https://upt.al/">https://upt.al/</a></p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Objektivat e programit BA Inxhinieri Tekstile e Modë përputhen me kërkesat për arsimin e lartë të Republikës së Shqipërisë. Rezultatet e të nxënit të programit janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara për ciklin e parë të studimit bachelor. Objektivat e përcaktuara në programin e studimit lidhen drejtpërdrejtë dhe përshtaten me objektit e departamentit dhe të fakultetit. Rezultatet e të nxënit gjithashtu korrespondojnë me kornizat evropiane dhe kombëtare të kualifikimeve. Programi 3 vjeçar i studimit Bsc Inxhinieri Tekstile e Modë është zhvilluar duke pasur parasysh objektivat e Kartës së Bolonjës.</p> <p>Zhvillimi dhe përmirësimi i programit Inxhinieri Tekstile e Modë merr parasysh situatën aktuale të sektorit e tekstit dhe modës në Shqipërisë, si një fushë e gjerë e kulturës, dhe artizanatit dhe pjesë e traditës shqiptare. Integrimi i traditës përmes risive bashkëkohore teknologjike të tekstit vlerësohet inkurajohet më tej në këtë program studimi. Programi i studimit Inxhinieri Tekstile e Modë është në përputhje me prioritetet e shtetit shqiptar, ku kultura e arsimit janë ndër burimet më të rëndësishme të shtetit shqiptar. Bashkëpunimi me partnerët dhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 5

	<p>institucione të tjera homologe janë pjesë e rëndësishme e këtij departamenti.</p> <p>Studimet e Bachelor përmbajnë bazat e nevojshme shkencore, si dhe aftësinë metodike të një kualifikimi të mundshëm profesional në fushën e inxhinierisë tekstile dhe në stilim dhe modë. Te diplomuarit kane aftësi për tu punësuar ne zbatimin e projekteve inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar te sistemeve inxhinierike tekstile, ne projektim dizenjimin dhe stilimin e veshjeve, si në kompanitë e prodhimit te veshjeve ne vend, atelie të punësuar ose vetëpunësuar, në çdo institucion shtetëror sipas fushës se ekspertizës.</p> <p>Të diplomuarit Bachelor në “Inxhinieri Tekstile e Modë” kanë aftësi për tu punësuar në zbatimin e projekteve inxhinierike, mirembajtjen dhe kontrollin e asistuar te sistemeve inxhinierike tekstile, në projektim të asistuar, dizenjim, projektim dhe stilim veshjesh etj.</p> <p><b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>  <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08Rregullorja e program te studimit.</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/media/211016222609X68807443LAX79.pdf">https://www.fim.edu.al/media/211016222609X68807443LAX79.pdf</a>  <a href="https://upt.al/">https://upt.al/</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Programi i studimit BA Inxhinieri Tekstile e Modë është hartuar dhe zbatohet në përputhje me qëllimet e krijimit dhe misionin e institucionit, duke evidentuar një ndër tiparet më përfaqësuese të këtij universiteti, përsa i përket performancës dhe veprimtarisë shumëplanëshe universitare.</p> <p>Bazuar në statutin e universitetit, misionin dhe objektivat institucionale, UPT synon dhe është gjithmonë në përmirësim që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve, si edhe të formojë specialistë të lartë dhe të përgatitë shkencëtarë të rinj;</li> <li>-të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;</li> <li>-të kontribuojë në rritjen e standardeve arsimit në shoqërinë shqiptare dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.</li> </ul> <p>Programi ofron dhe siguron një mjedis të veçantë mësimor që mbështet komunikimin ndërdisiplinor të tekstitit dhe modës, duke nxitur zhvillimin e vlerave profesionale. Ky program studimi plotëson dhe konform ofertës akademike të Universitetit Politeknik të Tiranës, dhe është i hartuar duke u bazuar në modelet më të përditësuara kombëtare dhe ndërkombëtare akademike, për ata studentë që duan të studiojnë në këtë fushë, dhe dëshirojnë të zhvillojnë me tej karrierën e tyre në përputhje me sfidat e tregut ndërkombëtar.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08Rregullorja e program te studimit.</b>  <b>Ref. 1.09 Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstile e mode.</b></p>

	<a href="https://www.fim.edu.al/media/211014105045X50863746LAX79.pdf">https://www.fim.edu.al/media/211014105045X50863746LAX79.pdf</a>			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Zhvillimi dhe përmirësimi i programit Inxhinieri Tekstile e Modë merr parasysh situatën aktuale të sektorit e tekstitit dhe modës në Shqipërisë, si një fushë e gjerë e kulturës, dhe artizanatit dhe pjesë e traditës shqiptare. Integrimi i traditës përmes risive bashkëkohore teknologjike të tekstitit vlerësohet inkurajohet më tej në këtë program studimi. Programi i studimit Inxhinieri Tekstile e Modë është në përputhje me prioritetet e politikave arsimore të shtetit shqiptar, ku arsimit mbetet një nga pikat më të rëndësishme në zhvillimin e shoqërisë. Bashkëpunimi me partnerët dhe institucione të tjera homologe janë pjesë e rëndësishme e këtij departamenti.</p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b>  <b>Ref. 1.09 Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstile e mode.</b>  <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT.</b>  <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><a href="https://www.fim.edu.al/media/211014105045X50863746LAX79.pdf">https://www.fim.edu.al/media/211014105045X50863746LAX79.pdf</a></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	<p>Programi i studimit Inxhinieri Tekstile e Modë, është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të universitetit, të përcaktuara në statutin dhe rregulloren e tij, duke u bazuar gjithashtu dhe në vizionin, prioritetet dhe objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik. Departamenti e zhvillon programin konform standardeve kombëtare dhe Evropiane, duke e orientuar atë drejt kërkesave të tregut të punës. Duke ecur në bazë të Planit strategjik të UPT, programi zhvillon aftësive teorike e shkencore, si dhe ato praktike të studentëve, duke nxitur dhe mbështetur studentët në partneritet të plotë me biznesin, si në kontekstin shqiptar, e po atë dhe ndërkombëtar, si dhe duke synuar përparimim e arsimit të lartë.</p> <p>UPT e ofron këtë program studimi konform Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve, duke përcaktuar karakteristikat dhe përmbajtjen e programeve të studimit, duke impaktuar në sistemin formues- edukativ përmes modeleve tradicionalë dhe atyre të rinj bashkëkohorë.</p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b>  <b>Ref. 1.09 Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstile e mode.</b>  <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b></p>

	<p><b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT.</b>  <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/info/bachelor">https://www.fim.edu.al/info/bachelor</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimet prioritare akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Programi i studimit ofron zhvillimin e qendrueshëm të metodave në mësimdhënie duke mbështetur në teknologjitë e reja dhe zhvillimit dhe u krijuar mundësitë që studenti të përshtatet me nevojat e tregut të punës, si dhe për t'u zhvilluar profesionalisht në përputhje me to.</p> <p>UPT synon fuqizimin e nismave mbështetëse për të ndihmuar suksesin profesional dhe futjen e të diplomuarve në tregun e punës. Gjithashtu në bazë të misionit dhe planit strategjik të institucionit, departamenti që ofron këtë program studimi, organizon module të veçanta për forcimin e aftësive dhe të njohurive të studentëve për të lehtësuar futjen e tyre në tregun e punës, si dhe mbështjetjen për studentët për çdo nismë që çon në lehtësimin e punësimit të tyre. Një vlerë e shtuar e institucionit janë dhe praktikat profesionale, mobiliteti i studentëve dhe organizimi i panairëve të punës, në të cilët të inkurajohen kontaktet punëdhënës-punëmarrës për të lehtësuar futjen në tregun e punës të të sapodiplomuarve.</p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b>  <b>Ref. 1.09 Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstile e mode.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimet akademike të institucionit.</p>	<p>Programi i studimit BSc në Inxhinieri Tekstile e Modë e ka këtë emërtim sipas shkresës së Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, dhe organizohet e strukturohet sipas rregullores së UPT dhe rregullores së programit të studimit.</p> <p>Programi i studimit BSc në Inxhinieri Tekstile e Modë është organizuar në përputhje me statutin e UPT sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve LIGJ Nr.10 247, datë 4.3.2010, <i>Per Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve</i>. Organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimi, në DTM bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS).</p> <p>Bazuar në ligjin nr. 80/2015 <i>“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”</i>, si dhe Statutin e UPT, FIM është njësi kryesore e UPT, dhe mbulon fushat didaktike dhe shkencore të inxhinierisë mekanike, materiale, të tekstilit ose të ndërthurura inxhinierike (si inxhinieria ekonomike).</p> <p>Departamentet e FIM janë njësi bazë të zhvillimit të mësimdhënies dhe të punës kërkimore-shkencore të këtij fakulteti. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të Departamenteve të FIM bazohet në përcaktimet ligjore (Ligji 80/2015 Neni 25), në SUPT (Neni 5-2), përcaktimet e kësaj rregulloreje dhe të dokumenteve të tjera në nivel Universiteti dhe Fakulteti. Mënyra e funksionimit të departamenteve përcaktohet në rregulloren e brendshme të tyre.</p> <p>FIM përbëhet nga 4 (katër) departamente të cilat janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Prodhimit dhe Menaxhimit</li> </ul>

*Nony*

*[Signature]*



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Departamenti i Mekanikës</li> <li>• Departamenti i Energjitikës</li> <li>• Departamenti i Tekstilit dhe Modës</li> </ul> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b>  <b>Ref. 1.09 Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstile e mode.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/info/bachelor">https://www.fim.edu.al/info/bachelor</a></p>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi I.3

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.</p>	<p>Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formim në Inxhinieri Tekstile e Modë, për arritjen e objektivave, me qëllim që kjo diplomë të targetojë kualifikimin e punësimit në fushat përkatëse. Nëpërmjet kërkimit shkencor dhe shërbimeve te ndryshme që i ofrohen studentëve, programi targeton të formojë specialistë në fushën e dizenjimit, teknologjisë, prodhimit të materialeve tekstile dhe veshjeve, gjë që ndikon dhe impakton në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal në fushat e teknologjisë së prodhimit të materialeve tekstile dhe lekures, veshjeve e kepuceve, ngjyrimit e përbarimit kimik, dizenjimit e Modelimit. Per te garantuar dijet, aftesite dhe kompetencat profesionale te studenteve, programi Inxhinieri Teksili dhe Modë, ecën sipas objektivave te percaktuara në rregulloren e programit te studimit, rregulloren e DTM dhe syllabuset e disiplinave. Çdo syllabus i lendeve te programit ka të përcaktuar konceptet themelore e aftesite me cilat pajiset studenti, si dhe objektiva e lendes.</p> <p><b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit te studimit BSc ne Inxhinieri Tekstili e Modë.</b>  <b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>  <b>Ref. 1.09: Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstili e Modë</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat</p>	<p>Ne fushën e inxhinierise se tekstilit dhe Modës, tregu aktual i punes është marrë në konsideratë qe prej fillimit të emërimit te departamentit të inxhinierise se Tekstilit dhe Modës, për më tepër të traditës të tekstilit, historisë së prodhimit të tekstilit në vendin tonë.</p> <p>DTM, ndjek mbarëvajtjen e studentëve te tij pas diplomimit ne BSc ne Inxhinieri Tekstile e Modë, duke lidhur bashkëpunime midis kompanive që operojne ne tregun e punës. Një nga çështjet e rëndësishme, pjesë e informacionit që institucioni përgatit për të informuar studentët e programit të studimit BSc në Inxhinieri Tekstili se Modë, është edhe mundësia e punësimit si dhe orientimi drejt tregut të punës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 9

<p>dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Një pikë e fortë e institucionit UPT/FIM është bashkëpunimi me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet. Këto bashkëpunime mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara duke filluar që nga viti 2016, të cilat shërbejnë për të bërë të mundur realizimin e praktikave mësimore të studentëve, duke e parë këtë edhe si një mundësi punësimi pas mbarimit të studimeve. Në panairin e punës, të organizuar nga UPT, shumë kompani pjesëmarrëse kanë shprehur interes për bashkëpunim në lidhje me praktikën profesionale dhe punësimin. Panairi të tjerë, ku UPT ka qenë pjesëmarrëse, janë edhe “work and study” 2020, i organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe e Industrisë dhe në panairin e Ndërtimit, Arkitekturës dhe Planifikimit Urban 2018.</p> <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, institucioni ka hulumtuar mbi tregun punës që në fillimet e tij, në bazë të panairëve të punës apo bashkëpunimeve me institucione të ndryshme, por jo në mënyrë specifike, gjë që është paraqitur dhe në pikat e dobëta të programit. Mos ndjekja e tregut të punës dhe e tendencës së zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, rajon e më gjerë, në bazë të një njësie të vecantë dhe mos reflektimi i ndryshimeve në filozofinë, strategjinë, menaxhimin e institucionit, kurrikulat, programet e lëndëve, dhe gjithë dokumentacionin ku mbështetet veprimtaria e departamentit dhe FIM, krijon vështirësi në zhvillimin e mëtejshëm të institucionit. Nisur nga kjo, GVJ rekomandon krijimin e një Bordi të tregut të Punës, me anëtarë nga biznese, studiues, dizajner, antropologë, gjë që do ndihmonte të merrte një feedback nga nevojat e tregut dhe sfidat e reja.</i></p> <p><b>Ref. 1.14: Veprimtaritë e zyrës së karrierës.</b>  <b>Ref. 1.24: Marrëveshje të UPT</b>  <b>Ref. 6.06: Vendimi Nr. 2</b>  <b>Ref. 1.13: Marrëveshje UPT – PEA</b>  <b>Ref. 1.05: VKM per riemnimin e DTM</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit, garantojnë përftimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e lëndëve janë paraqitur në çdo syllabus të programit. Gjithashtu në to pasyrohen rezultatet e nxënit, si dhe dijet e aftësisë që përftojnë studentet, të cilat gjithashtu i referohen elementëve të programit të studimit BSc ne Inxhinieri Tekstile e Modë e janë trajtuar ne rregulloren e programit të studimit DTM.</p> <p>Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i profesionistëve dhe specialistëve në fushën e Inxhinieri Tekstile e Modë, të cilët mund të depërtojnë si në tregun kombëtar, po ashtu dhe atë ndërkombëtar. Në këtë program studenti përfton në aspekte teorike, praktike dhe aplikative, të cilët më pas mund të avancojnë studimet e tyre dhe karrierën pas universitare.</p> <p><b>Ref. 1.09: Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstili e Modë</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			<p>X</p>	

**Standardi I.4**

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Institucioni, si institucioni i arsimit të lartë ka një përvojë shumë vjeçare në zbatimin, ndjekjen e objektivave dhe kriterëve sipas ligjeve të arsimit të lartë në Shqipëri. Ashtu sic është parashtruar në statutin, rregulloren e insitucionit dhe planin strategjik, UPT ka të gjitha burimet dhe kapacitet njerëzore, e logjistike për të ofruar programin e studimit. Në bazë të përmirësimit të vazhdueshëm, projekteve të ndryshme me organizata, shoqata a institucione homologe, universiteti realizon në mënyrë të qëndrueshme plotësimin e objektivave strategjike për arsimin profesional e shkencor, fuqizimi i kapaciteteve krijuese të personelit akademik e kërkimor të UPT në Shqipëri në përputhje me standartet e cilësisë. Gjithashtu institucioni e DTM ka në dispozicion burimet njerëzore dhe aparaturat e nevojshme për të ofruar shërbimet e mëposhtme, dhe për palë të tretë, si për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Projekte për prodhimin e lëndës së parë, tekstileve, veshjeve dhe këpucëve</li> <li>• Konsulencë teknike për fabrikat e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve</li> <li>• Bashkëpunim me institute të tjera që kanë në fokus kërkimet shkencore</li> <li>• Njohuri dhe asistencë në fushën e modës në Shqipëri</li> <li>• Kontroll cilësie të lëndës së parë fibrore, pëlhurave, veshjeve dhe lëkurë/këpucëve.</li> </ul> <p><b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT.</b>  <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b>  <b>Ref. 1.09 Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstile e mode.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Statutin e UPT, Departamenti i Tekstilit dhe Modës është një nga njësitë bazë të FIM. Veprimtaria akademike e Departamentit të Tekstilit dhe Modës zhvillohet në përputhje me parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit Lartë (HEAL), duke reflektuar parimet dhe objektivat e Procesit të Bolonjës, si dhe kornizën ligjore në fuqi. Programi i studimit BSc nc Inxhinieri Tekstile e Modë, si pjesët e programeve të ofruara nga DTM, menaxhohet ne nivel fakulteti dhe realizohet në bashkëpunim me te gjitha njësitë baze të tij. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit jane në përputhje me ato të njësisë kryesore, të reflektuara në misionin e FIM dhe të përshkuara në</p>

	<p>rregulloren e UPT, sipas klasifikimit te programeve te studimit sipas legjislacionit kombëtar dhe udhezimeve europiane .</p> <p><b>Ref. 1.17: Plani mesimor</b></p> <p><b>Lista e programeve te studimit te kodifikuara / Ligji per IAL 80 / 2015</b></p> <p><b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Bazuar ne rregulloren e UPT, DTM ne programin e tij BSc ne Inxhinieri Tekstile e Modë, ofron drejtimet:</p> <p>1. Teknologji Tekstili dhe Menaxhim</p> <p>2. Prodhim i Veshjeve dhe Fashion design</p> <p>3. Permbarim Kimik dhe Ngjyrim</p> <p>Gjatë vitit akademik 2005-2006 u aplikua sistemi me dy cikle, Bachelor dhe Master, sipas marrëveshjes së kartës së Bolonjës. Niveli Bachelor përfshin module mësimore sipas ndarjeve te mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Module inxhinierie</li> <li>• Module profesionale</li> <li>• Module me njohuri të përgjithshme</li> </ul> <p>Studimi i lëndëve profesionale fillon në semestrin e dytë te vitit të parë dhe vazhdon deri në semestrin e gjashtë (viti i tretë). Niveli Bachelor përfundon me punimin dhe mbrojtjen e temës se diplomës. Pas përfundimit të nivelit Bachelor studentët kanë mundësinë që gjatë dy viteve të ardhshme të vazhdojnë studimet në fushën e zgjedhur prej tyre në nivelin Master. Kjo gje që është ne perputhje me fushen akademike e kërkimore të vete njesisë. Programi është hartuar dhe vënë në funksionim nga DTM si i vetmi i ketij lloji ne vend i cili ka provuar nivelin e kompetencave te studenteve në dalje permes mobiliteteve në kuadër të programeve Erasmus dhe pjesëmarrjes në projekte të tjera ndërkombëtare e kombëtare.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b></p> <p><b>Ref. 1.09 Syllabuset e disjplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstile e mode.</b></p> <p><b>Ref. 1.19: Mobilitetet Erasmus te Stafit</b></p> <p><b>Ref. 1.20: Mobilitetet Erasmus te Studenteve</b></p> <p><b>Ref. 1.17: Plani mësimor</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**Standardi I.5**

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron	Institucioni ka ndërtuar e krijuar mekanizma të brendshëm për hartimin, mbikëqyrjen e mbarëvajtjen e programit. Brenda departamentit, organizimi dhe menaxhimi i çdo programi

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 12

<p>marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>studimi, në DTM, bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS), që përbëhet nga 3(tre) anëtarë përprograme te studimit të ciklit të dytë, 5(pesë) anëtarë për programe te studimit të ciklit të parë, dhe një anëtar përzgjidhet nga radhët e studentëve. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit të studimit, që është dhe drejtuesi i grupit mësimor me peshën më të madhe në programin përkatës të studimit.</p> <p>Koordinatori i programit, në kontakt të vazhdueshëm me përgjegjësën e departamentit, zhvillon e mbikqyr ecurinë e programit mesimor, dhe një sërë hapash të tjera, të cilat ndihmojnë në zhvillimin e programit.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b>  <b>Ref. 1.16 Organigrama e FIM. .</b>  <b>Ref. 6.03 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT, Nenet 4, 5, 6, . .</b>  <b>Ref. 6.04 Këshillat e Programeve të Studimit dhe Koordinatorët</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Departamenti i Tekstilit dhe Modës ka një bashkëpunim të hershëm e të vazhdueshëm me shumë nga firmat e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve në vend në drejtim të konsulencave dypalëshe, testimave dhe analizave laboratorike, kryerjes së praktikave mësimore për studentët, udhëheqjes se punimeve të diplomave. Shumë prej kompanive prodhuese punësojnë studentë të diplomuar në degën Inxhinieri Tekstile e Modë. Disa prej kompanive me të cilat institucioni ka bashkëpunime janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• SAM, Tiranë, Omega, Tiranë</li> <li>• Mediterranea, Tiranë</li> <li>• Kler, Tiranë</li> <li>• Ola1, Tiranë</li> <li>• Madison Avenue, Tiranë</li> <li>• Dika Konfeks, Tiranë</li> <li>• Kler shpk, Tiranë</li> <li>• AUTEX</li> </ul> <p><b>Ref. 1.12 Projektit Rritje Albania-USAID.</b>  <b>Ref. 1.13 Mareveshje UPT-PEA.</b>  <b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM. .</b>  <b>Ref. 3.09 Tabelë përmbledhëse që pasqyron aktivitetet për kërkimin shkencor të stafit. .</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Marrëveshjet e realizuara nga FIM, e te zbatuara nga DTM të programit Inxhinieri Tekstile e Modë, analizohen në mënyrë periodike në mbledhje e raportime të departamentit. Raportet i përcillen Dekanatit për raportimin vjetor në nivel fakulteti.</p> <p>Përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit reflektohen më pas në lementët e programit të studimit si: pjesëmarrja në projekte kërkimore shkencore, publikime shkencore, prezantime në konferenca shkencore, realizime të detyrave të kursit nga studentet, etj.</p> <p><b>Ref, 1.21: Analiza vjetore mësimore-kërkimore e DTM</b>  <b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM. .</b>  <b>Ref. 3.09 Tabelë përmbledhëse që pasqyron aktivitetet për kërkimin shkencor të stafit</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 13

	<p><b>Ref. 6.01 Plani Strategjik FIM</b>  <b>Ref. 5.12 Plani vjetor i aktivitetit kërkimor - shkencor në njësi bazë dhe kryesore</b>  <b>Ref. 1.24 Mareveshje ne UPT</b>  <a href="https://upt.al/cilesia-ne-upt">https://upt.al/cilesia-ne-upt</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.</p>	<p>Institucioni nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit për kryerjen e praktikës për studentët, së pari ka krijuar dhe konsoliduar një frymë partneriteti me institucionet kombëtare dhe ato vendore, si edhe me biznesin. Shumë prej kompanive prodhuese me të cilat bashkëpunon departamenti, i vijnë në ndihmë zbatimit dhe zhvillimit të praktikave të studentëve.</p> <p>Disa prej kompanive me të cilat institucioni ka bashkëpunime janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• SATRA (<a href="http://www.satira.co.uk">www.satira.co.uk</a>)</li> <li>• Universiteti i Tiranës</li> <li>• Qendra e Studimeve Albanologjike</li> <li>• Shoqata e Prodhuesve Shqiptarë të Fasonëve</li> <li>• Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve</li> <li>• Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë së Tiranës</li> <li>• Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)</li> <li>• GIZ</li> <li>• USAID</li> <li>• Banka Botërore, etj.</li> </ul> <p><b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM. .</b>  <b>Ref. 3.09 Tabelë përmbledhëse që pasqyron aktivitetet për kërkimin shkencor të stafit</b>  <b>Ref. 6.01 Plani Strategjik FIM</b>  <b>Ref. 5.12 Plani vjetor i aktivitetit kërkimor - shkencor në njësi bazë dhe kryesore</b>  <b>Ref. 1.24 Mareveshje ne UPT.</b>  <a href="https://upt.al/projekte-1">https://upt.al/projekte-1</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Institucioni siguron trajnime profesionale për studentët, nëpërmjet praktikave profesionale dhe dhënies së informacionit e asistencës së nevojshme për gjetjen e mundësive për kryerjen e praktikave profesionale/ stazheve/ internshipeve të ofruara nga institucione partnere apo dhe më gjerë. Institucioni ka të hartuar një procedure që ka si objektiv kushtet për mënyrën e hartimit, kryerjes, vlerësimit dhe rishikimit të programit të praktikës profesionale në programet e ciklit të parë dhe të dytë të studimeve në FIM. Procedura zbatohet nga Departamentet që mbulojnë një program studimi, koordinatori i programit të studimit, pedagogët përgjegjës dhe nga studentët në vitin e fundit të programeve të ciklit të parë ose të dytë të studimit. Kjo procedurë është në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT.</p> <p>Sipas procedurës, praktika profesionale e studentit zhvillohet nën mbikëqyrjen dhe ndjekjen e disa hapave:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pedagog përgjegjës – personi përgjegjës i caktuar nga Drejtuesi i</li> </ul>

	<p>Departamentit dhe Koordinatorit i programit të studimit për të drejtuar, mbikëqyrur dhe vlerësuar aktivitetin e studentit gjatë praktikës profesionale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Referenti në ndërmarrje – person referent në mbikëqyrjen dhe vlerësimin e aktivitetit të studentit gjatë praktikës profesionale nga ana e ndërmarrjes ku kryhet praktika.</li> <li>Komisioni i vlerësimit – komision i ngitur nga drejtuesi i Departamentit për vlerësimin me notë të studentit praktikant.</li> </ul> <p><b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e programit të studimit</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.</b></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1	
Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Kurrikula e programit i përgjigjet kriterëve dhe parametrave europianë, duke e bërë dijen të transferueshme dhe duke iu përgjigjur kërkesave të "Kartës së Bolonjës", në përshtatje edhe me ndryshimet dhe zhvillimet e tregut të punës. Programi i studimit është i organizuar në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi është i organizuar me 180 ects. Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Modë, realizohet dhe drejtohet nga departamenti i Tekstilit dhe Modës, FIM, UPT në tre vjet dhe në total ka 180 ECTS, prej të cilave 36 ECTS Disiplina të formimit të përgjithshëm, 96 ECTS- Disiplina të formimit karakterizues.</p> <p><b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program të studimit</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesioneve e specialitetesh.</p>	<p>Te diplomuarit "Bachelor" në Inxhinieri Tekstile dhe Modë kanë aftësi për tu punësuar në zbatimin e projekteve inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve inxhinierike tekstile, në projektim të asistuar, dizejnim, projektim dhe stilim veshjesh etj. Studimet e Bachelor përmbajnë bazat e nevojshme shkencore, si dhe aftësinë metodike të një kualifikimi të mundshëm profesional në fushën e inxhinierisë tekstile dhe në stilim dhe modë. Te diplomuarit kanë aftësi për tu punësuar në zbatimin e projekteve inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve inxhinierike tekstile, në projektim dizejnimin dhe stilimin e veshjeve, si në kompanitë e prodhimit të veshjeve në vend, atelie të punësuar ose vetëpunësuar, në çdo institucion shtetëror sipas fushës së ekspertizës. Në vitin e fundit, studentët kanë lëndë me zgjedhje sipas orientimit të diplomës:</p> <p><b>Orientimi konfeksionim dhe mode</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Tregu dhe prodhimi i modës</li> <li>• Teoria e projektimit (dizejnimit)</li> <li>• Plotesime të teknologjisë dhe çilesisë</li> </ul> <p><b>Orientimi teknologji</b></p> <p><b>Orientimi kimi</b></p> <p><i>Në orientimin konfeksionim dhe modë, GVJ rekomandon në zhvillimin e lëndëve më specifike që ndihmojnë studentët në këtë orientim diplome, dhe një gërshetim të lëndëve me një qasje dhe artistike e krijuese.</i></p> <p><b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM.</b></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 16



	<p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Statutin e UPT, Departamenti i Tekstilit dhe Modës është një nga njësitë bazë të FIM dhe mbulon fushat didaktike dhe shkencore të ndarë në grupe mësimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologjia e prodhimit të materialeve tekstile;</li> <li>• Teknologjia e prodhimit të veshjeve dhe dizenjim.</li> </ul> <p>Grupet janë njësi përbërëse mësimore-kërkimore të Departamentit., të cilat mbulojnë veprimtarinë mësimore apo kërkimore shkencore të një ose më shumë disiplinave të ngjashme dhe të ndërvarura të formimit të përgjithshëm dhe atij profesional. Grupet mësimore-kërkimore kanë në përbërjen e tyre të paktën pesë anëtarë efektivë si personel akademik i departamentit. Grupet mësimore krijohen në bazë të grup-disiplinave që mbulon departamenti. Grupet mësimore krijohen, mbyllen, organizohen dhe riorganizohen në përputhje me kornizën ligjore në fuqi me Statutin e UPT dhe Rregulloren e brendshme të FIM, Udhëzimi i Rektoratit + FIM_PO-03.</p> <p><b>Ref. 4.02 Ndarja e grupeve mësimore në DTM.</b>  <b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Misioni i DTM është:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të ndryshme; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj në fushën e dizenjimit, teknologjisë, prodhimit të materialeve tekstile dhe veshjeve.</li> <li>• të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë inxhinierik;</li> <li>• të kontribuojë në zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal;</li> <li>• të integrojë mësimdhënien me kërkimin shkencor; kërkimi shkencor në fushat e teknologjisë së prodhimit të materialeve tekstile dhe lekures, veshjeve e kepuceve, ngjyrimit e përmbartimit kimik, dizenjimit e Modelimit.</li> <li>• ofrimi i shërbimeve për industrinë në formën e studimeve, ekspertizave, opioncave teknike, projekteve, dhe kontrollit të cilësisë e konformitetit të produkteve industrial.</li> </ul> <p>Në bazë të vizionit, planit strategjik dhe statutit të institucionit, departamenti synon dhe realizon në vazhdimësi implementimin e zbatimin e këtyre parimeve.</p> <p><b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM.</b></p>

	<p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/media/220919111203X86756388LAX85.pdf">https://www.fim.edu.al/media/220919111203X86756388LAX85.pdf</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi i studimeve organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studime. Rregullorja e brendshme e Departamentit të Tekstilit dhe Modës (DTM) mbështetet në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, rregulloren e brendshme të FIM, si dhe aktet e tjera të brendshme rregullatore të institucionit. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë misionin dhe të rregullojë aspekte të organizimit, drejtimit, administrimit dhe sigurimit të cilësisë së punës akademike e kërkimore në Departamentin e Tekstilit dhe Modës.</p> <p><b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.</b></p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Lëndët në përmbajtje të kurrikulës janë të organizuara sipas kategorive (A-E), me peshën e përcaktuar në Shtojcën 1 të VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL”, e ndryshuar.</p> <p><b><u>Veprimtaritë mësimore janë ndarë si më poshtë:</u></b>  <b>Kategoria A-</b> 36 kredite ECTS nga lëndët bazë në me peshën <b>20%</b>  <b>Kategoria B-</b> 96 kredite ECTS –lëndë karakterizuese me peshën <b>53.3%</b>  <b>Kategoria C-</b> 24 kredite ECTS - lëndë ndërdisiplinore të profilit me peshën <b>13.3%</b>  <b>Kategoria D-</b> 18 kredite ECTS - lëndë plotësuese me peshën <b>10%</b>  <b>Kategoria E-</b> 6 kredite ECTS nga detyrimi përmbyllës, i cili është provim përfundimtar, ose punim diplome, me peshën <b>3.3%</b> me një total prej 180 ECTS. Një kredit ECTS është 25 orë mësimore, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/ detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit.</p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b>  <b>Ref. 1.09 Syllabuset e disiplinave te BSc ne Inxhinieri Tekstile e mode. Ref. 1.17 Plani mesimor.</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>X</b></p>

**Standardi II.2****Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>UPT në statutin dhe ne rregulloren e tij përshkruan programet e studimeve që ofrohen në të gjitha njësitë kryesore dhe ato baze. Njeherazi, rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinieri Tekstile e Modë, në përputhje me dokumentat e sipërcituar, provon që programi është hartuar bazuar në to. Programi i studimeve organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studime. Rregullorja e brendshme e Departamentit të Tekstilit dhe Modës (DTM) mbështetet në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, Statutin e Universitetit Politeknik të Tiranës, Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT, rregulloren e brendshme të FIM, si dhe aktet e tjera të brendshme rregullatorë të institucionit. Kjo rregullore ka për qëllim të përcaktojë misionin dhe të rregullojë aspekte të organizimit, drejtimit, administrimit dhe sigurimit të cilësisë së punës akademike e kërkimore në Departamentin e Tekstilit dhe Modës</p> <p><b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program të studimit</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.</b>  <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/media/220919111203X86756388LAX85.pdf">https://www.fim.edu.al/media/220919111203X86756388LAX85.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Organizimi dhe menaxhimi i çdo programi studimi, në DTM, bëhet nga Këshilli i Programit të Studimit (KPS). KPS përbëhet nga 3(tre)anëtarë për programe të studimit të ciklit të dytë, 5(pesë) anëtarë për programe të studimit të ciklit të parë. Një anëtar përzgjidhet nga radhët e studentëve. Drejtuesi i KPS është koordinatori i programit të studimit. Koordinatori i programit të studimit, është drejtues i grupit mësimor me peshën më të madhe në programin përkatës të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat formuese të tij. Koordinatori i programit të studimit informon vazhdimisht përgjegjësin e njësisë përkatëse për të gjitha problematikat, si dhe mbledh dhe drejton mbledhjet e KPS; bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, në përputhje me rregulloren e njësisë bazë dhe kryesore; siguron që dokumentacioni bazë i programit të studimit, plani mësimor dhe sylabuset të jenë të përditësuar në fillim të çdo viti siguron që materialet didaktike të jenë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme për studentët, në format letër ose elektronik në fillim të zhvillimit të lëndës;</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 19




	<p>bashkëpunon me drejtuesin e njësisë bazë për koordinimin e aktiviteteve për kryerjen e analizës vjetore dhe rishikimin e programit të studimit; në koordinim me drejtuesin e njësisë bazë, merr pjesë në organizimin e takimeve me palët e interesuara për të kryer studime të tregut të sotëm të punës në lidhje me kompetencat në dalje që duhet të fitojnë të studentët; në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse, merr pjesë në organizimin e aktiviteteve të informimit për maturanët/kandidatët që dëshirojnë të regjistrohen në këtë program studimi.</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 6.08: Takimeve informuese të zhvilluara nga ASCAL</b>  <b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b>  <b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM.</b></p> <p><a href="https://www.fim.edu.al/media/220919111203X86756388LAX85.pdf">https://www.fim.edu.al/media/220919111203X86756388LAX85.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Tekstilit dhe Modes si pjese e FIM, bashkërendon mesimdhënien dhe kërkimin shkencor në fushat e përcaktuara. FIM përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>FIM ka në përbërje të tij departamentet:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Departamenti i Energjisë</li> <li>2. Departamenti i Mekanikës</li> <li>3. Departamenti i Prodhim Menaxhimit</li> <li>4. Departamenti i Tekstil dhe Modës</li> </ol> <p>Ku secili departament ka në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë me kohë të plotë. Departamenti është i organizuar në grupet mesimore kërkimore: gruplet e "Teknologjise së prodhimit të veshjeve dhe Designit", dhe gruplet e "Teknologjise së prodhimit të materialeve tekstile".</p> <p>Ky organizim dhe strukturat laboratorike në varësi (laboratori fiziko-mekanik dhe kimik i tekstilit dhe lekures, atelier i projektimit dhe dizajnit, dhe laborator i prodhimit dhe projektimit CAD/CAM të tekstilit dhe kepuceve) janë në përputhje me misionin e programit BSc në Inxhinieri Tekstile e Mode misionin e departamentit, si dhe në rregullore.</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT,</b>  <b>Ref. 1.03: Shkrese e MASH</b>  <b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b>  <b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>Numri i personelit akademik në departamentin përgjegjes.</p> <p>Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/ gradat:</p> <p><b><u>Personeli Akademik Efektiv- PAE- Viti akademik 2019 - 2020</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Prof.Dr</li> <li>• 2 Prof.asoc</li> <li>• 6 Dr</li> </ul> <p><b><u>Personeli Akademik me Kontratë-PAK- 2019 - 2020</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 Prof.Dr</li> <li>• 5 Msc</li> </ul>

	<p><b><u>Personeli Akademik Efektiv- PAE- Viti akademik 2020 - 2021</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 Prof.Dr</li> <li>• 2 Prof.asoc</li> <li>• 6 Dr</li> </ul> <p><b><u>Personeli Akademik me Kontratë-PAK- 2020 – 2021</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Prof.Dr</li> <li>• 1 Dr.proc</li> <li>• 3 Msc</li> </ul> <p><b><u>Personeli Akademik Efektiv- PAE- Viti akademik 2021 – 2022</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 Prof.Dr</li> <li>• 2 Prof.asoc</li> <li>• 6 Dr</li> </ul> <p><b><u>Personeli Akademik me Kontratë-PAE- 2021 – 2022</u></b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Prof.Dr</li> <li>• 4 Msc</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/ bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>UPT në përputhje me përcaktimet e LAL 80/2015: Neni 23, Pika 3, struktura, organizimi, përberja, funksionimi, si dhe drejtimit e FIM dhe DTM janë të përcaktuara në statutin dhe aktet e tjera të UPT.</p> <p>Mënyra e hartimit të programit të studimit BSc ne Inxhinieri Tekstile e Mode (Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit BSc ne Inxhinieri Tekstili e Mode), transferimi i studimeve (<a href="http://www.unt.al/transferime">http://www.unt.al/transferime</a>) diploma dhe suplementi i diplomes realizohen duke respektuar Ligjin Nr. 80/2015 per "Arsimin e Lartë në Republikën e Shqiperise", Nenet 89-91.</p> <p><b>Ref. 1.01_AL Statuti i UPT.</b></p> <p><b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b></p> <p><b>Ref. 6.03: Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b></p> <p><b>Ref. 6.04: Këshillat e Programeve të Studimit dhe Koordinatorët</b></p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b></p> <p><b>Ref. 2.04: Modeli i diplomes</b></p> <p><b>Ref. 2.05: Modeli i suplementit</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

<p><b>Standardi II.3</b></p> <p><b>Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/ bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe</p>	<p>KPS analizon çdo propozim për ndryshim ose përmirësim të programit të studimit dhe pasi e vlerëson atë në përputhje me objektivat formuese të programit të studimit, me Kodin e cilësisë, SUPT, Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe me të gjithë kornizën ligjore aktuale, referuar programeve të studimit, ia përcjell</p>

<p>përbajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>përmiririm dhe procedim të mëtejshëm departamentit përkatës ose fakultetit për programet ndërdisiplinore. Kjo analizë shoqërohet me një raport teknik, në të cilën jepet mendimi i KPS përndryshimet e propozuara; Harton draft propozimin për programet e reja të studimit që synohen të hapen mbështetur në propozime të ardhura nga personeli akademik, duke respektuar kërkesat e kornizës ligjore në fuqi dhe të dokumenteve themelore të UPT dhe ia paraqet departamentit për procedim të mëtejshëm në respekt të procedurave administrative të UPT. Gjithashtu, drejtuesi i njësisë bazë ushtron funksione të ndryshme, të cilat mbikqyrin dhe procedojnë hapat për zhvillimin e ecurinë e departamentit. Përgjegjësi i departamentit emëron pas përzgjedhjes titullarët e grupeve mësimore / grupeve kërkimore; drejton punën për hartimin e rregullores së departamentit; koordinon, kontrollon dhe menaxhon procesin mësimor, që ofron njësia bazë; emëron pedagogët e tutorazhit për çdo grup seminaresh të programeve të studimit që mbulon departamenti. Gjithashtu, ai/ ajo nxit, koordinon, kontrollon dhe menaxhon veprimtarinë kërkimore-shkencore të departamentit, e raporton para Dekanatit të FIM për mbarëvajtjen e veprimtarisë së departamentit, si dhe përcjell vendimet dhe propozimet e departamentit tek Dekani.</p> <p>Drejtuesi i njësisë bazë përgatit raportet vjetore të punës mësimore, kërkimit shkencor dhe zhvillimit të departamentit, mbështetur në raportet e grupeve mësimore/ grupeve kërkimore, si dhe krijon komisione e grupe pune për çështje, studime e veprimtari të veçanta të departamentit;</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/media/220910222742X74147305LAX84.pdf">https://www.fim.edu.al/media/220910222742X74147305LAX84.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Departamenti i Tekstilit dhe Modës, FIM, në përputhje me rregulloren e tij dhe atë të UPT, ka të përcaktuar organizimin, strukturën dhe përbajtjen e programit të studimit.</p> <p>Në planin mësimor të programit të studimit janë përcaktuar disiplinat të grupuara në kategoritë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• lëndë bazë (7 disiplina - A),</li> <li>• lëndë karakterizuese (17 disiplina - B)</li> <li>• lende ndërdisiplinore integruese (5 disiplina - C),</li> <li>• gruplëndë me zgjedhje (3 disiplina - D)</li> <li>• punimi i diplomës - E.</li> </ul> <p>Pjesë e programit janë edhe detyrimet pënbjlyse të cilat lidhen me praktikën mësimore,, përgatitjen e diplomës në përputhje me rregulloren e UPT, rregulloren e DTM dhe rregulloren e programit të studimit. <a href="https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit">https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit</a>. Në Statutin, në rregulloren e UPT dhe në rregulloren programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstili dhe Mode janë përcaktuar qartë objektivat, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve, të transferimit,</p>

	<p>vlerësimin të dijeve dhe diplomimit.</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p> <p><b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b></p> <p><b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi është i organizuar në lëndë dhe komponentë të tjerë (praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse), të vlerësuara në kredite ECTS. Programi i ciklit të parë të studimit Bachelor në Inxhinjeri Tekstili dhe Modë, realizohet dhe drejtohet nga departamenti i Tekstilit dhe Modës, FIM, UPT në tre vjet dhe në total ka 180ECTS, prej të cilave 36 ECTS Disiplina të formimit të përgjithshëm, 96 ECTS- Disiplina të formimit karakterizues. Komponentët janë të ndarë në vite dhe semestra, duke bërë një shpërndarje të balancuar të ngarkesës mesatare për çdo semestër dhe vit akademik. Programi është i ndërtuar në mënyrë të atillë, ku në vitin e parë zhvillohen kryesisht lëndët e natyrës së përgjithshme, e cila vijon më tej në vitin e dytë e të tretë me lëndë karakterizuese të programit, e lëndët e profilit. Praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse, zhvillohen në vitin e fundit të programit, dhe janë të detyrueshme për përmbylljen e diplomës.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b></p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program të studimit.</b></p> <p><b>Ref. 2.03 Mareveshje te praktikave mesimore</b></p> <p><a href="https://www.fim.edu.al/media/220910222742X74147305LAX84.pdf">https://www.fim.edu.al/media/220910222742X74147305LAX84.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/ jashtë auditorit, frekuentimin/ ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimin të dijeve etj.</p>	<p>Sipas statutit dhe rregulloreve përkatëse, programi i studimit përmban planin mësimor, ku pasqyrohen të detajuara të gjitha informacionet mbi lëndët dhe komponentët e tjerë sipas semestrave dhe viteve akademike, ku pasqyrohen ngarkesa e çdo lëndë në kredite, orët në javë, orët mësimore të ndara në leksione, seminare, ushtrime/ laborator, format e kontrollit të vazhdueshëm, orët në auditor, mënyrat e vlerësimin etj.</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p> <p><b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b></p> <p><b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Informacionet që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve gjenden në dokumentet e brendshme, në nivel institucional dhe në nivel programi studimi, të cilat bazohen sipas rregullave në fuqi nga Ministria e Arsimit, si dhe gjithashtu bazohen në rregulloren, statutin e insitucionit. Në dokumentacionin e paraqitur, insitucioni ka paraqitur procedurën dhe formularët që ndiqen e plotësohen konform rregullave të përcaktuara. Në Nenin 62 “Transferimi i studimeve” dhe në Nenin 63 “Ndjekja e një program të dytë studimi”, në Statutin e UPT, sqarohen kriteret dhe procedurat në lidhje me njohjen e</p>

	<p>kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Njohje e cila bëhet nëpërmjet komisioneve të ekuivalentimit të lëndëve. Gjithashtu tabela me “Kategoritë e veprimtarive formuese”, Neni 10 dhe “Kriteret dhe kuotat e pranimit” Neni 11, në Rregulloren e programit të studimit japin të dhëna mbi kadehorizimin e lëndëve, peshën e tyre, kreditet dhe përqindjen gjë që i bën procedurat e transferimeve apo njohjen e studimeve të pjesshme transparente për të interesuarit.</p> <p><b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili e mode</b></p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikën, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve që përmbanë kurrikula e programit janë të strukturuar sipas formatit të miratuar, në nivel institucioni, ku paraqitet informacion i detajuar për objektivat e lëndës, temat për secilën javë, format e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, si edhe literaturën e detyrueshme dhe të rekomanduar që studenti duhet të lexojë. Informacioni i detajuar për secilën lëndë të programit të studimit paraqitet në syllabusin e detajuar, i cili miratohet përpara fillimit të semestrit nga përgjegjësi i grup lëndës dhe përgjegjësi i departamentit. Programet mësimore japin informacion mbi njohuritë tematike, të shoqëruara me literaturën bazë, të detyruar dhe plotësuese apo ndihmëse, që nevojiten për marrjen e dijes në lëndën e caktuar. Në programin e lëndës evidentohen ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit, të paraqitura dhe në ECTS. Në secilin program lëndë, reflekton format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe detyrimet e studentit për lëndën. Syllabuset e çdo lëndë depozitohen dhe mbahen nga personeli administrativ i programit apo koordinatori. Bashkëpunimi dhe projektet e ndryshme në nivel institucional e po ashtu dhe departamenti, favorizojnë nxënien e dijeve tek studentet. Në kuadër të projektit të USAID, si dhe marrëveshjet e bashkëpunimit midis shoqatës PEA dhe UPT, ku njëra nga objektet e marrëveshjes është edhe mundësia e kryesjes së praktikave dhe e punësimit në kompanitë pjesë të rrjetit të PEA-s. Gjithashtu DTM organizon sfilata me punimet e studentëve, të realizuar sipas programit të studimit, për të promovuar dhe lehtësuar punësimin e tyre. FIM, UPT, përmes zyrës së karrierës, e cila është ngritur në vitin 2020, e ndjek mbarëvajtjen e kërkesave dhe nevojave të studentëve.</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p> <p><b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b></p> <p><b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë.</b></p> <p><b>Ref. 1.09 Syllabuset e disiplinave të BSc në Inxhinjeri Tekstile e mode</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese rishikohen në mënyrë periodike, aty ku paraqitet dhe nevoja për ndryshim. KPS analizon çdo propozim për ndryshim ose përmirësim të programit të studimit dhe pasi e vlerëson</p>



<p>ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>atë në përputhje me objektivat formuese të programit të studimit, me Kodin e cilësisë, SUPT, Rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe me të gjithë kornizën ligjore aktuale, referuar programeve të studimit, ia përcjell përmiratim dhe procedim të mëtejshëm departamentit përkatës ose fakultetit për programet ndërdisiplinore. Kjo analizë shoqërohet me një raport teknik, në të cilën jepet mendimi i KPS përndryshimet e propozuara; Harton draft propozimin për programet e reja të studimit që synohen të hapen mbështetur në propozime të ardhura nga personeli akademik, duke respektuar kërkesat e kornizës ligjore në fuqi dhe të dokumenteve themelore të UPT dhe ia paraqet departamentit për procedim të mëtejshëm në respekt të procedurave administrative të UPT; Përgatit raportin e analizës vjetore të programit të studimit dhe ia përcjell për diskutim dhe miratim departamentit. Këto procedura, gjithashtu ndihmohen dhe nga puna e drejtuesit të grupit mësimor, i cili organizon punën për hartimin e programit të lëndëve që i përkasin grupit mësimor për t'i propozuar më pas për miratim në Departament, si dhe mbikëqyr respektimin e programeve mësimore, dhe raporton te Drejtuesi i Departamentit për realizimin e programit mësimor në përfundim të çdo semestri duke pasqyruar dhe mendimet e grupit mësimor. Drejtuesi i grupit mësimor gjithashtu bën propozime pranë departamentit për komisionet e provimeve të lëndëve që ai mbulon në fakultet</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë</b></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="643 1144 823 1218">Përmbushet plotësisht</th> <th data-bbox="823 1144 997 1218">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="997 1144 1214 1218">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1214 1144 1436 1218">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="643 1218 823 1256"></td> <td data-bbox="823 1218 997 1256"></td> <td data-bbox="997 1218 1214 1256"></td> <td data-bbox="1214 1218 1436 1256">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi II.4</b> <b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të nxënies dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Organizimi i programit të studimit, nga ngarkesa e përgjithshme dhe ndarja e lëndëve dhe komponentëve të tjerë në kategori, sikurse dhe emërtimi i secilës veprimtari dhe shpërndarja e tyre, përmbush qëllimin dhe objektivat e programit të studimit në funksion të njohurive, aftësive dhe punësimin e studentëve. Veprimtaritë formuese që ofrohen në këtë program studimi grupohen si më poshtë:</p> <p>36 kredite ECTS nga lëndët bazë në Kategorinë A me peshën 20%  96 kredite ECTS –lëndë karakterizuese të kategorisë B me peshën 53.3%  24 kredite ECTS - lëndë ndërdisiplinore të profilit me peshën 13.3%  18 kredite ECTS - lëndë plotësuese në kategorinë D me peshën 10%  6 kredite ECTS nga detyrimi përmbyllës, i cili është provim përfundimtar, ose punim diplome, me peshën 3.3% me një total prej 180 ECTS.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 25

	<p>Një kredit ECTS është 25 orë mësimore, përbërë nga orë mësimore për transmetim dijesh në auditor (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe orë mësimore për përgatitje ose punë individuale të studentit</p> <p><b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ ose punësim të studentëve.</p>	<p>Duke parë numrin e konsiderueshëm të studentëve që zgjedhin këtë program studimi, si dhe me traditën e ekëtij institucioni, dhe traditën vendase të pëlhurave, nteresi i studentëve për te ndjekur BSc në Inxhinjeri Tekstile e Mode reflekton mundesine e punësimit të tyre të ardhshëm.</p> <p>Orët laboratorike didaktike cilat lidhen me formimin praktik të studentëve kanë një sasi të konsiderueshme orësh mësimore. Gjithashtu mobilitete e studentëve, praktikat mësimore, si dhe lidhja që mundëson departamenti për punësimin e studentëve pranë kompanive, rezulton se një pjesë e tyre vazhdojnë studimin në nivelin e dytë te studimeve pranë te njëjtij departament, ose jashtë vendit dhe të tjeret jane të punësuar pjesërisht në kompanitë e prodhimit të veshjeve dhe këpucëve si dhe pranë institucioneve publike te lidhura me profilin e studimit, duke dëshmuar një përputhje të programit të studimit me nevojat e tregut të punës.</p> <p>Duke qenë se frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 100%, kjo gjë mundëson implementimin e teorisë në praktikë.</p> <p><b>Ref. 1.17: Plani mësimor</b>  <b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/media/220221113819X96522039LAX84.pdf">https://www.fim.edu.al/media/220221113819X96522039LAX84.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/ modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi i studimit, plani mësimor, disiplinat mësimore dhe veprimtaritë formuese, që ofrohen në këtë program studimi, dhe kreditet mundësojnë arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional. Në rregulloren e programit të studimit, parashtrohen të gjitha kërkesat e programit, elementet mësimorë të programit dhe procedura e diplomimit. “Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të ciklit të parë të studimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>Kreditet, sipas sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS);</li> <li>Kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</li> <li>Objektivat formues dhe kompetencat profesionale;</li> <li>Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</li> <li>Kadegoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</li> <li>Planin mësimor;</li> <li>Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</li> </ol>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 26

	<p>h) Programin mësimor (Syllabus-et);  i) Profilin e programit;  j) Diplomën dhe suplementin.</p> <p>Këto politika dhe procedura janë të ligjëruara si në statutin e dhe rregulloren e UPT, statutin dhe rregulloren e FIM dhe statutin e rregulloren e DTM.</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b>  <b>Ref. 6.08: Takime informuese të zhvilluara nga ASCAL</b>  <b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar dhe mundëson arritjen e rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimit profesional. Në rregulloren e programit të studimit, parashtrihen të gjitha kërkesat e programit, elementet mësimorë të programit dhe procedura e diplomimit.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstili dhe Modë shprehen dhe shpjegohen qartë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Elementet që përbëjnë programin e studimit;</li> <li>• sistemi i krediteve;</li> <li>• Kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlerësimit;</li> <li>• Objektivat formues dhe kompetencat profesionale;</li> <li>• komponentët e programit të studimit;</li> <li>• Kategoritë e veprimtarive formuese;</li> <li>• Kriteret dhe kuotat e pranimit;</li> <li>• praktika profesionale;</li> <li>• mbrojtja e diplomës.</li> </ul> <p>Gjithashtu, kontrolli i vazhdueshëm, detyrat praktike gjatë simestrit rrisin mundësinë për të kuptuar nëse studentët po i arrijnë objektivat mësimore. Programet e studimit janë të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite (ECTS). Sasia normale e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student me kohë të plotë është 60 kredite. Në përfundim të studimeve në të gjitha programet e studimit që ofrohen nga Universiteti Politeknik, studenti duhet të grumbullojë të paktën sasinë e krediteve të përcaktuara në pikat 1-4 të nenit e rregullores. Një krediti të formimit të arsimit të lartë i korrespondojnë 25 orë mësimore pune të studentit (1 orë mësimore pune llogaritet 60 minuta). Sasia mesatare e punës së kryer nga studenti gjatë një viti studimesh universitare me kohë të plotë është 1500 orë mësimore (60 kredite), që përfshijnë orë në auditor dhe orë punë të pavarur. Orët e punës së pavarur të studentit, zënë jo më pak se gjysmën e fondit të përgjithshëm të 1500 orëve. Ngarkesa mësimore javore në auditor, për leksione, seminare, ushtrime e laboratorë, forma të kontrollit të</p>

	<p>vazhdueshëm dhe seanca të praktikave të zhvilluara në auditor, është nga 20 deri në 25 (njëzet e pesë) orë mësimore 50-minutëshe. Në fillimet e hapjes së programi i studimit BSc në Inxhinieri Tekstile e Mode, insitucioni dhe stafi i angazhuar konsultoi një numër programesh të BE-së të fushes së inxhinierisë tekstile nga universitete prestigjioze për të përafuar programin, i cili implementohej për here të pare në Shqipëri. Kështu, struktura e programit, lendet dhe emertimi i tyre, ngarkesa dhe raportet teori: praktikë, janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe të ngjashme me programe bachelor në vende të rajonit dhe me gjerë, gjë e cila dëshmohet në pjesëmarrjen e stafit dhe studentëve në programet e mobilitetit Erasmus+. Gjatë shkëmbimit, studentët ndjekin një semester në Universitetet Europiane, me të cilat Departamenti është koordinator, dhe lëndët e ndjekura / intershipet, i njihen lehtësisht. Gjithashtu nga keto marrëveshje të bashkëpunimit, personel akademik i Universiteteve Europiane është i ftuar për cikle leksionesh ose seminare dhe ëorkshope të mbajtura në mjediset e në ambjentet e FIM, që dëshmon një pasqyrim vlerash të përbashkëta, përse i përket mësimdhënies.</p> <p><b>Ref. 2.08: Mobilitetet Erasmus të Stafit të huaj.</b>  <b>Ref. 1.19: Mobilitetet Erasmus të Stafit</b>  <b>Ref. 1.20: Mobilitetet Erasmus Studentëve.</b>  <b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc në Inxhinieri Tekstili e Mode</b>  <a href="https://upt.al/kreditet-frekuentimi">https://upt.al/kreditet-frekuentimi</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndarja e kurikulës sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formuese të studentit, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve, sipas pritshmërive të tyre, si dhe në përshtatje me tregun e punës. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies së disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme e frekuentimit të tyre ndryshon në funksion të tipit të aktivitetit mësimor që realizohet, duke i klasifikuar pjesërisht të detyrueshme dhe plotësisht të detyrueshme.</p> <p>a. frekuentimi i leksioneve është i këshillueshëm;  b. frekuentimi i seminareve dhe ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75% të numrit të seancave të zhvilluara;  c. frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 100%.</p> <p><a href="https://upt.al/kreditet-frekuentimi">https://upt.al/kreditet-frekuentimi</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Cilësia e programit BSc në Inxhinieri Tekstile e Modë, ndër të tjera bazohet në përditësimin e përmbytjes së syllabuseve nga stafi akademik, diskutimi pranë gruplëndëve, miratimin në mbledhjet e DTM dhe përzgjedhja e tematikave tëzave të diplomimit. Syllabuset përmbajnë informacion mbi literaturën dhe atë ndihmëse për çdo disiplinë, të cilat studenti i gjen në bibliotekë, në formë fizike dhe elektornike.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur nga institucioni, në shkresën për miratimin e literaturës bazë dhe mbështetëse që shërben për këtë program</p>

	<p>studimi, departamenti ka miratuar propozimet e kryera nga titullarët e lëndëve. Aty pasqyrohen botime shkencore nga stafi të realizuar 2014/2015, si dhe leksione të shkruara nga stafi të cilat janë në zhvillim e sipër, viti 2018 e në vazhdim, të cilat janë literaturë e nevojshme për studentët.</p> <p><b>Ref. 1.09: Syllabuset e disiplinave të BSc në Inxhinieri Tekstili e Modë.</b>  <b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b>  <b>Ref. 3.07 tekste të miratuara të programit Bsc Inxhinjeri Tekstili e Mode</b>  <a href="https://upt.al/biblioteka">https://upt.al/biblioteka</a></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Përmbajtja e programeve të studimit dhe elaborimi i lëndëve të ndryshme, gërshetimi i praktikës dhe teorisë, mundëson formimin, përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë. Objektivi i rezultateve të nxënimit të studentëve, kjo si rezultat i bashkëpunimit të mira Student – Pedagog dhe programeve të lëndëve. Ndihe e madhe janë në këtë drejtim burimet laboratorike ku studenti praktikon njohuritë e nxena në auditor, në formën e laboratorëve, punëve praktike, praktikave mësimore. Departamenti i Tekstilit dhe Modës, përveç lëndëve që mbulon vetë në dy ciklet e studimit, mbulon disa lëndë në ciklin Bachelor Piktura në Tekstil, Akademia e Arteve të Bukura në Tiranë.</p> <p><b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Studimet e Bachelor përmbajnë bazat e nevojshme shkencore, si dhe aftësinë metodike të një kualifikimi të mundshëm profesional në fushën e inxhinierisë tekstile dhe në stilim dhe modë. Te diplomuarit kanë aftësi për tu punësuar në zbatimin e projekteve inxhinierike, mirëmbajtjen dhe kontrollin e asistuar të sistemeve inxhinierike tekstile, në projektim dizajnimit dhe stilimit e veshjeve, si në kompanitë e prodhimit të veshjeve në vend, atelie të punësuar ose vetëpunësuar, në çdo institucion shtetëror sipas fushës së ekspertizës. UPT ndjek politika për punësimin brenda universitetit të studentëve ekselentë si personel akademik efektiv dhe me kontratë, si staf ndihmës akademik apo administrativ. Një shembull i qartë i punësimit të studentëve ekselentë është edhe DTM, ku kryesisht pedagogët e lëndëve karakterizuese dhe lëndëve ndërdisiplinore kanë qenë ish studentë. Gjithshtu DTM bën përpjekje të vazhdueshme për të ndihmuar studentët në lidhje me punësimin në kompanitë prodhuese të konfeksioneve, firma të ndryshme, atelie mode apo institucione të ndryshme. DTM i kushton shumë rëndësi praktikave profesionale që nga gjetja e kompanive të ndryshme dhe bashkëpunimi i ngushtë në monitorimin e studentëve, si një rrugë që ndihmon në mënyrë efektive punësimin e studentëve mbase mbarimit të studimeve. Një argument ky i prekur dhe i aprovuar, si nga stafi akademik ashtu edhe nga vetë studentët, gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit të jashtëm. Rrjeti Alumni, tashmë i ngritur në FIM mbledh të dhëna mbi punësimin e studentëve dhe</p>

	<p>mban kontakte me ta. (<a href="https://fim.edu.al/fim/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim">https://fim.edu.al/fim/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim</a>). Nëpërmjet rrjetit Alumni, UPT identifikon dhe ndjek zhvillimin e karrierës së studentëve. Institucioni ka krijuar një database me mbi 200 të diplomuar, që kanë qenë të interesuar për tu bërë pjesë e këtij rrjeti. Nëpërmjet pyetësorit dhe database të krijuar, figurojnë të punësuar aktualisht në masën 88%, prej të cilëve 78% punojnë në profesionin e tyre. 57% janë punësuar për herë të parë pa mbaruar studimet dhe 36% janë punësuar vitin e parë mbas diplomimit. Ngritja së fundmi e zyrës së karrierës dhe alumnit mundëson formalizimin e lidhjeve të kësaj natyre për gjurmimin e të diplomuarve në programin të studimit.</p> <p><i>Mungesa e database të mëparshëm për punësimin e studentëve të diplomuar (gjurmimi i studenteve të diplomuar) në vite tregon se ruajtja e lidhjeve me këtë masë të madhe specialistësh është kryer mbi baza sporadike, njohjesh personale apo edhe rastësore në bazë departamenti, gjë që ka krijuar vështirësi për të patur një perceptim më të plotë të punësimit të studentëve gjatë viteve.</i></p> <p><b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b>  <b>Ref. 3.08: Broshurë informuese e DTM</b>  <b>Ref. 1.14: Veprimtaritë e zyrës së karrierës</b>  <b>Ref. 1.24: Marrëveshje të UPT</b>  <b>Ref. 6.06: Vendimi Nr. 2</b>  <b>Ref. 1.13: Marrëveshje UPT – PEA</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Një nga çështjet e rëndësishme, pjesë e informacionit që institucioni përgatit për të informuar studentët e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili se Modë, është edhe mundësia e punësimit si dhe orientimi drejt tregut të punës. Një pikë e fortë e institucionit UPT/FIM është bashkëpunimi me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet. Këto bashkëpunime mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara duke filluar që nga viti 2016, që shërbejnë për realizimin e praktikave mësimore të studentëve, duke e parë këtë edhe sin je mundësi punësimi pas mbarimit të studimeve. Në panairin e punës, të organizuar nga UPT, shumë kompani pjesmarrëse kanë shprehur interes për bashkëpunim në lidhje me praktikat profesionale dhe punësimin. Panairë të tjerë, ku UPT ka qenë pjesmarrëse, janë edhe “ëork and study” 2020, i organizuar nga Dhoma e Tregëtisë dhe e Industrisë dhe në panairin e Ndërtimit, Arkitekturës dhe Planifikimit Urban 2018. Rrjeti Alumni, tashmë i ngritur në FIM mbledh të dhëna mbi punësimin e studentëve dhe mban kontakte me ta. (<a href="https://fim.edu.al/fim/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim">https://fim.edu.al/fim/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim</a>). Nëpërmjet rrjetit Alumni, UPT identifikon dhe ndjek zhvillimin e karrierës së studentëve. Institucioni ka krijuar një database me mbi 200 të diplomuar, që kanë qenë të interesuar për tu bërë pjesë e këtij rrjeti. Nëpërmjet pyetësorit dhe database të krijuar, figurojnë të punësuar aktualisht në masën 88%, prej të cilëve 78% punojnë në profesionin e tyre. 57% janë punësuar për herë të parë pa mbaruar studimet dhe 36% janë punësuar vitin e parë mbas diplomimit. Nëpërmjet pjesëmarrjes në panairin</p>

	<p>“work&amp;study”, nga njësia bazë planifikohen ditët e karrierës për të informuar maturantët nëpërmjet fletëpalosjeve dhe broshurës. Zhvillohen edhe prezantime të organizuara nga zyra e karrierës.</p> <p><b>Ref. 3.08: Broshurë informuese e DTM</b></p> <p><b>Ref. 1.14: Veprimtaritë e zyrës së karrierës</b></p> <p><b>Ref. 1.24: Marrëveshje të UPT</b></p> <p><b>Ref. 6.06: Vendimi Nr. 2</b></p> <p><b>Ref. 1.13: Marrëveshje UPT – PEA</b></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5	
Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përmbush kriteret ligjore, si në aspektin e titujve dhe gradave që zotërojnë, ashtu edhe në aspektin e përputhshmërisë së ekspertizës me lëndët ku janë të angazhuar</p> <p>Numri i personelit akademik: Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat:</p> <p><b>Personeli Akademik Efektiv- PAE- Viti akademik 2019 - 2020</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Prof.Dr</li> <li>• 2 Prof.asoc</li> <li>• 6 Dr</li> </ul> <p><b>Personeli Akademik me Kontratë-PAK- 2019 - 2020</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 Prof.Dr</li> <li>• 1 Dr.proc</li> <li>• 4 Msc</li> </ul> <p><b>Personeli Akademik Efektiv- PAE- Viti akademik 2020 - 2021</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 Prof.Dr</li> <li>• 2 Prof.asoc</li> <li>• 6 Dr</li> </ul> <p><b>Personeli Akademik me Kontratë-PAE- 2020 – 2021</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Prof.Dr</li> <li>• 1 Dr.proc</li> <li>• 3 Msc</li> </ul> <p><b>Personeli Akademik Efektiv- PAE- Viti akademik 2021 – 2022</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 2 Prof.Dr</li> <li>• 2 Prof.asoc</li> <li>• 6 Dr</li> </ul> <p><b>Personeli Akademik me Kontratë-PAE- 2021 – 2022</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• 1 Prof.Dr</li> <li>• 4 Msc</li> </ul> <p>Pjesë e dokumentit të “Ngarkesës mësimore të stafit akademik” është</p>

	<p>edhe “Deklarimi i ngarkesës së realizuar nga personeli akademik efektiv”.</p> <p>Ngarkesa akademike e stafit në vite ka qenë:</p> <p><b>Viti akademik 2019-2020</b> PAE 1798 ore/ PAK 216/ ne total 2014 ore</p> <p><b>Viti akademik 2020-2021</b> PAE 1769 ore/ PAK 460 ore / ne total 2229</p> <p><b>Viti akademik 2021-2022</b> PAE 1701 ore/ PAK 382 ore / ne total 2083 ore</p> <p>Në bazë të “VENDIM Nr. 418, datë 10.5.2017, Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve TË ARSIMIT TË LARTË DHE TË DEGËVE TË TYRE, Pika 2, ii) Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi, personeli akademik i angazhuar në programin e studimit përmbush kriteret ligjore, si në aspektin e titujve dhe gradave që zotërojnë, ashtu edhe në aspektin e përputhshmërisë së ekspertizës me lëndët ku janë të angazhuar, stafi PAE ka patur një ngarkesë mësimore, duke përmbushur mbi 70% të normës së ngarkesës mësimore. Procedura e “Deklarimit të ngarkesës së realizuar nga personeli akademik efektiv në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike”, përgjatë një viti akademik, është hartuar në zbatim të Nenit 57 pika 3 dhe nenit 59 pika 1 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Shkencën në Republikën e Shqipërisë”. Kjo procedure pasqyron ngarkesën e personelit akademik në veprimtaritë që ai kryen në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.</p> <p>Qëllimi është:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. të krijojë një standard të matjes së kontributit akademik të stafit efektiv në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike;</li> <li>2. të jetë një instrument nxitës për rritjen profesionale të personelit akademik efektiv në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike;</li> <li>3. të motivojë punën dhe vlerat në mjedisin akademik.</li> </ol> <p>Objekti i kësaj procedure është përcaktimi i mënyrës së deklarimit të përmbushjes së ngarkesës vjetore (1536 orë) të personelit akademik efektiv të punësuar më kohë të plotë (PAE) në FIM.</p> <p>Kjo procedure ka lidhje me veprimtaritë që kryen PAE në FIM që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënie;</li> <li>- Kërkim shkencor;</li> <li>- Kontribut institucional;</li> <li>- Kontribut profesional;</li> </ul> <p>Ngarkesa klasifikohet edhe sipas kategoriave të gradave shkencore. Po ashtu kjo bëhet e qartë edhe nëpërmjet Nenit 3 të Statutit të UPT “Misioni dhe objektivat institucionale”.</p> <p><b>Ref. 2.02: Ngarkesa mësimore e stafit akademik</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme që angazhohen në realizimin e</p>	<p>Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjeshme të angazhuar në programin e studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për të udhëhequr ecurinë e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>



programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

Gjithashtu, departamenti ka kryer një analizë ku në dokumentin e paraqitur janë renditur kërkimet-shkencore për cdo anëtarë të tij:  
Disa prej këtyre kërkimeve shkencore në plan individual janë:

- Organizon çdo dy vjet Konferencen Nderkombetare te tekstilit dhe sfilaten me punime te studenteve Inxhinieri Tekstili dhe Mode.
- Fashion products through digital manufacturing - a case study ëith FDM technology, Journal of the Albanian Young Academy, Volume 1, 2019. ISSN 2707 7128, Shtator 2019, Mitilineos S. A., Kazani I., Guxho G., Dassonville F., Koncar V., 11.
- The anisotropic structure of electroconductive leather studied by Van Der Pauëmethod, Shabani A., Hylli M., Kazani I., Berberi P., Zavalan O., Guxho G. 2019, Hylli M., Kazani I., Berberi P., Zavalan O., Guxho G.
- Performanca ne komfort e veshjeve sportive, AJTNS, Nentor 2020, autor i parë, AJTNS (Akademia e Shkencave), Tiranë. Artikull, autor i parë.
- E.Shehi, "Textile and garment Sector – Investment Promotion", Dusseldorf, Panairi Nderkombetar, 5 – 9 Nentor 2019, AIDA dhe Ëeiss Consulting Germany 2019 , referuese e parë.
- "Teknologjia e Prodhimit te veshjeve" Tekst mësimor i prodhuar në kuadër tëProjekt i Ëeis Consulting Germany dhe Ministria e Arsimit, Shqiperi. Redaktim shkencor i tekstit dhe oponenca per Ministrine e Arsimit, Shqiperi. 4. Udheheqës shkencor i doktoraturës: Materialet dhe Aksesoret e veshjeve Popullore shqiptare – Dr. Albana Leti (Tota), mbrojtja 2020.
- Performanca ne komfort e veshjeve sportive, AJTNS, Nentor 2020, autor i parë, AJTNS (Akademia e Shkencave), Tiranë. Artikull, autor i dytë. 2. 10-11 October, 2019, Polytechnic University of Tirana,
- Blerina Kolgjini, Ana Marija Grancaric, Ilda Kola, Elton Rogozi, Genti Guxho, "The Performance of Textiles on Mosquito Protection" 2nd International Conference "Engineering and Entrepreneurship" 2019, organized by Mechanical Engineering Faculty, Polytechnic University of Tirana (PUT), . ISBN 978-9928-4525-5-9, referues i parë.

Etj.

**Ref. 2.11 Konferenca Nderkombetare te Tekstilit**

**Ref. 3.05 Raportet vjetore të DTM**

**Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM. .**

**Ref. 3.09 Tabelë përmbledhëse që pasqyron aktivitetet për kërkimin shkencor të stafit.**

**Kriteri 3.** Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit,

Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij, ku cdo pedagog drejton e zhvillon lëndë të cilat mbulohen nga fusha e tij e studimit, dhe studimet e tij kërkimore.

janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

**Ref. 3.09 Tabelë përmbledhëse që pasqyron aktivitetet për kërkimin shkencor të stafit.**

**Kriteri 4.** Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.

Institucioni, në bazë të marrëveshjeve të bashkëpunimit me institucione të tjera të arsimit të lartë, e me përfaqësues të biznesit dhe me stafin e duhur e të kualifikuar, instrukton dhe orienton e udhëheq studentët në praktikën profesionale, për punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera. Kps përgatit raportin e analizës vjetore të programit të studimit dhe ia përcjell për diskutim dhe miratim departamentit. Analizon format e vlerësimit të studentit dhe i propozon departamentit mënyrat e përmirësimit të tyre; Organizon tërheqjen e mendimit të studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Rezultatet e tyre ia përcjell departamentit për analizë të mëtejshme; Mbështet proceset për sigurimin e cilësisë; Bashkëpunon me strukturat e tjera akademike për përmirësimin e programit të studimit.

**Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.**

**Ref. 1.12 Projektit Rritje Albania-USAID.**

**Ref. 1.13 Mareveshje UPT-PEA**

**Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.**

**Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.**

**Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.**

<https://www.fim.edu.al/pro/erasmus>

**Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësues shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.

Takimet me studentë shprehën kënaqësi në lidhje me studimet dhe stafin pedagogjik, gjë që dëshmon përshtatshmërinë e kualifikimeve të personelit akademik të mirënjohur. Studentët konfirmuan se universiteti është gjithmonë i disponueshëm për t'i ndihmuar ata.

Angazhimi i stafit akademik, sipas kualifikimit të nevojshëm, pranë këtij institucioni, në këtë program studimi, siguron dhe përditëson cilësinë e zhvillimit të orëve mësimore, veçanërisht ato praktike, laboratorike, të cilat lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me praktikën, ku një rol të rëndësishëm luan dhe stafi ndihmës akademik i angazhuar në këtë program.

**Vizita në institucion**

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

### III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.</p>	<p>Institucioni në planin strategjik të tij, ka si qëllim të ngjallë tek studentët krijimtarinë, lirinë krijuese, bashkëpunimin dhe transferimin e njohurive në fushën e shkencës dhe të edukimit për një zhvillim të qendrueshëm, me synim për të avancuar njohuritë. Në këtë kontekst, dhe departamenti, dhe fakulteti kanë hartuar plan strategjik, plan mësimor, për të zhvilluar dhe për të vënë në përdorimin metoda të ndryshme bashkëkohore, që ndihmojnë në përfitim të dijeve. Gjatë bisedimeve me stafin akademik, u konstatua, se pedagogët të cilët përftojnë njohuri të reja e metoda të mësimdhënies gjatë shkëmbimeve dhe eksperiencave të përftuara gjatë mobiliteteve akademike. Rritja e veprimtarisë ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor, nëpërmjet pjesëmarrjes në programet dhe projektet kërkimore kombëtare, Evropiane dhe rajonale dhe më gjerë, dhe zgjerimi i bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e shkëmbimit të personelit akademik, favorizon dhe ndikon në përcjelljen e dijeve tek studentët. Gjithashtu në bazë të praktikave mësimore, zhvillimeve të orëve laboratorike, si dhe mobiliteti i studentëve, kontribuon në përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative.</p> <p><i>Pavarësisht se përdorimi i metodave të reja, inovative që përdoren në këtë program studimi, GVJ rekomandon Design thinking jo vetëm si metodologji të mësuarit, si një ide, një strategji, një metodë dhe një mënyrë për të kuptuar konsumatorin, tregun apo të ketë më të qartë target grupin mbi të cilin zhvillohet një projekt apo diplomë nga studentët. Design Thinking që është pjesë metodologjike që ka bërë me dizajnin, do të ndihmonte akoma më shumë zhvillimin e një projekti duke nisur me fokus konsumatorin, e që shkon deri në zhvillimin e prototipit. Për këtë GVJ rekomandon krijimin e lidhjet e bashkëpunimeve me institucione, apo trajnime ose ëorkshope ne fusha te dizajnit, të cilat do të mundësonin tek studentët një qasje më inovative drejt nevojave, trendeve të reja të tregut, me një fokus të orientuar drejt target grupeve të caktuara.</i></p> <p><b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>  <b>Ref. 1.12 Projektit Rritje Albania-USAID.</b>  <b>Ref. 1.13 Mareveshje UPT-PEA</b>  <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në</p>	<p>Politikat e mekanizmat e ngritura nga universiteti, ndikojnë në përmirësimin e kulturës së cilësisë në procesin e edukimit nëpërmjet zbatimit të standarteve të përcaktuara në planin e veprimeve për arritjen e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 35

<p>mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>plotësimin e zhvillimin e kapaciteteve për monitorimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë në procesin e edukimit me synim rritjen e efektivitetit dhe efijencës së programeve të studimit.</p> <p>Kjo zhvillohet në disa mënyra:</p> <p>Metoda e vetëvlerësimit periodik te punës së personelit akademik si pjesë e rritjes së kulturës së cilësisë, ku cdo pedagog plotëson formularin e vetëvlerësimit për performancën e tij.</p> <p>Gjithashtu Koordinator i programit të studimit informon vazhdimisht drejtuesin e njësisë përkatëse për të gjitha problematikat, si dhe mbledh dhe drejton mbledhjet e KPS; bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse përzhvillimin e programit të studimit, në përputhje me rregulloren e njësisë bazë dhe kryesore; Personeli ndihmës-akademik me karakter mësimor (laboranti, tekniku) kryen veprimtarinë e tij brenda DTM, i cili ka disa detyra, si: dhënie e kontributit e tij në ecurinë e procesit mësimor-kërkimor të DTM; mban përgjegjësi për mjediset ku ai kryen veprimtarinë e tij dhe mjetet didaktike dhe kërkimore që ndodhen në ato mjedise e realizon planin e veprimtarive të miratuara, në fillim të çdo viti akademik, nga përgjegjësi i departamentit. Gjithashtu institucioni harton raporte analitike mbi kërkimin-shkencor, i cili siguron informacion sasior dhe cilësor mbi kërkimin shkencor pranë njësisë kryesore dhe bazë të UPT-së me qëllim përgatitjen e raportit vjetor mbi kërkimin shkencor dhe inovacionin, i cili do të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, bazuar në Udhëzimin Nr. 5, Datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”, Udhëzimi Nr. 24, Datë 21.10.2019, Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 5, datë 19.02.2018, “Për përcaktimin e elementëve përbërës të raportit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”.</p> <p><b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b></p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b></p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Departamenti, ashtu si dhe institucioni ka hartuar një plan veprimi, i cili konsiston në rishikimin dhe përmirësimin e programeve të studimit duke u mbështetur tek rezultatet e të mësuarit (Learning Outcomes - LO); në nxitja e metodave efektive të zhvillimit të disiplinave që japin rezultate positive për studentët, si dhe ridimensionimi i rolit të studentëve duke e vendosur në qendër të procesit të mësimdhënies dhe të asimilimit. Gjithashtu pjesë e këtij plani veprimi janë dhe formularët e ankesave dhe të vlerësimit të studnetëve për lëndët dhe pedagogun, të cilat japin një feedback mbi ecurinë apo problematikat që mund të shfaqen. Kontrolli i dijeve në FIM është një nga veprimtaritë e procesit mësimor i cili synon që të vlerësojë në mënyrë të shkallëzuar (me notë) studentët, duke siguruar verifikimin e dijeve të studentit në një lëndë të caktuar. Pedagogu shfrytëzon procesin e kontrollit të dijeve për vlerësimin e metodologjisë në mësimdhënie dhe për ri-formulimin e shpërndarjes të elementeve të aktiviteteve mësimore.</p>

	<p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Procesi i Anketimit të studentëve është një proces i parashikuar në Ligjin 80/2015, Kreu X, Neni 103 “Sigurimi i brendshëm i cilësisë”, si një ndër masat e marra në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. SKS ka si qëllim kryesor sigurimin dhe rritjen e cilësisë në arsimin e lartë duke vlerësuar performancën e institucioneve në kuadër të mësimdhënies, mësimnxënies dhe kompetencave nga këndështrimi i studentëve. Metodologjia e përdorur për ankimet studentore nga DSBC. Mbi bazën e të dhënave të gjeneruara nga sistemi, u realizua një analizë statistikore në disa nivele:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Nivel Institucioni</li> <li>• Nivel Fakulteti</li> <li>• Nivel Programesh Studimi</li> <li>• Nivel Pedagogu</li> </ul> <p>Për të garantuar pjesëmarrje dhe njohjen sa më të mirë me procesin, studentët informohen përmes e-mail-it në lidhje me kohën e kryerjes së anketimit, mënyrën e plotësimit dhe rëndësinë e këtij procesi. Nëpërmjet këtyre pyetësorëve, çdo studenti, i jepet mundësia të shprehë mendimet e tij mbi procesin mësimor dhe personelin akademik si dhe të përcjellë pranë autoriteteve të Universitetit shqetësime specifike. Plotësimi i pyetësorëve bëhet për çdo lëndë dhe çdo pedagog që merr pjesë në procesin e mësimdhënies në semestrin aktual nëpërmjet platformës online të sekretarisë mësimore: <a href="http://bit-albania.com/upt.php">http://bit-albania.com/upt.php</a>. Këta pyetësorë ndihmojnë në krijimin e një panorame të problematikave në UPT, në lidhje me universitetin, fakultetin, programin e studimit ku ata studiojnë dhe pedagogët e tyre, për të mundësuar përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë akademike.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b>  <b>Ref. 6.02 Plan Veprimi mbi problematikat e konstatuara në Anketimet Studentore</b></p> <p><u>Raport mbi anketimin studentor viti akademik 2021-2022 (sem i)</u>  <u>raport mbi anketimin studentor "cilësia e mësimdhënies online" sem ii 2019-2020</u>  <u>raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2019-2020(sem i)</u>  <u>raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2018-2019(sem ii)</u>  <u>raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2018-2019(sem i)</u>  <u>raport mbi anketimin studentor per vitin akademik 2017-2018 (sem ii)</u></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e</p>	<p>UPT, bazuar në planin strategjik të tij synon dhe në mënyrë të vazhdueshme stimulon promovimin dhe mbështetjen e bashkëpunimit ndërkombëtar në nivel njësie bazë nëpërmjet dhënies së çmimeve/shpërblimeve vjetore nga Rektori për personelin akademik dhe studentët, që kanë dhënë kontribut të shquar në promovimin e UPT në arenën ndërkombëtare. Intensifikimi i bashkëpunimit shkencor me partnerët</p>

mëtejshëm së cilësisë së mësimdhënies.	homologë ndërkombëtarë (konferenca të përbashkëta, projekte, etj), për rritjen e njohjes ndërkombëtare të veprimtarive akademike të UPT. Inkurajimi dhe rritja e pjesëmarrjes nga njësitë bazë dhe kryesore të UPT në programet Evropiane të bashkëpunimit Erasmus plus, H2020 dhe më gjerë (objektivat e zyrave të UPT). <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b> <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>		
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>
			<b>Përmbushet plotësisht</b>
			X

<b>Standardi III.2</b>	
<b>Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive ndiqen sipas statutit, rregulloreve përkatëse dhe ligjeve vendore në fuqi. Në planin mësimor të programit janë të përfshira leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër që lidhet me performancën e studentit, të miratuara nga institucioni. Objektivi kryesor i programit të studimit Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Mode është t'u japë studentëve njohuritë bazë të formimit të përgjithshëm inxhinierik dhe formimit të profilizuar në fushën e materialeve dhe proceseve të formimit të tekstilit, veshjeve, këpucëve, përmbartimit kimik të tyre, proceseve dhe sistemeve të realizimit të tyre si dhe menaxhimit të ndërmarrjeve të prodhimit të tekstileve dhe veshjeve/këpucëve. Cdo syllabus, që i vihet në dispozicion studentit që në fillim të vitit akademik, ka të përcaktuar qartazi metodologjinë, lëndët, orët, tematikat e literaturën që përmban lënda. Aty janë të pasqyruara qartazi të gjitha detyrimet e studentit për të plotësuar kreditet e duhura. Cdo syllabus, ashtu dhe plani mësimor janë hartuar në funksion të një përmbushje sa më të plotë të dijeve profesionale, duke gërshetuar teorinë me praktikën, për të qënë të aftë profesionalisht në tregun e punës, apo për të zhvilluar studime të tjera. <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b> <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b> <a href="https://upt.al/transferime">https://upt.al/transferime</a> <a href="https://upt.al/transferime?start=2">https://upt.al/transferime?start=2</a> <a href="https://upt.al/transferime?start=3">https://upt.al/transferime?start=3</a>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies,	Personali akademik u përgjigjet nevojave të studentëve, duke ju përputhur dhe llojit specifik të lëndës, duke ofruar mundësi të ndryshme për të gjithë studentët në arritjen e qëllimeve akademike. Programi organizon module të veçanta për forcimin e aftësive dhe të njohurive të studentëve për të lehtësuar futjen e tyre në tregun e punës, si dhe mbështjetjen për studentët për lëndët ekstrakurrikulare, si dhe për çdo nismë që çon në lehtësimin e punësimit të tyre. Me organizimin e

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 38

<p>në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>panaireve të punës, studentët inkurajohen të bien në kontakt me punëdhënës-punëmarrës, duke lehtësuar futjen në tregun e punës të të sapodiplomuarve. Gjithashtu, studentët informohen për mundësi të ndryshme trajnimi e punësimi dhe në faqet online të universitetit.</p> <p>Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, është dhe mbetet në synimet e institucionit. Nëpërmjet informimit, këshillimit, mbështetjes si dhe orientimit të tyre, dhe infrastrukturës të përshtatshme dhe funksionale, zbatimit të një politikë gjithpërfshirëse si në vendimarrje ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarisë shoqërore, studentët luajnë një rol të rëndësishëm në aktivitete të ndryshme si në proceset e vendimmarrjes, përmirësimit të politikës gjithpërfshirëse të zhvillimit shoqëror.</p> <p>Studentët kanë marrë pjesë në disa aktivitete, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pjesëmarrës në Civil Istanbul 2018 <a href="https://iaces.net/?pagina=Evento&amp;id=105">https://iaces.net/?pagina=Evento&amp;id=105</a></li> <li>• Pjesëmarrës ne International Geodetic Students</li> <li>• Organizatorë për Dy vjet të ceremonisë së diplomimit.</li> <li>• Ëorkshop with Gjeo-Vjosa në bashkëpunim me departamentin e Ing. Gjeodezisë.</li> <li>• Pjesë e grupit të hartimit dhe miratimit të Strategjise së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit për 5 vitet e ardhshme.</li> <li>• Pjesë në grupin e hartimit dhe miratimit të Rregullores së Brendshme të Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit.</li> <li>• Ëorkshop ‘Cities and Energy’ në bashkëpunim me departamentin e Ing. Mjedisit.</li> <li>• 2 Simposiune ndërkombëtare në bashkëpunim me departamentin e Ing. Mjedisit ‘Applying Enginering in Solving Environmental Challenges’ &amp; ‘Easte Treatment and their Challenges Ahead’.</li> </ul> <p><b>Ref. 5.16 Këshilli Studentor (Aktivitete).</b> <a href="https://upt.al/aktivitete-te-keshillit-studentor">https://upt.al/aktivitete-te-keshillit-studentor</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b> <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b> <b>Ref. 1.01_AL Statuti i UPT.</b> <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b> <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është i përzgjedhur sipas fushave, si dhe eksperiencia e tyre në fushat përkatëse. Për këtë dëshmojnë cv-të e stafitë pedagogjik që janë në fushat e tyre përkatëse, si dhe komunikimi që komisioni vlerësues pati me studentë, kishte një feedback pozitive në lidhje me mësimdhënien, dhe marrëdhien dialoguese, mbështetëse dhe profesionale pedagog-student.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 39

dhe profilit.	<p><b>Ref. 2.01 CV e personelit akademik</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/pro/erasmus">https://www.fim.edu.al/pro/erasmus</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Njësi përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit është Departamenti. DSBC dhe DK, nëpërmjet fakulteteve, kordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Senati Akademik ka hartuar edhe rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në shërbim të cilësisë.</p> <p>UPT ka të institucionalizuar dhe aktive njësinë e brendshme të sigurim të cilësisë, e cila merr informacion nga çdo njësi kryesore dhe njësi bazë dhe monitoron zbatimin e kodit të cilësisë në to. Ajo ndjek dhe koordinon proceset e akreditimit dhe prozon plane veprimi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në kuadër të monitorimit të cilësisë, DSBC ka organizuar rregullisht anketime semestrale adresuar studentëve për vlerësimin e cilësisë në mësimdhënie. Në këto anketime përfshihen të gjithë indikatorët e mësimdhënies, çdo student i jepet mundësia të shprehë mendimin e tij mbi procesin mësimor dhe personelin akademik. Vlerësimet janë transparente dhe të aksesueshme në faqen e UPT. <a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a></p> <p>Në planin strategjik 2020-2024 të FIM, theksohet rëndësia e respektimit të standarteve për sigurimin e cilësisë në veprimtaritë akademike dhe administrative të fakultetit, sin ë planin afatshkurtër ashtu edhe në planin afatgjatë.</p> <p><b>Ref. 6.01: Plani Strategjik FIM</b>  <b>Ref. 5.01: Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT.</b>  <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT.</b>  <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Gjatë intervistave me stafin akademik, por dhe nga bisedat e zhvilluara me studentët, rezultoi se personali akademik përdor metoda të ndryshme për përmirësimin e nxënësies së studentit. Krahas lëndëve teorik, zhvillimi i lëndëve me karakter laboratorik, është i stimuluar nëpërmjet metodave ndërvepruese, ku studentët kryejnë punë individuale por dhe në grup, gjë që stimulon mjedisin mësimor. Bashkëbisedimet e vazhdueshme, leksionet e hapura, praktikat profesionale, janë të gjitha pjesë e metodologjisë shkencore të programit të studimit. Personeli akademik, i cili është i stimuluar dhe realisht merr pjesë në konferenca shkencore, aktivitete të ndryshme, në mobilitet e ndryshme që ata kanë kryer ndër vite, dhe ende zhvillojnë në kuadër të mësimdhënies, bëhen pjesë e konsiderueshme e metodologjisë së mësimin, pasi gjatë shkëmbimeve profesionale, përftohen dhe pasurohen dijet shkencore mbi fushën studimore në fjalë. <b>Vizita në institucion</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin</p>	<p>Përmirësimi dhe rritja e cilësisë së shërbimeve ndaj studentëve, duke krijuar një kulturë shërbimi cilësor bashkohor, përmirëson dhe rrit</p>



e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.

cilësinë së shërbimeve ndaj studentëve nëpërmjet informimit, këshillimit, mbështetjes si dhe orientimit të tyre. Nëpërmjet shfrytëzimit të infrakturës laboratorike që institucioni ofron, i vjen në ndihmë studentëve, stafit, por dhe studiuesjve të tjerë jashtë institucionit. Gjithashtu rol të rëndësishëm është dhe zbatimi i politikës gjithëpërfshirëse si në vendimarrje ashtu edhe në zhvillimin e veprimtarisë shoqërore të studentëve në proceset e vendimmarrjes, përmirësimit të politikës gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror për studentët.

Gjithashtu aktivitetet sociale dhe kulturore jashtë auditorëve, luajnë një rol të rëndësishëm në cilësinë e jetës universitare që i japin mundësi studentëve për ndërveprim shoqëror, zhvillim të aftësive të veçanta drejtuese, për shërbime të ndryshme brenda komunitetit të tyre, argëtim dhe edukim. Universiteti Politeknik i Tiranës synon të zhvillojë zbatimin e një politike gjithëpërfshirëse të zhvillimit shoqëror, për studentët dhe stafin. Për këtë qëllim, fillimisht në projekt-buxhetin afatmesëm dhe më tej në buxhetin vjetor, universiteti parashikon rregullisht një fond të veçantë dedikuar plotësisht të nevojave të Këshillit Studentor.

Të gjitha aktivitetet me efekte financiare, përfshirë aktivitetet social - kulturore në Universitetin Politeknik të Tiranës, realizohen në përputhje me procedurat e përcaktuara nga legjislacioni në fuqi.

-Propozimet e studentëve mbi tipologjinë, kalendarin dhe mënyrën e organizimit të aktiviteteve social kulturore jashtë auditorëve paraqiten me shkrim pranë këshillit studentor të secilës njësi kryesore (Fakultetit).

-Këshilli studentor i njësisë kryesore, miraton ose refuzon propozimet, bazuar në etikën, ndikimin e aktivitetit të propozuar në imazhin e universitetit, impaktin në cilësinë e jetës studentore dhe përputhmërinë me misionin dhe vizionin e zhvillimit institucional.

-Projektet e miratuara renditen sipas prioriteteve dhe i përcillen me shkrim këshillit studentor të UPT. Ky organ, vijon me procedurat standarde që ndiqen për realizimin e të gjithë aktiviteteve me efekte financiare të institucionit.

**Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.**

**Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.**

**Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit.**

**Ref. 1.15 Sfilatat e organizuara nga DTM. .**

**Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM**

**Ref. 4.21 Plan busheti i DTM. .**

**Ref. 4.22 Projekt Buxheti Afatmesëm 2020-2022.**

**Ref. 5.16 Këshilli Studentor (Aktivitete).**

Shkalla e përmbushjes së standardit	shet	Përmbushet	Përmbushet	Përmbushet
		pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

**Standardi III.3**

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Infrastruktura teknike dhe shkencore luan një rol primar në aktivitetin e Departamentit të Tekstilit dhe Modës. Pjesë e Departamentit janë laboratorët fiziko-mekanik dhe kimik të tekstilit, të akredituar sipas standardit ISO/IEC 17025, Atelier i Modelimit dhe dizenjimit si dhe laboratorit i prodhimi dhe projektimi CAD/CAM të tekstileve dhe këpucëve.</p> <p>Për plotësimin e këtij objekti synohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ruajtja dhe zhvillimi i burimeve njerëzore për të garantuar vazhdueshmërinë e kërkimit shkencor në UPT;</li> <li>• rritja e fondeve për kërkimin shkencor dhe shërbimet në rang institucional;</li> <li>• përmirësimi i infrastrukturës së kërkimit shkencor nëpërmjet ngritjes së laboratorëve të rinj;</li> </ul> <p>Modernizimi i bibliotekave shkencore të fakulteteve për t'i kthyer në një burim të vlefshëm e të domosdoshëm informacioni në shërbim të kërkimit shkencor dhe zgjerimit të njohurive për studentët.</p> <p><b>Ref. 2.12 Rregullore e mirembajtjes dhe infrastruktures laboratorike.</b>  <b>Ref. 3.06 Inventaret e laboratorëve të DTM.</b>  <b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM.</b>  <b>Ref. 4.05 Relacion mbi zonimin e ambienteve në shfrytëzimin të FIM në korpusin qëndror.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Për të zhvilluar procesin mësimor, dhe vecanërisht punën laboratorike të studentëve sipas lëndëve përkatëse, departamenti ka ngritur e venë në funksionim disa laboratorë. DTM ka këto laboratorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Laboratori Fiziko – Mekanik i Tekstilit dhe lëkurës</li> <li>b. Laboratori Kimik i tekstilit dhe lëkurës</li> <li>c. Laboratori i CAD/CAM dhe Teknologjisë së prodhimit të Veshjeve</li> <li>d. Atelier e Modës dhe Dizenjimit</li> </ol> <p><b>Laboratori i akredituar i tekstilit dhe i krijimit</b></p> <p>Laboratori punon si qendra e vetme, e qëndrueshme për tekstilet dhe lëkurën në Shqipëri dhe si e tillë ofron shërbimet e saj për sipërmarrjet prodhuese. Laboratori është akredituar në mënyrë të përsëritur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit (2001, 2005, 2006, 2011) për testimin e materialit dhe tekstilit. Testimet e kryera janë konform standardeve të tjera ISO, EN, DIN etj.</p> <p><b>Seksioni Fiziko-Mekanik</b></p> <p>Ky laborator i vjen në ndihmë stafit akademik dhe studenteve në lëndë: Shkenca dhe teknologjia e teksteve, materialet e prodhuara dhe Sigurimi i informacionit, Teknologjia dhe Kontrolli Drejtues i Studimeve, Teknologjia industriale I, Teknologjia dhe teknologjia e njohurive.</p> <p>Pjesë e punës së tërë të laboratorit është kryerja e testimeve dhe analizave laboratorike në lëndën e parë, produkte të ndryshme dhe gjysmë të grimcave, pëlhura të trikotuara e tezahuara, veshje, lekurë/këpucë, qilima e tapiceri. Laboratori ka marrë pjesë në testime ndërlaboratorike dhe testime zotësie me laboratorë të fushës në Evropë.</p>

	<p><b>Seksioni kimik</b></p> <p>Laboratori i shërben një moduli të caktuar të orientimit të përmbartimit të kimikateve dhe ngjyrave të tekstilit si dhe kontrollit të tekstilit</p> <p><b>Laboratori i CAD/CAM dhe Teknologjisë së Prodhimit të Veshjeve</b></p> <p>Ky është laborator i është vendi i mësimëve mësimore për Modëlim, prerje, qepje, trikotim dhe tezgjahim. Ky laborator ka dy linja të prodhimit të veshjeve, makina prestatie, ploter industrial, makina të trikotimit, tezgjah vertikal dhe horizontal, skaner kompjuterë antropometrik 3D dhe rrjetik me 20 kompjuterë në të cilat janë instaluar programet LECTRA (Lectra Modaris, Kaledo Style, Di) për lidhjen e skicave, Modëlimin e përzierjen e kallëp dhe shumëfishimin e tyre për prodhim industrial.</p> <p>Laboratori ofron asistencë në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• dizenjim dhe Modëlim veshjesh,</li> <li>• optimizimin e tekstilit për veshje dhe veshje,</li> <li>• tezgjahim,</li> <li>• trikotim,</li> <li>• tapiceri, për bizneset e vogla dhe të mesme private</li> </ul> <p>Ky atelier i vjen në ndihmë studentëve, punës së stafit akademik dhe studjuesve në lëndët: Modelim Veshjesh, Zhvillimi i projektimit të dizenjimit, Teknologji e prodhimit të veshjeve I dhe Teknologjisë së prodhimit-it të veshjeve II. Atelieri i Modëlimit dhe dizenjimit është një investim i ri në jetën e Departamentit të Tekstilit dhe Modës, dhe shërben për lëndët mësimore dhe praktike. Laboratorët janë bashkohore sipas standardeve të teknologjisë më të fundit. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të laboratorëve përcaktohet nga një rregullore dhe dokumentet të tjera në nivel Universiteti dhe Fakulteti. Laboratorët didaktikë kanë një përgjegjës të emëruar nga Drejtuesi i departamentit. Përdorimi i bazës laboratorike në funksion të projekteve kërkimore-shkencore të fituara në departament apo prej grupeve të tij përbërës, saktësohet për çdo rast specifik në fillim të projektit përkatës.</p> <p><b>Ref. 2.12 Rregulbre e mirembajtjes dhe infrastruktures laboratorike.</b></p> <p><b>Ref. 3.06 Inventaret e laboratoffive të DTM.</b></p> <p><b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM. .</b></p> <p><b>Ref. 4.05 Relacion mbi zonimin e ambienteve në shfrytëzim të FIM në korpusin qëndror.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>UPT angazhohet për përmirësimin e cilësisë së sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional, duke synuar paraqitje të plotë, të qartë, të saktë e të përditësuar të informacionit për studentët që lidhet me veprimtarinë e UPT-së, veçanërisht me procesin mësimor. Mirëfunksionimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në nivel institucional u mundëson studentëve kontaktin me tutorin, për të garantuar të drejtat e tyre dhe monitorimin e problemeve të mundshme.</p> <p><b>Ref. 4.10 informimi i studentëve nëpërmjet platformave online</b></p> <p><b>Ref. 3.02 Trajnim per platformen TEAMS</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion</p>	<p>Për një pjesë më të madhe, lëndët që mbulon DTM, pedagoget përkatës kanë literature baze tekst mësimor ne gjuhën shqipe si dhe leksione te</p>

<p>të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>shkruara nga pedagoget e lendeve, dhe literature ne gjuhe te huaj (tekste). Për të gjitha lëndët pedagogët kanë gjithashtu në formë të shkruar në shqip ushtrime dhe problema për pjesën e ngarkesës Seminare. DTM vazhdimisht azhuron literaturën brenda programit të studimit të lëndëve përkatëse. Përputhshmëria e literaturës me programin lëndor (syllabusin) është e plotë. Literatura bazë dhe ndihmëse I vihet në dispozicion studentëve në gjuhën e programit të studimit, cka garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin e studimit, dhe i pasqyrohet atyre në syllabuset.</p> <p><i>Në bazë të raportit të paraqitur nga institucioni, GVJ, rekomandon mbulimin e të gjitha disiplinave me tekste bazë, në gjuhën shqipe, pasi sic është paraqitur dhe në GVB, jo të gjitha lëndët kanë literaturë bazë në gjuhën shqipe.</i></p> <p><b>Raporti i vleresimit te brendshem</b>  <b>Ref. 4.07 Liçenca e Modaris për DTM, F. U</b>  <b>Ref. 4.08 Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës Shkencore 2017-2020</b>  <b>Ref. 4.09 informacion mbi Bibliotekat në UPT.</b>  <b>Ref. 4.10 informimi i studentëve nëpërmjet platformave online.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe koModë për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>Në dispozicion të studentëve të programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Mode është edhe biblioteka shkencore e UPT. Hapësira e saj fizike është e konsiderueshme referuar numrit të përdoruesve dhe vendeve të studimit, po ashtu edhe cilësia e studimit dhe llojet e shërbimit që kjo bibliotekë iu ofron studentëve për të siguruar literaturën e nevojshme. Kjo bibliotekë është më e pasura në vend përse i përket literaturës tekniko-shkencore që ajo mbart. Fondi i saj mbart rreth 121 mijë tituj me vlera të veçanta studimore dhe historike. Fondi i bibliotekës shkencore të UPT, gjatë periudhës 2017-2020, është zgjeruar me 2105 njësi bibliotekare dhe 605 tituj të rinj. Çdo vit, njësitë bazë, bëjnë kërkesat e reja për literaturë pranë bibliotekës, për të krijuar përputhshmëri me literaturën e kurrikulave mësimore dhe të kërkimit shkencor (si një nevojë kjo e përditësimit të kurrikulave me zhvillimet e reja në shkencë dhe teknologji).</p> <p><b>Ref. 4.08: Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore 2017-2020</b>  <b>Ref. 3.07 Tekste të miratuara të programit Bsc në Inxhinieri Tekstile e Mode</b>  <b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka shkencore në UPT ka zgjeruar fondin e saj me 2105 njësi bibliotekare dhe me 605 tituj të rinj, duke disponuar kështu rreth 121 mijë tituj. Totali i kapacitetit të bibliotekave është 341 vende studimi dhe koleksionin prej 121 mijë titujsh në shkencat teknike dhe programet e studimit që ofron UPT. (<a href="https://biblioteka-shkencore.edu.al/">https://biblioteka-shkencore.edu.al/</a>).</p> <p>Pasurimi i bibliotekës i shërben procesit mësimor dhe kërkimit shkencor në UPT. Literatura në gjuhën shqipe dhe të huaj pasurohet nëpërmjet blerjeve, shkëmbimeve ndërbibliotekare, projekteve dhe dhuratave me biblioteka universitare dhe bibliotekave të institucioneve nga vende të ndryshme të botës. <b>Biblioteka Digjitale</b> (<a href="https://ulibrari.rash.al/">https://ulibrari.rash.al/</a>), <b>COBISS:</b> <a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries">https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries</a>).</p>

	<p><b>Ref. 4.08: Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore 2017-2020</b>  <b>Ref. 4.09: Informacion mbi Bibliotekat në UPT.</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike zhvillon aktivitetin, duke përdorur në mënyrë të përbashkët me dy njësi të tjera kryesore dhe me Rektoratin e Universitetit Politeknik të Tiranës dy godina, godinën e Korpusit Qendror të UPT dhe godinën e Shtesës së Korpusit Qendror të UPT. FIM shfrytëzon sipërfaqen prej 6567.5 m<sup>2</sup>. Sallat e leksioneve janë 8 (tetë), me një sipërfaqe totale e tyre është 639.52 (gjashtëqind e tridhjetë e nëntë pikë pesëdhjetë e dy) m<sup>2</sup>. Janë gjithsej 15 salla seminaresh me sipërfaqe totale 663.17 m<sup>2</sup>. Në ambient disponohet edhe një sallë për aktivitete promovuese me sipërfaqe 130 m<sup>2</sup>.</p> <p>Fakulteti zotëron 11 (njëmbëdhjetë) laboratore për lëndët dhe një laborator informatike, në total 912.36 (nëntëqind e dymbëdhjetë pikë tridhjetë e gjashtë) m<sup>2</sup> në këtë godinë.</p> <p>DTM ka këto laboratorë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a. Laboratori Fiziko – Mekanik i Tekstilit dhe lëkures</li> <li>b. Laboratori Kimik i tekstilit dhe lëkurës</li> <li>c. Laboratori i CAD/CAM dhe Teknologjisë së prodhimit të Veshjeve</li> <li>d. Atelier e Modës dhe Dizenjimit</li> </ol> <p>2. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të laboratorëve përcaktohet nga kjo Rregullore dhe dokumentet të tjera në nivel Universiteti dhe Fakulteti.</p> <p>3. Laboratorët didaktikë kanë një përgjegjës të emëruar nga Drejtuesi i departamentit.</p> <p>4. Përdorimi i bazës laboratorike në funksion të projekteve kërkimore-shkencore të fituara në departament apo prej grupeve të tij përbërës, saktësohet për çdo rast specifik në fillim të projektit përkatës.</p> <p>5. Përdorimi i bazës laboratorike jashtë mjedisve të departamentit autorizohet paraprakisht nga drejtuesi i njësisë bazë (DTM) si dhe nga titullari përgjegjës i atij laboratorit.</p> <p>Raporti i sipërfaqes m<sup>2</sup>/student në ambientet e dy godinave ku zhvillon aktivitetin FIM (të përmendura më sipër) është 4.7 m<sup>2</sup>/student. Normativa 5 m<sup>2</sup>/student, e përcaktuar për IAL e profileve inxhinierike sipas legjislacionit në fuqi arrihet duke marrë në konsideratë pjesën proporcionale të ambienteve në përdorim në nivel institucioni siç janë FIM ka një raport 1 (një) pedagog për 17 studentë, që tejkalon dy herë normativën 1 pedagog për jo më shumë se 35 (tridhjetë e pesë) studentë.</p> <p>Infrastruktura në dispozicion të FIM siguron kushte të kënaqshme pune për studentët dhe pedagogët, <i>por hapësirat në mjediset e fakultetit që i takojnë një studentit janë shumë më të vogla se ato që garantojnë nga universitetet homologe jashtë vendit, megjithëse vitin e fundit me rikonstruksionin e përfunduar të godinës së FIM hapësira në dispozicion e infrastrukturës është shumë më e përmirësuar.</i> Për këtë, GVJ rekomandon zgjerimin e hapësirave për të arritur standartet ndërkombëtare.</p> <p><b>Ref. 2.12 Rregullore e mirembajtjes dhe infrastruktures laboratorike.</b></p>

	<p><b>Ref. 3.06 Inventaret e laboratoffive të DTM.</b>  <b>Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM. .</b>  <b>Ref. 4.05 Relacion mbi zonimin e ambienteve në shfrytëzim të FIM në korpusin qëndror.</b></p>		
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Përdorimi i platformës digjitale Microsoft Teams ka sjellë edhe një komunikim më intensiv midis personelit akademik dhe studentëve. Komunikimi i studentëve me titullarët e lëndëve bën të mundur shkëmbimin realizimin e konsultave, dhënien e literaturës, dorëzimin e detyrave, oraret e leksioneve, seminareve, laboratorëve, oraret e provimeve, notat e provimeve, etj. Kjo platformë mundëson komunikimin interaktiv të personelit me studentët.</p> <p><b>Ref. 4.18 Llogari në MS Teams pedagogu dhe studenti.</b></p>		
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>Si personeli akademik, ashtu dhe studentët janë të pajisur me adresë e-maili dhe me kode të aksesimit të sistemit elektronik duke siguruar në këtë mënyrë akses të informacionit. Sistemi i menaxhimit përmban informacione rreth programeve lëndore, kurseve, sezoneve të provimeve, orareve, listave të studentëve të regjistruar etj. Nëpërmjet sistemit bëhet e mundur edhe aksesimi i dokumentave e procesverbaleve për studentët për sezonet e caktuara.</p> <p><b>Ref. 4.18 Llogari në MS Teams pedagogu dhe studenti.</b></p>		
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Bazuar ne “Ligji Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Shkencën në Republikën e Shqipërisë”. 2.2 VKM Nr 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë” (ndryshuar me VKM 879 datë 18.12.2019).”, institucioni ka hartuar një procedurë mbi zhvillimin e diplomës, që përcakton vendosjen e kushteve për mënyrën e konceptimit, formulimit dhe mbrojtjes të Punimit të Diplomës, në programet e e ciklin të parë të studimeve (Bachelor) në FIM, si dhe të rishikimit të saj. Kjo procedurë zbatohet nga Departamentet që mbulojnë një program studimi, dhe nga studentët diplomantë në periudhën e përgatitjes së temës të Punimit të Diplomës dhe gjatë mbrojtjes së tij. Drejtuesi i Departamentit krijon fondin e temave të diplomave sipas propozimeve të stafit akademik dhe numrit të studentëve në vitin akademik përkatës, duke pasur parasysh: - temat përcaktohen dhe miratohen mbasi Departamenti ka bërë një analizë të nevojave dhe fushave të ekspertizës; - punimi i diplomës së ciklit të parë të studimeve është në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera, studim literature në fushat e programit përkatës të studimit.</p> <p>Të gjithë pedagogët, gjithashtu stafi akademik mbështetës asiston dhe ndihmon studentët për zhvillimin e diplomave.</p> <p><b>Ref. 4.14 Ngritja e komisioneve të provimeve.</b>  <b>Ref. 4.15 Ngritja e komisioneve të mbrojtjes së diplomave. (n.d.)</b></p>		
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
			X

**Standardi III.4**

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>UPT që synon përsosjen dhe konsolidimin e formimit akademik dhe zgjidhjen e problemeve të rëndësishme kërkimore dhe shkencore në shkallë vendi dhe rajoni. Bazuar në planin strategjik të tij, mbi statutin, rregulloret e programit, dhe organigrama, me një staf akademik profesionist dhe me aktivitet të gjerë shkencor, impakton në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Gjithashtu dhe në bazë të politikave, zyrave e drejtorive, institucioni synon ecurinë e mësimdhënies dhe shpërndarjes së dijes tek studentët.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b>  <b>Ref. 1.16 Organigrama e FIM.</b>  <b>Ref. 6.04 Këshillat e Progra meve të Studimit dhe Koordinatorët.</b>  <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT.</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Drejtuesi i Departamentit, përgjegjës për programin e studimit, cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat formuese të tij. Koordinatori i programit të studimit informon vazhdimisht drejtuesin e njësisë përkatëse për të gjitha problematikat, i cili bashkëpunon dhe koordinon aktivitetet me strukturat përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit, në përputhje me rregulloren e njësisë bazë dhe kryesore. Gjithashtu ai siguron që dokumentacioni bazë i programit të studimit, përditësimin e planit mësimor dhe sylabuset në fillim të çdo viti akademik, si dhe siguron që materialet didaktike të jenë të disponueshme dhe lehtësisht të aksesueshme për studentët, në format letër ose elektronik në fillim të zhvillimit të lëndës. Koordinatori bashkëpunon me drejtuesin e departamentit për koordinimin e aktiviteteve për kryerjen e analizës vjetore dhe rishikimin e programit të studimit dhe merr pjesë në organizimin etakimeve me palët e interesuara për të kryer studime të tregut të sotëm të punës në lidhje me kompetencat në dalje që duhet të fitojnë të studentët. Koordinatori është drejtues për organizimin, mbarëvajtjen monitorimin e praktikave profesionale të studentëve në përputhje me Rregulloren e FIM të mësimin dhe procedurës përkatëse për organizimin dhe kryerjen e praktikave profesionale të miratuara në DFIM. Për plotësimin e këtij objekti, institucioni promovon dhe mbështet bashkëpunimet ndërkombëtare në nivel njësie bazë nëpërmjet dhënies së çmimeve/ shpërblimeve vjetore nga Rektori për personelin akademik dhe studentët, që kanë dhënë kontribut të shquar në promovimin e UPT në arenën ndërkombëtare.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b></p>

	<p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b>  <b>Ref. 1.16 Organigrama e FIM. .</b>  <b>Ref. 1.17 Plani mesimor.</b>  <b>Ref. 6.04 Këshillat e Progra meve të Studimit dhe Koordinatorët.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Forcimi dhe zgjerimi i bashkëpunimit shkencor dhe i kërkim-zhvillimit të UPT me qendrat kërkimore jo universitare jashtë dhe brenda vendit. Nxitja institucionale për rritjen e numrit të programeve të përbashkëta të studimit është pjesë e strategjisë institucionale të ndërkombëtarizimit.</p> <p>Objekti i rezultateve të nxënies të studenteve, është dhe rezultat i bashkëveprimit Student – Pedagog dhe programeve të lendeve. Ndihe dhe madhe janë në këtë drejtim burimet laboratorike që në kemi ku studenti praktikon njohuritë e nxena në auditor, në formën e laboratorëve, punëve praktike, praktikave mësimore.</p> <p><b>Ref. 1.21 Analiza vjetore mesimore-kerkimore e DTM.</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Bazuar në strategjinë e institucionit, personeli akademik kualifikohet në mënyrë të vazhdueshme për rritjen profesionale të tij. Ky kriter arrihet duke siguruar dhe duke zhvilluar marrëveshje të vazhdueshme me institucionet dhe universitetet homologe Evropiane dhe më gjerë përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit dhe projekteve të përbashkëta në fushat me interes të përbashkët në shërbim të kualifikimit shkencor, doktoratave, postdoktoratave, dhe shkëmbimi i eksperiencave në këto fusha.</p> <p>UPT gjatë viteve ka intensifikuar bashkëpunimin shkencor me partnerët homologë ndërkombëtarë (konferenca të përbashkëta, projekte, etj), për rritjen e njohjes ndërkombëtare të veprimtarive akademike të zhvilluar nga stafi. Universiteti inkurajon pjesëmarrjen e stafit akademik dhe ndihmës në programet Evropiane të bashkëpunimit Erasmus plus, H2020 dhe më gjerë . Një rol të rëndësishëm luan dhe promovimi i botimeve kërkimore në gjuhë të huaja në buletin e botuar nga UPT për të rritur faktorin e tyre të ndikimit në arenën ndërkombëtare. Si njësi bazë DTM ka një eksperiencë të gjatë e të konsiderueshme përsa i përket kualifikimit të vazhdueshëm të personelit. Eksperiencat e mobiliteteve erasmus u konfirmuan nga vetë stafi akademik i pranishëm në takimet me grupin e vlerësimit të jashtëm e po ashtu edhe CV e personelit e tregojnë qartë këtë. Në rubrikën Erasmus+Mobilities 2017-2020 renditet lista me 83 personel nga stafi akademik dhe ndihmës akademik, ku përfshihen edhe stafi akademik i DTM. Në të përfshihet edhe lloji i mobiliteteve si: trajnime, mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p> <p>Shembuj të stafit akademik të DTM si pjesë e Mobiliteteve Erasmus+</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• T.K Koordinator në projektet Erasmus</li> <li>1. 2014 - 2023 “Gheorghe Asachi” Technical University of Iasi and Polytechnic University of Tirana, Albania.</li> <li>2. 2014 – 2023 FH Bielefeld Germany and Polytechnic University of Tirana, Albania.</li> <li>3. 2019 – 2021 Trakia University Bulgaria and Polytechnic</li> </ul>



	<p>University of Tirana, Albania</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>4. 2020 - 2023 TTK University of Applied Sciences (TTK UAS) and Polytechnic University of Tirana, Albania.</li> <li>5. 2020 - 2023 University of Eastern Macedonia – Greece and Polytechnic University of Tirana, Albania.</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>• S. S</li> </ul> <p>Programi Erasmus +</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. 05.06 - 09.06.2017 Staff mobility for training to the Faculty of Mechanical Engineering, Technical University of Sofia, Bulgaria</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>• M. Q</li> </ul> <p>Erasmus +</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Staff Mobility for Teaching and Training. May 20 until May 24 of 2019, University of East Attica, Greece.</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I. K</li> </ul> <p>Erasmus+,</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. PhD Exchange Student , 01.06.2016 – 30.11.2016, Faculty of Engineering and Architecture, Department of Materials, Textile and Chemical Engineering, Ghent University, Belgium</li> <li>2. Staff Mobility for Training. (02.09 – 08.09). 2018, University of East Attica (UNIËA), Greece</li> <li>3. Staff Mobility for Teaching, 21.11.2019 – 27.11.2019, Faculty of Engineering and Mathematics, Fachhochschule Bielefeld, Germany</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>• I. K</li> </ul> <p>COORDINATOR OF ERASMUS+ KA107:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. University of East Attica, Athinë, Greece, 2020- 2027</li> <li>2. Technical University of Liberec, Czech Republic, 2014-2023</li> <li>3. University of Applied Science, Faculty of Arts and Creative Technologies (FACT), Vilnius, Lithuania 2020- 2023.</li> <li>4. University of Zagreb, Faculty of Textile 2021-2030.</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>• E Sh</li> </ul> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. May 2017 ERASMUS+ Project, Key Action 1– Mobility for learners and staff – Higher Education Student and Staff Mobility - Inter-institutional agreement 2014-20[21] between institutions from program and partner countries, Polytechnic University of Tirana and Technical University of Sofia, Pjesemarrje me prezantim Dhjetor 2017</li> <li>2. ERASMUS+ Project, KA1, Mobility for learners and staff – Higher Education Student and Staff Mobility - Inter-institutional agreement 2014-20[21] , University of Piraeus, Greece, Teaching Mobility 1 ëek, Pjesemarrje me prezantim 2016 – Vazhdim</li> <li>3. Koordinatore e Projektit Erasmus+, Textile and Fashion Department and Ëestsachsische Hochschule Zëickau, University of Applied Science Zëickau</li> </ol> <ul style="list-style-type: none"> <li>• B. K</li> </ul> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Erasmus +, STAFF MOBILITY FOR TEACHING and TRAINING for one ëek. November 2019, Bielefeld University,</li> </ol>
--	---


Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 49




	<p>Germany.</p> <p>2. Erasmus +, STAFF MOBILITY FOR TEACHING and TRAINING for one week. March 2019, Zwickau University, Germany.</p> <p>3. Erasmus +, STAFF MOBILITY FOR TEACHING and TRAINING. For one week, MOctober 2018 Pireus University, Grece.</p> <p>4. Erasmus +, STAFF MOBILITY FOR TEACHING and TRAINING. June 5 untill june 11 of 2016, University of Ghent, Belgium.</p> <p><b>Ref. 1.21 Analiza vjetore mesimore-kerkimore e DTM.</b>  <b>Ref. 1.24 Mareveshje ne UPT</b>  <b>Ref. 1.19: Mobilitetet Erasmus të Stafit</b>  <b>Ref. 2.01: CV e Personelit Akademik.</b>  <a href="https://www.fim.edu.al/pro/erasmus">https://www.fim.edu.al/pro/erasmus</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitet përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p>	<p>Personeli i Departamentit të Tekstilit dhe Modës përbëhet nga personeli akademik, personeli ndihmës akademik me karakter mësimor dhe administrativ. Personeli akademik gëzon status të veçantë, në përputhje me përcaktimin e të ligjit të arsimit të lartë në fuqi, dhe akteve nënligjore në fuqi. Personeli akademik gëzon liri akademike në këto drejtime të veprimitarisë së tij:</p> <p>a) Mësimdhënie  b) Punë kërkimore – shkencore;  c) Kontribut institucional  d) Kontribut profesional</p> <p>Personeli akademik ka mundësi të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, duke shfrytëzuar edhe përdorimin e metodave dhe eksperiencave të përftuara gjatë periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+ KA1 dhe trajnimeve të herëpashershme nga lektorë të ftuar.</p> <p>Si njësi bazë DTM ka një eksperiencë të gjatë e të konsiderueshme për sa i përket kualifikimit të vazhdueshëm të personelit. Eksperiencat e mobiliteteve erasmus u konfirmuan nga vetë stafi akademik i pranishëm në takimet me grupin e vlerësimit të jashtëm e po ashtu edhe CV e personelit e tregojnë qartë këtë. Në rubrikën Erasmus+Mobilities 2017-2020 83 pjesëtarë të stafit akademik dhe ndihmës akademik, ku përfshihen edhe stafi akademik i DTM, kanë kryer mobilitete nderkombëtare, si dhe trajnime, mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p> <p><b>Ref. 1.19 Mobilitetet Erasmus te stafit. .</b>  <b>Ref. 1.21 Analiza vjetore mesimore-kerkimore e DTM.</b>  <b>Ref. 1.24 Mareveshje ne UPT.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe përmirësimin e mësimdhënies, që fillon që në momentin me hartimin e syllabusit të lëndës, duke përfshirë metodat e mësimdhënies për secilën temë. Mësimi behet i kombinuar përmes leksioneve, ushtrimeve, kontrolleve, problemave, laboratorëve, etj. Leksionet zhvillohen duke kombinuar prezantimin me video projektor dhe duke përdorur tabelën me</p>

implementimin e metodave të reja.	shkumës dhe fshirëse ose me lapustil, metode kjo e fundit, është cilësuar nga nje pjesë e stafit pedagogjik, si nje metodë e mirë. <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b>			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	UPT garanton zhvillimin e karrierës së personelit akademik, në respekt të lirisë akademike, meritës dhe në përputhje me kornizën ligjore në fuqi, si dhe mundëson kualifikimin e vazhdueshëm të personelit ndihmës-akademik dhe administrativ. Personeli akademik ka lirinë të testojë metoda të reja në mësimdhënie, dhe duke qenë se silabuset e lëndëve rishikohen çdo vit, ka mundësi të reflektojë përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e përdorimit të tyre në përmirësimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies tek studentët. <b>Ref. 1.19 Mobilitetet Erasmus te stafit. .</b> <b>Ref. 1.21 Analiza vjetore mesimore-kerkimore e DTM.</b> <b>Ref. 1.24 Mareveshje ne UPT</b> <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b> <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi III.5</b>	
<b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Objekti i kësaj procedure është përcaktimi i mënyrës së kontrollit dhe vlerësimit të dijeve në FIM. Qëllimi është përcaktimi i rregullave dhe mënyrës së realizimit të kontrollit të dijeve për të arritur në një vlerësimi objektiv dhe të paanshëm të studentit. Kjo procedurë është në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Kontrolli i dijes në një lëndë bëhet në mënyrë të vazhdueshme, i shtrirë përgjatë kohës së zhvillimit të lëndës, duke përdorur forma të ndryshme. Mënyra e organizimit të provimit përfundimtar është në funksion të natyrës së disiplinës (lëndës). Ajo përcaktohet nga titullari i lëndës, mbështetur në programin e lëndës dhe miratohet nga drejtuesi i departamentit. Mënyra e organizimi të kontrollit të dijeve shprehet në programin e lëndës dhe i bëhet e njohur studentit në fillim të procesit mësimor. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, përkthehet në notë. Instrumentet e vlerësimit përbëhet nga këta elementë: <ol style="list-style-type: none"> <li>1. provimeve me shkrim e me gojë,</li> <li>2. detyrave të kursit,</li> <li>3. projekteve</li> <li>4. testeve gjatë semestrit</li> <li>5. kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike</li> </ol> Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues

Adresa: "Rruga e Durrësit" , Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423



web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 51

	<p>dhe të kompetencave profesionale. Metodot e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Instrumente në kontrollin e vazhdueshëm, para provimit përfundimtar. Kriteret e vlerësimit përcaktohen nga titullari i lëndës dhe pasqyrohen në programin e lëndës. Shprehja në përqindje e vlerësimit në kontrollin e vazhdueshëm në rezultatin përfundimtar:</p> <p>5-10 % për detyrën/at e kursit 5-10% për projektin e kursit 5-10 % provime të ndërmjetme 5-10 % për shlyerjen e laboratorëve 75 – 85% provimi përfundimtar</p> <p>Studenti fiton të drejtën e hyrjes në provimin e një lënde, kur ka plotësuar kriteret detyruese të vendosura për atë lëndë, e ka frekuentuar jo më pak se 75%, të lëndës, si dhe ka mbrojtur 100% detyrimet për praktikatat mësimore, punët laboratorike, para fillimit të sesionit të provimeve.</p> <p>Provimet zhvillohen brenda periudhave të caktuara në strukturën mësimore të vitit akademik. Datat e tyre propozohen nga sekretaritet mësimore dhe zëvendësdekani i FIM për veprimtarinë mësimore, në bashkëpunim me departamentet, miratohen nga dekani dhe shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të periudhës së provimeve.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Mënyra e organizimi të kontrollit të dijeve shprehet në programin e lëndës dhe i bëhet e njohur studentit në fillim të procesit mësimor. Instrumentet e vlerësimit përbëhet nga këta elementë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. provimeve me shkrim e me gojë,</li> <li>2. detyrave të kursit,</li> <li>3. projekteve</li> <li>4. testimet gjatë semestrit</li> <li>5. kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike</li> </ol> <p>Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale. Metodot e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				X

**Standardi III.6****Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p>	<p>Kontrolli i dijeve është procesi që shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit nga studenti. Instrumentet e vlerësimit përbëhet nga këta elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• provimeve me shkrim e me gojë,</li> <li>• detyrave të kursit,</li> <li>• projekteve</li> <li>• testimet gjatë semestrit</li> <li>• kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike</li> </ul> <p>Kriteret e vlerësimit përcaktohen nga titullari i lëndës dhe pasqyrohen në programin e lëndës. Shprehja në përqindje e vlerësimit në kontrollin e vazhdueshëm në rezultatin përfundimtar:</p> <p>5-10 % për detyrën/at e kursit  5-10% për projektin e kursit  5-10 % provime të ndërmjetme  5-10 % për shlyerjen e laboratorëve  75 – 85% provimi përfundimtar</p> <p>Mënyra e organizimit të provimit përfundimtar është në funksion të natyrës së disiplinës (lëndës), dhe përcaktohet nga titullari i lëndës, mbështetur në programin e lëndës dhe miratohet nga drejtuesi i departamentit. Mënyra e organizimi të kontrollit të dijeve shprehet në programin e lëndës dhe i bëhet e njohur studentit në fillim të procesit mësimor.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni ka venë në përdorimin platformën e Microsoft teams në versionin “prezantues – auditor” ku përcaktohen detyrat dhe privilegjet e ndryshme për pjesëmarrësit në takim. Qellimi I ketij udhezuesi eshte perdorimi I aplikacionit MS Teams ne procesin mesimor prane FTI. Disa nga aktivitetet me te rendesishme qe mund te organizohen permes kesaj platforme jane:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Bashkebisedim me studentet e lendes suaj,</li> <li>• ngarkimi i materialeve didaktike,</li> <li>• kalendar,</li> <li>• takime online,</li> <li>• testimet online,</li> <li>• dorezim detyrash,</li> <li>• regjister notash per detyrat</li> <li>• e shume opsione te tjera.</li> </ul> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive</p>	<p>Dekanati i FIM merr masat e nevojshme për organizimin e sezoneve të provimeve, si dhe kontrollon vazhdimisht zbatimin e rregullave të</p>

<p>profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>përcaktuara në këtë procedurë. Provimet organizohen mbi bazën grupeve mësimore të studentëve. Ato zhvillohen në orën, datën dhe auditorin e caktuar, të cilat reflektohen në orarin e provimeve, të shpallur dy javë para fillimit të sesionit. Studentët vlerësohen në provimin e lëndës nga një komision i vlerësimit me jo më pak se dy pedagogë: lektori i lëndës dhe pedagogë të tjerë të përfshirë në mësimdhënien e lëndës. Komisionet e provimit të lëndës ngrihen nga Drejtuesi i Departamentit dhe i dërgohen Dekanatit për informim, jo më vonë se një javë nga fillimi i sezonit të provimeve. Nëse lënda është zhvilluar nga një pedagog, drejtuesi i departamentit cakton një anëtar tjetër të stafit akademik, të afërt me atë disiplinë.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 4.14 Ngritja e komisioneve të provimeve.</b>  <b>Ref. 4.15 Ngritja e komisioneve të mbrojtjes së diplomave. (n.d.).</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Institucioni ka hartur rregulloren e procedurën e posaçme për vlerësimin e dijeve, e përpiluar në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies në UPT. Rregullorja përcakton rregullat dhe mënyrën së realizimit të kontrollit të dijeve për të arritur në një vlerësimi objektiv dhe të paanshëm të studentit, dhe gjithashtu duke garantuar infrastrukturë të posaçme e sa më të duhur për të zhvilluar cdo provim. Forma e provimit me shkrim, bëhet e sekretuar dhe tezat e provimit, hartohen nga lektori i lëndës, së bashku me asistentin e tij, dhe miratohen e nënshkruhen nga drejtuesi i departamentit.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 4.14 Ngritja e komisioneve të provimeve. .</b>  <b>Ref. 4.15 Ngritja e komisioneve të mbrojtjes së diplomave. (n.d.).</b>  <b>Ref. 5.01 Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit, para plotësimit të fletës së provimit. Studenti sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose paraqet pretendimet e tij për rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit sqaron studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur.</p> <p><b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 4.14 Ngritja e komisioneve të provimeve. .</b>  <b>Ref. 4.15 Ngritja e komisioneve të mbrojtjes së diplomave. (n.d.).</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime</p>	<p>Deknati i FIM merr masat e nevojshme për organizimin e sezoneve të provimeve, si dhe kontrollon vazhdimisht zbatimin e rregullave të përcaktuara në këtë procedurë. Provimet organizohen mbi bazën grupeve</p>

<p>dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>mësimore të studentëve. Ato zhvillohen në orën, datën dhe auditorin e caktuar, të cilat reflektohen në orarin e provimeve, të shpallur dy javë para fillimit të sesionit.  <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve. Komisioni bën me dije studentin për rezultatin e vlerësimit, para plotësimit të dokumentacionit përkatës sipas pikës 10 (formulari "Fleta e provimit"). Studenti sqarohet për çdo paqartësi nga ana e tij ose paraqet pretendimet e tij për rezultatin e marrë. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>UPT, ka ngritur një strukturë të vecantë për trajtimin dhe përmirësimin e cilësisë së insitucionit, që është drejtoria e sigurimit të brendshëm të cilësisë. Kjo drejtori ka hartuar një Plan Veprimi mbështetur mbi rezultatet e sondazheve studentore të organizuar nga DSBC, që ndërton proceset e sigurimit të brendshëm të cilësisë në universitet. Nëpërmjet këtij plani bëhet e mundur përkthimi i rezultateve të sondazheve në problematika me të cilat hasen studentët, dhe mbi bazën e tyre parashikohen veprimet e nevojshme që duhet të ndërmerren në çdo njësi të UPT. Studenti ka të drejtë të ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet me proces verbal të firmosur nga Dekani dhe Zv. Dekani për veprimtarinë mësimore.  <b>Ref. 1.06 Rregullorja e FIM.</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti ka të drejtë të kërkojë përmirësimin e notës. Një veprim i tillë lejohet kur vlerësimi me notë që kërkon të përmirësojë studentin është e një lëndë të vitit akademik që ai sapo ka mbyllur. Studenti ka të drejtë të përmirësojë çdo vit mësimor vetëm dy vlerësime me notë. Në bazë të vendimit që merr dekani, sekretaria mësimore kryen veprimet përkatëse. Studenti mund të përmirësojë vetëm vlerësimin e marrë në provim, i cili i bashkëngjitet vlerësimeve të marra në elementet e tjerë të lëndës përgjatë vitit akademik. Studenti ka të drejtë të ankohet, në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat procedurale gjatë zhvillimit të provimit ose nuk është dakord me vlerësimin e bërë. Ankesa, nëpërmjet formularit të ankesës për provimin e lëndës depozitohet me shkrim në sekretarinë e dekanit, brenda një afati prej 3 ditë pune nga shpallja e rezultatit. Kjo ankesë shqyrtohet nga Dekani dhe Zv. Dekani për veprimtarinë mësimore, të cilët mund të thërrasin për sqarime drejtuesin e departamentit përkatës, komisionin e vlerësimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të çështjes, merret vendimet e caktuara. Procedura e ndjekur për</p>

	zgjdhjen e ankesës, si dhe vendimi i marrë, dokumentohet me proces verbal të firmosur nga Dekani dhe Zv. Dekani për veprimtarinë mësimore. <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit Bachelor në Inxhinieri Tekstile e Modë, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, studim, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor),</li> <li>• studim individual (studim, punim relacionesh detyrash apo projektsh), përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës, veprimtari të tjera, si praktika profesionale.</li> </ul> <p>Për ecurinë sa më të mirë e të qendrueshme, programi i studimit i përmbahet disa parimeve si:</p> <p>a) Temat janë të hapura dhe jo të ngurta, duke u dhënë mundësinë studentëve të kontribuojnë me njohuritë e tyre, si dhe të ngrënë shqetësimet që kanë. Psh. hulumtimi i aftësive sipërmarrëse nga studentët dhe diskutimi i tyre në klasë duke i ballafaquar me aftësitë e veta, krahasuar me një listë të aftësive sipërmarrëse, nuk kanë të njëjtin efekt për edukimin në karrierë të nxënësit.</p> <p>b) Trajtimi i temave bëhet sipas nivelit të përgatitjes dhe kuptimit të studentit, duke i dhënë mundësinë gjithsecilit student të përfitojë e kontribuojë.</p> <p>c) Temat dhe trajtimi i tyre janë aktuale dhe përshtaten me kërkesat e tregut.</p> <p>d) Kompetencat zhvillohen duke përfshirë partnerët socialë dhe palët e tjera të interesit. Praktikrat profesionale në biznes janë një rast i shkëlqyer që studentët të zhvillojnë kompetencat për menaxhimin e karrierës. Po ashtu përfshirja e zyrave të punës, firmave rekrutuese, individëve qoftë prindër apo njerëz të tjerë të sukseshëm është një tjetër formë e mirë.</p> <p>e) Studentët e ndjejnë përparimin, duke akumuluar dhe përmirësuar vit pas viti kompetencat e tyre për menaxhimin e karrierës</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b> <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale,</p>	<p>UPT përcakton zhvillon dhe konsolidon mënyrat e kontrollit të dijeve të studentëve sipas parimeve të meritës dhe paanshmërisë.</p> <p>Njohuritë teorike e ato praktike e zhvillojnë studentin profesionalisht për të qenë të aftë për t'u përfshirë në tregun e punës.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 56



<p>komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Përveç lëndëve specifike e të lidhura direkt më fushën e studimit, zhvillimi i lëndëve të tjera si në fushën e IT, shkencat humane, gjuhët e huaja, synojnë në kompletimin e dijeve të studentit. Sistemi i njohurive që ofrohet nga ky program dhe kompetencat që përfitojnë studentët nëpërmjet tij, u mundësojnë atyre edhe ndjekjen e një karriere kërkimore apo akademike nëpërmjet vazhdimit të studimeve të ciklit të dytë, duke rritur kështu mundësinë e karrierës së tyre profesionale.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Kontrolli i dijeve në FIM synon që të vlerësojë në mënyrë të shkallëzuar (me notë) studentët, duke siguruar një mjedis të përshtatshëm për verifikimin e dijeve të studentit. Për ti motivuar studentët drejt formës sistematike të të mësuarit, pedagogu përdor format e kontrollit të vazhduar, duke identifikuar pikat e dobëta në të kuptuarin e lëndës nga studenti. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës, ku pedagogu shqyrton me studentët problematika, analiza ne esetë/ detyrat e kurseve.</p> <p><b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>Kontrolli i dijeve, që shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit nga studenti, zhvillohet përmes disa instrumentëve që përbëhet nga këta elementë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• provimeve me shkrim e me gojë,</li> <li>• detyrave të kursit,</li> <li>• projekteve</li> <li>• testimëve gjatë semestrit</li> <li>• kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike</li> </ul> <p>Kriteri i vlerësimit përshkruan atë çfarë pritet të bëhet nga studenti dhe në çfarë niveli, me qëllim demonstrimin e arritjeve të objektivave formues dhe të kompetencave profesionale. Metodot e vlerësimit janë strategjitë, teknikat, mjetet dhe instrumentet për grumbullimin e informacionit për të përcaktuar masën, në të cilën studenti demonstroi përvetësimin e objektivave formues e të kompetencave profesionale të programit. Studentët orientohen para testimëve të pjesshme dhe përfundimtare, në mënyrë që të fokusohen te çështjet më të rëndësishme të lëndës. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme të cilat do t'u nevojiten studentëve, nëpërmjet konsultave. Kontrolli i dijes në një lënde bëhet në mënyrë të vazhdueshme, i shtrirë përgjatë kohës së zhvillimit të lëndës, duke përdorur forma të ndryshme të kontrollit. Instrumente në kontrollin e vazhdueshëm, para provimit përfundimtar:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Detyra Kursi</li> <li>• Projekte kursi</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Provime të ndërmjetme (testimeve gjatë semestrit)</li> <li>• Kontrolli i relacioneve të punëve laboratorike</li> </ul> <p>Shprehja në përqindje e vlerësimit në kontrollin e vazhdueshëm në rezultatin përfundimtar:</p> <p>5-10 % për detyrën/at e kursit  5-10% për projektin e kursit  5-10 % provime të ndërmjetme  5-10 % për shlyerjen e laboratorëve  75 – 85% provimi përfundimtar</p> <p>Pedagogu i lëndës i komunikon studentit, në orën e fundit të mësimi:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të drejtën e futjes ose jo në provim;</li> <li>• nivelin e pikëve të fituara në format e tjera të kontrollit të vazhdueshëm.</li> <li>• Kriteret e vlerësimit përfundimtar.</li> </ul> <p><b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b>  <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</b>  <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Pedagogët sipas fushës së tyre të studimit zhvillojnë leksione të hapura, të cilat mbahen si në kuadër të lëndëve të caktuara të programit të studimit, ashtu edhe si aktivitete ekstrakurrikulare, dhe janë të hapura për t'u ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik. Gjithashtu në këto aktivitete marrin pjesë dhe lektorë të ftuar nga universitetet ndërkombëtare, gjë e cila ndihmon në shkëmbimin e informacionit mbi risitë në këto fusha kërkimi.</p> <p>Disa prej tyre janë si më poshtë:</p> <p><b>Dr. Georgios Belokas</b> from UNIVERSITY ĘEST ATTICA (UNIĘA), GREECE, visited Polytechnic University of Tirana (UPT), Albania from <b>01.07.2019 to 05.07.2019</b></p> <p><b>Prof. Assoc. Dr. Marios Valavanides</b> from UNIVERSITY ĘEST ATTICA (UNIĘA), GREECE, visited Polytechnic University of Tirana (UPT), Albania from <b>01.07.2019 to 05.07.2019</b></p> <p><b>Professor Ioannis KIOUSOPOULOS</b> visited our premises in Polytechnic University of Tirana (UPT), Albania from <b>19/11/2019 to 23/11/2019</b></p> <p>PhD. Eng. Bogdan SARGHIE, Lecturer at "Gheorghe Asachi" Technical University of Iasi, Faculty of Textile-Leather and Industrial Management, Romania, visited Polytechnic University of Tirana, Albania, in the period 28.04.2019 – 04.05.2019 in the frameçork of the ERASMUS+ Inter-Institutional existing Agreement. Tema: "Gheorghe Asachi" Technical University of Iasi, Faculty of Textile-Leather and Industrial Management"</p> <p>Leksion i hapur me temë "Tregu dhe Prodhimi i Modës" nga Gianni De Biasi, CEO i CNT LAB 30.05.2019.</p> <p>Leksion i hapur me temë "Përpunimi i Lëkurës dhe prodhimi i Këpucëve" nga Kriton Mito, CEO i Caterina Firenze Mirto Sh.p.k 19.04.2019.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 58

	<p><b>Ref. 3.09 Tabelë përmbledhëse që pasqyron aktivitetet për kërkimin shkencor të stafit.</b></p> <p><b>Ref. 3.10 Leksione të hapura.</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Disa nga parimet për realizimin e edukimit për karrierë janë:</p> <p>a) Temat janë të hapura dhe jo të ngurta, duke u dhënë mundësinë studentëve të kontribuojnë me njohuritë e tyre, si dhe të ngrenë shqetësimet që kanë. Psh. hulumtimi i aftësive sipërmarrëse nga studentët dhe diskutimi i tyre në klasë duke i ballafaquar me aftësitë e veta, krahasuar me një listë të aftësive sipërmarrëse, nuk kanë të njëjtin efekt për edukimin në karrierë të nxënësit.</p> <p>b) Trajtimi i temave bëhet sipas nivelit të përgatitjes dhe kuptimit të studentit, duke i dhënë mundësinë gjithsecilit student të përfitojë e kontribuojë.</p> <p>c) Temat dhe trajtimi i tyre janë aktuale dhe përshtaten me kërkesat e tregut.</p> <p>d) Kompetencat zhvillohen duke përfshirë partnerët socialë dhe palët e tjera të interesit. Praktikrat profesionale në biznes janë një mundësi që studentët të zhvillojnë kompetencat për menaxhimin e karrierës.</p> <p>e) Studentët e ndjejnë përparimin, duke akumuluar dhe përmirësuar vit pas viti kompetencat e tyre për menaxhimin e karrierës</p> <p>Gjithashtu përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, për të kontribuar në formimin e tyre profesional, rritjen e shkallës së përvetësimit të programeve mësimore, orientimin e tyre në tregun e punës, inicimin e tyre si kërkues të ardhshëm si dhe për të realizuar objektivat e kërkimit. Kjo gjë arrihet gjithashtu nëpërmjet shkrimit të artikujve shkencor të përbashkët pedagog-student, gjë që ndihmon më së miri në kuptimin dhe implementimin e aspekteve teorike në fushë studimi.</p> <p><b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b></p> <p><b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</b></p> <p><b>Ref. 2.09 Artikuj shkencore me autore studentet</b></p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p> <p><b>Ref. 1.20 Mobilitetet Erasmus te studenteve</b></p> <p><b>Ref. 1.21 Analiza vjetore mesimore-kerkimore e DTM</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Personeli akademik nxit bashkëpunimin ndërmjet studentëve dhe punën në grup të tyre, ku studentët zhvillojnë punë në grupe prej 2-3 vetash, në bazë të temave të përcaktuara më parë, vecanërisht ato të punëve laboratorike, duke kuptuar procese të ndryshme të mësimin. Gjithashtu në rregulloren e insitucionit janë të përfshira dhe diploma që mund të punohen nga një grup studentësh, pavarësisht se nota është individuale. Kjo gjë lejon dhe favorizon punën në grup, komunikimin dhe bashkëpunimin, por mbi të gjitha shkëmbimin e informacionit dhe dijeve midis studentëve.</p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimi</b></p> <p><b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b></p> <p><b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</b></p>

	<b>Ref. 2.09 Artikuj shkencore me autore studentet</b> <b>Ref. 2.04 Modeli i diplomes</b>			
<b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.	Personeli akademik inkurajon përfshirjen e studentëve, në punën kërkimore shkencore. Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor, për të kontribuar në formimin e tyre profesional, rritjen e shkallës së përvetësimit të programeve mësimore, orientimin e tyre në tregun e punës, iniciimin e tyre si kërkues të ardhshëm si dhe për të realizuar objektivat e kërkimit. Kjo gjë arrihet gjithashtu nëpërmjet shkrimit të artikujve shkencor të përbashkët pedagog-student, gjë që ndihmon më së miri në kuptimin dhe implementimin e aspekteve teorike në këtë fushë studimi. Gjithashtu hartimi i një plani të zhvillimit të aftësive praktike të studentëve për çdo program studimi, me fokus në zhvillimin eficient të praktikave profesionale për studentët, si dhe zbatimi i tyre, si dhe zgjerimi i internship për studentët e UPT, e rritja e bashkëpunimit me biznesin dhe Alumnin për realizimin e praktikave profesionale të studentëve, favorizojnë një klimë të përshtatshme për përfitim të dijeve në rrafshin praktik të teorisë. <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b> <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</b> <b>Ref. 2.09 Artikuj shkencore me autore studentet.</b>			
<b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.	UPT promovon dhe rrit rolin e tij në procesin e zhvillimit të shoqërisë, përmes transferimit të teknologjisë dhe informacionit, si edhe shërbimeve për territorin dhe komunitetin. UPT nëpërmjet koordinimit dhe zhvillimit të projekteve kërkimore në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, promovon kërkimin shkencor bazë dhe të zbatuar, duke nxitur përfitim të njohurive më të përparuara shkencore dhe teknologjike. Gjithashtu UPT promovon inovacionin në mësimdhënie në një mjedis ku qendra është studenti, duke shfrytëzuar gjerësisht potencialin e teknologjive të reja në mësimdhënie. Nëpërmjet ngritjes profesionale, kualifikimit dhe specializimit të mëtejshëm e të vazhdueshëm të stafit akademik, transferimit dhe përcjelljen e njohurive bashkëkohore tek studentët si dhe përfshirjen e tyre në veprimtari kërkimore të përbashkëta apo dhe individuale. <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b> <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</b>			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Shkëmbimet e personelit akademik në universitetet partnere perëndimore, në kuadër të projekteve Erasmus + KAL, mundësojnë rritjen e shkëmbimit të eksperiencës dhe përfitim prej praktikave më të mira, të cilat adaptohen nga personeli akademik pas rikthimit në UPT, dhe të trasmetohen si pjesa tjetër e stafit, dhe mbi të gjitha tek studentët. <b>Ref. 1.01_AL_Statuti i UPT.</b> <b>Ref. 1.02 Plani Strategjik 2019-2024 i UPT</b> <b>Ref. 1.19 Mobilitetet Erasmus te stafit</b> <b>Ref. 1.21 Analiza vjetore mesimore-kërkimore e DTM</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	
			<b>X</b>	

<b>Standardi III.8</b>	
<b>Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Institucioni ka hartuar një rregullore të posaçme për mbrojtjen e diplomës. Objekti i kësaj procedure është vendosja e kushteve për mënyrën e konceptimit, formulimit dhe mbrojtjes të Punimit të Diplomës, në programet e e ciklin të parë të studimeve (Bachelor) në FIM, si dhe të rishikimit të saj. Kjo procedurë zbatohet nga Departamentet që mbulojnë një program studimi, dhe nga studentët diplomantë në periudhën e përgatitjes së temës të Punimit të Diplomës dhe gjatë mbrojtjes së tij. Kjo procedurë është në përputhje me Rregulloren e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies. UPT, sipas kriterëve dhe lidhjeve për arsimin ka një version të 2 të mbi punimn e diplomës. Versioni i 2të i procedurës për konceptimin, dhe mbrojtjen e diplomës në programet e ciklit të parë të studimeve në FIM, ka pasqyruar ndryshimet në Ligjin “Për Arsimin e Lartë dhe Shkencën në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet nënligjore për organizimin dhe elementët e programit të studimit në Institucionet e Arsimit të Lartë.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b>  <b>Ref. 2.04 Modeli i diplomes.</b>  <b>Ref. 2.10 Procedura FIM-P006- Konceptimi dhe mbrojtja e diplomes</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Zyra e Karrierës është një nga stukturat e cila ka marrëdhënie të drejtëpërdrejta me studentët dhe problematikat e sfidat që ata hasin në jetën e tyre studentore. Kjo zyrë ka për detyrë tju ofrojë studentëve mbështetje për mënyrën e marrjes së informacionit lidhur me cdo event që fakulteti zhvillon, adresimin e kërkesave dhe ankesave që studentët mund të kenë si dhe për përmbushjen e të drejtave dhe detyrimeve që ata kanë. Në këtë kuadër Zyra e Karrierës ka realizuar disa aktivitete me qëllim përmbushjen e detyrës së saj si një strukturë dedikuar studentëve. Këto aktivitete janë të pasqyruara në tabelën e mëposhtme.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Takime informuese me studentët në kuadër të projektit Gradua: Informimi i studentëve në prag diplomimi Bachelor dhe Master dhe orientimi i tyre për mënyrën e plotësimit të pyetësorit në platformën Gradua</li> <li>• Takim online me kompanitë dhe bizneset me të cilat UPT ka marrëveshje bashkëpunimi: Informimi dhe diskutimi lidhur me mundësitë dhe kapacitetet për punësim/intership</li> <li>• Takim me kompaninë Deloitte: Lancimi i rezultateve te vrojtimit me teme “Hapat e parë në tregune punës”</li> <li>• Hartimi i databazës së kompanive dhe institucioneve me të cilat FIM ka marrëveshje bashkëpunimi: Mbledhja e të dhënave për kompanitë dhe institucionet me të cilat FIM ka marrëveshje bashkëpunimi.</li> </ul> <p>Per periudhën 15 Prill 2021-15 Mars 2022, Zyra e Karrierës në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 61

	<p>periudhën ka zhvilluar 18 aktivitete.</p> <p><b>Ref. 1.14 Veprimtarite e zyres se karrieres.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Dekani i FIM është përgjegjës për të kontrolluar nëse kjo procedurë zbatohet gjatë realizimit të procesit të përgatitjes dhe mbrojtjes së diplomës në programet e ciklit të parë të studimit në FIM. Drejtuesit e Departamenteve janë përgjegjës:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• krijimin e fondit të temave të diplomave për çdo vit akademik; shpalljen e temave potenciale të punimit të diplomës;</li> <li>• përcaktimin e studentëve që do të kryejnë diplomën;</li> <li>• ngritjen e komisionit të mbrojtjes së diplomës;</li> <li>• kontrollin përfundimtar të punimit të diplomës.</li> </ul> <p>Udhëheqësi i punimit të diplomës ka përgjegjësinë e drejtimit të punës për realizimin e punës praktike, aplikative si edhe për orientimin e studentit diplomant në shfrytëzimin e literaturës së duhur.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b>  <b>Ref. 2.04 Modeli i diplomes.</b>  <b>Ref. 2.10 Procedura FIM-P006- Konceptimi dhe mbrojtja e diplomes</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>Sipas rregullores së përcaktuar mbi mbrojtjen e diplomës, dhe duke ndjekur gjithashtu dhe procedurën e duhur sipas rregullores, personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave. Sipas rregullores, udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij, të cilat studenti duhet ti respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen e punimit të diplomës. Sipas grafikut të konsultimeve të programuara, studenti konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë, sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studenti. Drejtuesi i Departamentit cakton Koordinatorin e Programit të Studimit (ose një pedagog tjetër), për organizimin e kontrolleve të ndërmjetme të punimeve të diplomave. Nëpërmjet kontrolleve të ndërmjetme kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e saj. Përgjatë këtyre kontrolleve rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të temës së diplomës, të cilat nuk përmbysin thelbin e punimit, por studenti dhe udhëheqësi duhet t'i marrin parasysh rekomandimet e kontrollit.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b>  <b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b>  <b>Ref. 2.04 Modeli i diplomes.</b>  <b>Ref. 2.10 Procedura FIM-P006- Konceptimi dhe mbrojtja e diplomes</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Drejtuesi i Departamenteve të FIM krijon fondin e temave të diplomave sipas propozimeve të stafit akademik nëpërmjet Koordinatorit të Programit të Studimit dhe temat përcaktohen dhe miratohen pasi Departamenti ka bërë një analizë të nevojave dhe fushave të ekspertizës. Pas krijimit të fondit të temave të diplomave dhe udhëheqësve respektive, Drejtuesi i Departamentit i miraton ato në Dekanatin e FIM dhe vijon me shpalljen e tyre. Studenti diplomant ka të drejtë të zgjedhë një (ose më</p>

	<p>shumë) temë preferenciale. Në rastin e temave të diplomave të cilat përfshijnë disiplina të tjera, Departamenti bashkëpunon me Departamentet e tjerë në FIM ose UPT, Qendra Kërkimi në Shqipëri ose jashtë saj, me të cilat FIM dhe Departamentet e tij kanë projekte të përbashkëta dhe bashkëpunim shkencor, duke asistuar në këtë mënyrë studentët për zhvillimin e metodave, përpunimin e të dhënave, të përfutuara në terren, si dhe analizimin e tyre, për interpretimin sa më analitik. <b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet) asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Punimi i diplomës së ciklit të parë të studimeve konsiston në formën e një projekti apo përmbledhjeje punimesh të kryera, studim literature në fushat e programit përkatës të studimit. Në temë e diplomës përmbahen kërkesa, mënyra e shtrimit të të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së studimit, të tregojë aftësitë e tij për të zgjidhur elementë të veçantë të detyrave projektuese ose/dhe zbatuese, probleme të prodhimit apo për të punuar me literaturën në fushën përkatëse. Tema e diplomës është pjesë e fushës së kërkimit apo ekspertizës të çdo pedagogu dhe/ose e punës kërkimore – shkencore të Departamentit në bashkëpunim me qendra të tjera kërkimore – shkencore. Studenti mund të zhvillojë një teme diplome që mund të jetë e lidhur me disiplina të përafërta, në kuadër të programit të studimit. Studenti e zhvillon punimin e diplomës nën drejtimin e një udhëheqësi të miratuar. Udhëheqësi i diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij. Studenti duhet të respektojë afatet e vendosura për të bërë të mundur mbrojtjen e punimit të diplomës. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë, sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit. Drejtuesi i Departamentit cakton Koordinatorin e Programit të Studimit (ose një pedagog tjetër), për organizimin e kontroleve të ndërmjetme të punimeve të diplomave. Kontrollat e ndërmjetme janë jo më pak se 2 (dy) për çdo sesion mbrojtje të diplomave. Nëpërmjet kontroleve të ndërmjetme kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e saj. Përgjatë këtyre kontroleve mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të temës së diplomës, të cilat nuk përmbysin thelbin e punimit. Studenti dhe udhëheqësi mund t'i marrin parasysh rekomandimet e kontrollit. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur tezën e diplomës, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës dhe ka kryer kontrollat në nga personeli akademik i caktuar nga Drejtuesi i Departamentit. Para mbrojtjes së punimit të diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit, duke firmosur në formularët P06-F01 dhe P06-F02. Personeli akademik i caktuar për kontrollin e punimit të diplomës, plotëson në formularin e miratimit (P06-F01) informacionin për kontrollat e punimit të diplomës, për çdo student. Modëli i kapakut të diplomës (P06-F02) dhe formularit të miratimit (P06-F01) janë pjesë e kësaj procedure dhe publikohen në</p>

	<p>faqen ueb të FIM, për t'u aksesuar nga studentët diplomantë.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Studenti e mbron tezën e diplomës para një komisioni të posaçëm, dhe me mbrojtje publike. Komisioni propozohet nga Drejtuesi i Departamentit dhe miratohet nga Dekani i FIM. Numri i anëtarëve të komisionit të mbrojtjes së diplomave është 3 (tre) – 5 (pesë), dhe komisioni i diplomës respekton, procedurën dhe rregullat përkatëse, të përcaktuara në rregulloren e programit të studimit dhe në këtë procedurë. Komisioni i mbrojtjes së diplomave funksionon kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e komisionit. Në përfundim të çdo seance të mbrojtjes së punimeve të diplomave, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo studentit diplomant notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij, ku nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Nota regjistrohet në proces-verbalin e mbrojtjes së diplomave, I cili firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.</p> <p><b>Ref. 1.07 Rregullorja e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 1.08 Rregullorja e program te studimit</b></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Sipas statutit dhe rregullores së programit, në përfundim të kursit të plotë të programit të studimit, studentët kanë të drejtë të diplomohen në fushën e arsimimit të kryer. Çdo student në vitin e tretë të programit të studimit bachelor në FIM ka të drejtën e marrjes së një teme diplome, e cila ofrohet nga Departamenti që mbulon atë program studimi, pasi ka plotësuar të gjitha detyrimet përkatëse në lidhje me mbrojtjen e temës, dhe pasi ka zhvilluar të gjithë procedurën dhe hapat për mbrojtjen e saj.</p> <p><b>Ref. 4.13 Rregjistrin e leshimit t diplomave</b></p> <p><b>Ref. 5.09 Shëmbull i dosjes së studentit</b></p> <p><b>Ref. 6.07 Rregullore e sekretarisë mësimore e FIM</b></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të kursit të plotë të programit të studimit, studentët kanë të drejtë të diplomohen në fushën e arsimimit të kryer. Çdo student në vitin e tretë të programit të studimit bachelor në FIM ka të drejtën e marrjes së një teme diplome, e cila ofrohet nga Departamenti që mbulon atë program studimi. Kopja elektronike, që përbehet nga një dosje (file) i vetëm në formatin docx, ose pdf, si dokument zyrtar i dorëzohet Dekanit dhe ruhet në arkivin elektronik të FIM. Departamenti është përgjegjës për futjen futjen e të gjithë dosjeve (files) në CD-Rom, të të gjitha punimeve të diplomave që mbrohen në atë sesion. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar dhe sekretaria mësimore harton dhe pajis studentin me suplementin e Diplomës, ku pasqyrohen të detajuara të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht).</p> <p><b>Ref. 4.11 Regjistri themeltar i studentëve.</b></p> <p><b>Ref. 4.13 Rregjistrin e leshimit t diplomave</b></p> <p><b>Ref. 5.09 Shëmbull i dosjes së studentit</b></p> <p><b>Ref. 6.07 Rregullore e sekretarisë mësimore e FIM</b></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të</p>	<p>Sipas rregullores dhe detyrimeve të institucionit, sekretaria mësimore, institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit</p>



dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	të studentit. Në lidhje me procedurat që kryhen për ruajtjen dhe arkivimin e informacionit dhe pajisjen e studentit me informacionin e nevojshëm, institucioni i ka të përcaktuara në dokumenta të veçanta. <b>Ref. 4.11 Regjistri themeltar i studentëve.</b> <b>Ref. 4.12 Rregjistrin e arritjeve akademike.</b> <b>Ref. 4.13 Rregjistrin e leshimit t diplomave</b> <b>Ref. 5.09 Shëmbull i dosjes së studentit</b> <b>Ref. 6.07 Rregullore e sekretarisë mësimore e FIM</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

**IV. NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR  
REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimitor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni në fjalë, pra Departamenti i Tekstitit dhe Modës, si njësi e FIM në UPT, mbledh, ruan dhe përditëson, në çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në këtë program studimi. Struktura e departamentit paraqitet në Listën e pedagogëve të programin BSc, e cila përcillet në Dekanat çdo vit akademik (<b>Ref. 1.22: Lista e pedagogëve të programit Bsc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b>). Të dhënat përfshijnë si anëtarët e personelit akademik pjesë e programit ashtu edhe të personelit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, si dhe të personelit ndihmës. Ndarjen e stafit akademik për çdo vit, ngarkesën mësimore dhe titujt akademik. Këtë e tregon edhe ndarja në grupe mësimore në department (<b>Ref. 4.02: Ndarja e grupeve mësimore në DTM</b>) e po ashtu edhe përcaktimi i pedagogëve kujdestarë për vitet e para, si nga stafi i brendshëm ashtu edhe i jashtëm (<b>Ref. 3.04: Lista e tutorëve për secilin vit të BSc në Inxhinjeri Tekstil dhe Modë</b>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Për rekrutimin e personelit të ri akademik me kohë të plotë, me kohë të pjesshme ose staf ndihmës, Departamenti i Tekstitit dhe Modës zbaton procedurat në përputhje me bazën ligjore dhe me aktet e brendshme rregullatore të institucionit të tilla si: publikimi i njoftimit për hapje konkursi, bashkangjitur kriteret përkatëse së bashku me dokumentacionin. Gjithashtu edhe dokumentimin e përzgjedhjes përfundimtare së stafit. (<b>Ref. 4.01: Kriteret për pedagogë të jashtëm pranë DTM</b>), (<b>Ref. 4.03: Kriteret për staf ndihmës pranë DTM</b>)</p> <p>Shembull i kriterëve të përgjithshme për pedagogë të jashtëm:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Diploma të paktën për dy cikle studimi në fushën përkatëse.</li> <li>2. Të ketë notën mesatare 7.5 të ciklit të parë dhe të dytë të studimeve.</li> <li>3. Të zotërojë me dëshmi një gjuhë të huaj perëndimore</li> <li>4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.</li> </ol> <p>Shembull i kriterëve të veçanta:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të ketë përvojë në fushën e mësimdhënies akademike.</li> <li>2. Të ketë aftësi prezantuese në fushën për të cilën aplikon.</li> </ol> <p>Shembull i kriterëve për staf ndihmës akademik (Teknik laborator)</p> <p>Pasi bëhet përshkrimi i punës, vijojnë kriteret:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Të ketë përfunduar studimet e larta në degën Inxhinjeri Tekstili dhe Mode (cikli i parë dhe i dytë i studimeve) me notë mesatare mbi 7.5)</li> <li>2. Eksperiencë në përdorimin e programeve kompjuterike CAD/CAM për modelimin e veshjeve, mundësisht kualifikime të dokumentuara me certifikata apo dëshmi.</li> </ol>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 66

	<p>3. Gjuhë e huaj e mbrojtur (një nga gjuhët e BE)</p> <p>4. Eksperiencë mësimdhënieje (kriter plotësues)</p> <p>5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Kriteret për pranimin e me konkurim të pedagogëve propozohen nga departamenti, në bazë të nevojave dhe specifikeve. Vendet e lira të punës shpallen nga Institucioni UPT dhe mbas ndjekjes së procedurave përkatëse e në përfundim të tyre shpall fituesit përkatës</p> <p><b>Ref. 4.01: Kriteret për pedagogë të jashtëm pranë DTM</b></p> <p><b>Ref. 4.04: Përzgjedhja e kandidatëve fitues</b></p> <p>Fituesit shpallen edhe në faqen e universitetit.</p> <p>(<a href="http://upt.al/vendepune/1575-fie-fim-shpallja-e-kandidateve-fitues">http://upt.al/vendepune/1575-fie-fim-shpallja-e-kandidateve-fitues</a>.)</p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Tekstilit dhe modës ndjek procedurat e rekrutimit dhe vlerësimit në bazë kritereve të përgjithshme dhe atyre specifike. Kriteret e përgjithshme të punësimit përcaktohen në rregulloren e UPT, ndërsa ato specifiket në rregulloren e njësisë bazë DTM. Kriteret specifike përcaktohen në bazë edhe të nevojave që lindin nga ngarkesa apo mbingarkesa mësimore e stafit dhe lëndët përkatëse, hapësirave të krijuara Departamenti Tekstilit dhe Modës, si njësi bazë, i drejton kërkesën Fakultetit të Inxhinjerisë Mekanike, me qëllim miratimin e hapjes së konkursit përkatës. Me miratimin e hapjes së konkursit Departamenti i Tekstilit dhe Modës shpall kriteret së bashku me afatet kohore në faqen e departamentit, në facebook dhe në faqen e fakultetit. Shpallja e konkursit bëhet në mënyrë paralele edhe nga UPT dhe pritet dorëzimi i dokumentave të kërkuara nga kandidatët. Njësia e burimeve njerëzore të UPT me FIM dhe DTM, si njësi bazë, zhvillojnë procedurën e konkurimit dhe përcaktimin e fituesit. Universiteti pra UPT-ja bën shpalljen e fituesit.</p> <p><b>Ref. 4.04: Përzgjedhja e kandidatëve fitues</b></p> <p>(<a href="http://upt.al/vendepune/1575-fie-fim-shpallja-e-kandidateve-fitues">http://upt.al/vendepune/1575-fie-fim-shpallja-e-kandidateve-fitues</a>.)</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti UPT</b></p> <p><b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM).</b></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </table>		<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				<b>X</b>
	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			<b>X</b>						

<b>Standardi IV.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë eficiente dhe efektive</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Angazhimin institucional të UPT, në lidhje me krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale e shohim së pari në Statusin e UPT, ku në Nenin 2/3 përcaktohet qartë liria akademike që i jepet personelit akademik të UPT:</p> <p>(a) të drejtën për të zhvilluar mësimdhënie, për të kryer kërkim apo krijim pa pasur detyrimin e aderimit në ndonjë doktrinë politike ose fetare të paravendosur;</p> <p>b) të drejtën për të publikuar dhe përhapur kontributet dhe rezultatet e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 67

	<p>mësimdhënies, kërkimit apo krijimit;</p> <p>c) të drejtën e shprehjes së mendimit, duke përfshirë kritikën ndaj shoqërisë, institucioneve, doktrinae, dogmave e opinionëve, si edhe ndaj statutit dhe rregulloreve të UPT, si edhe ndaj politikave qeveritare të arsimit të lartë e kërkimit shkencor, por pa çënuar interesat institucionale dhe në respekt të kodit të etikës së UPT.</p> <p>d) garancinë dhe të drejtën për të zhvilluar veprimtarinë e tij pa qenë subjekt i presionit ose censurës, pavarësisht nga orientimi i të menduarit të tyre, nga mënyra e jetesës, nga përkatësia etnike, gjuha, gjinia, orientimi seksual, aftësia e kufizuar e veprimtarive fizike, mendimi politik ose fetar, moshë dhe gjendja martesore.);</p> <p>Në Nenin 35, përcaktohen të drejtat dhe detyrat e stafit akademik me kohë të plotë; Në Nenin 36, përcaktohen kategoritë e personelit akademik dhe veprimtaritë përkatëse sipas kategorive; Në Nenin 39, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për stafin akademik të ftuar; në Nenin 41, përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë për personelin ndihmës-akademik</p> <p><b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>  <b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>UPT angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm profesional të personelit kryesisht nëpërmjet hartimit të strategjive të ndërkombëtarizimit dhe mobilitetit. Kjo është arritur kryesisht nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit shkencor shumëpalësh (nëpërmjet Mobiliteteve Erasmus+), apo dy palëshe, por edhe nëpërmjet hartimit të projekteve kombëtare për kërkimin shkencor dhe inovacionin. Politikat e kualifikimit të stafit akademik shprehen qartë dhe janë të sanksionuara në Statutin e UPT, përkatësisht në Nenin 68 “Kërkimi shkencor dhe zhvillimi në UPT” dhe në Nenin 83 “Personeli Akademik” (Ref. 1.01: Statuti i UPT). Si njësi bazë DTM ka një eksperiencë të lavdërueshme përse i përket kualifikimit të vazhdueshëm të personelit. Eksperiencat e mobiliteteve erasmus u konfirmuan nga vetë stafi akademik i pranishëm në takimet me grupin e vlerësimit të jashtëm e po ashtu edhe CV e personelit e tregojnë qartë këtë. (Ref. 1.19: Mobilitetet Erasmus të Stafit; Ref. 2.01: CV e Personelit Akademik). Në rubrikën Erasmus+Mobilities 2017-2020 renditet lista me 83 personel nga stafi akademik dhe ndihmës akademik, ku përfshihen edhe stafi akademik i DTM. Në të përfshihet edhe lloji i mobiliteteve si: trajnime, mësimdhënie dhe kërkim shkencor.</p> <p><b>Ref. 1.19 Mobilitetet Erasmus të stafit</b>  <b>Ref. 1.21 Analiza vjetore mesimore-kerkimore e DTM</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>Përveç kërkimit personal të personelit akademik, në rritjen e cilësisë së mësimdhënies nëpërmjet metodave alternative, institucioni UPT ka hartuar një udhëzues për zhvillimin dhe përdorimin e tyre në rang universiteti. Udhëzuesi synon mundësimin e mësimdhënies cilësore në përputhje me programet specifike. Lidhur ngushtë edhe me adaptimin e nevojshëm me metodat e reja të mësimin në distancë si rrjedhojë e kushteve të diktuar nga pandemia.</p> <p>Në vijim të kësaj stafi akademik është trajnuar në përdorimin e disa</p>

	<p>platformave të mësimdhënies online si: Google Meet, Microsoft Teams, Zoom, etj.).</p> <p>Gjithashtu nxitja e kërkimit shkencor nga ana e institucionit çon në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe përdorimin e metodave më efikase. Nxitja e stafit drejt kërkimit shkencor dhe kualifikimit të vazhdueshëm të tij shprehet në Nenin 3 të Statutit “Misioni dhe objektivat institucionale”. Gjithshtu personeli akademik, kryen disa lloje veprimtarish si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• veprimtaritë mësimdhënëse dhe këshilluese për studentët;</li> <li>• veprimtari të kërkimit shkencor;</li> <li>• veprimtari mbështetëse për zhvillimin e UPT dhe shërbime për të tretët (përmendim këtu shërbimet laboratorike ofruar për të tretët);</li> <li>• veprimtari të tjera (transferim teknologjie dhe inovacioni)</li> </ul> <p>Referuar Nenit 71 “Projektet kërkimore-shkencore” të Statutit të UPT-së, personeli akademik i UPT, në përputhje me fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si edhe me programet e zhvillimit të vendit, janë të lirë të grupohen e të hartojnë projekte kërkimore-shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>a) brenda dhe jashtë njësive bazë të UPT;</li> <li>b) në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit;</li> <li>c) të ndjekin procedurat ligjore për shqyrtimin e miratimin e tyre dhe të vihen në dispozicion të zbatimit të tyre me cilësinë e kërkuar.</li> </ol> <p>Drejtuesit e njësive kryesore, në bashkëpunim me Rektoratin e UPT, marrin masa administrative për hartimin dhe realizimin në kohë të detyrave të parashikuara në planin e punës të kërkimit shkencor dhe të financimit të projektit të miratuar, në përputhje me objektivat e zhvillimit, objektivat dhe rezultatet e pritshme të tyre.</p> <p><b>Ref. 1.01. Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 3.01: Udhëzues për zhvillimin e mësimin në distancë</b>  <b>Ref. 3.02: Trajnim për platformën Teams</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Institucioni FIM dhe UPT dëshmon angazhimin e plotë të burimeve njerëzore në përbushjen e objektivave të studimeve të ciklit të parë BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Modë. Këtë e provon dokumentacioni mbi personelin akademik të brendshëm dhe të jashtëm, stafit ndihmës akademik dhe atij administrativ gjatë çdo viti akademik. Në dokumentin “Ngarkesa e stafit akademik”, gjendet edhe procedura e njohjes së ngarkesës në orë mësimore të stafit të pedagogëve për hartimin dhe aplikimin e projekteve. Kjo Procedurë përcakton ngarkesën e njohur për pjesëmarrje për grupet e punës për hartim dhe aplikim të projektit. Njohja si mbingarkesë varet edhe nga rregullat dhe kërkesat e ministrisë përgjegjëse. Për pedagogët me kontratë me kohë të pjesshme zbatohen të njëjtat procedura. Më pas bëhet parashikimi i ngarkesës mësimore të stafit në auditor për vitin akademik, si për stafin e brendshëm ashtu edhe të jashtëm. Në një tabelë të veçantë pasqyrohet edhe ngarkesa totale e personelit akademik për një vit.</p>

	<p>Pjesë e dokumentit të “Ngarkesës mësimore të stafit akademik” është edhe “Deklarimi i ngarkesës së realizuar nga personeli akademik efektiv”. Procedura e “Deklarimit të ngarkesës së realizuar nga personeli akademik efektiv në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike”, përgjatë një viti akademik, është hartuar në zbatim të Nenit 57 pika 3 dhe nenit 59 pika 1 të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Shkencën në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Kjo procedure pasqyron ngarkesën faktike të personelit akademik në veprimtaritë që ai kryen në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike.</p> <p>Qëllimi është:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. të krijojë një standard të matjes së kontributit akademik të stafit efektiv në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike;</li> <li>2. të jetë një instrument nxitës për rritjen profesionale të personelit akademik efektiv në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike;</li> <li>3. të motivojë punën dhe vlerat në mjedisin akademik.</li> </ol> <p>Objekti i kësaj procedure është përcaktimi i mënyrës së deklarimit të përmbushjes së ngarkesës vjetore (1536 orë) të personelit akademik efektiv të punësuar më kohë të plotë (PAE) në FIM.</p> <p>Kjo procedure ka lidhje me veprimtaritë që kryen PAE në FIM që janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mësimdhënie;</li> <li>- Kërkim shkencor;</li> <li>- Kontribut institucional;</li> <li>- Kontribut profesional;</li> </ul> <p>Ngarkesa klasifikohet edhe sipas kategorieve të gradave shkencore</p> <p><b>Ref. 2.02: Ngarkesa mësimore e stafit akademik.</b></p> <p><b>Ref: Statutit të UPT “Misioni dhe objektivat institucionale”.</b></p>								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="587 1131 754 1211"></th> <th data-bbox="754 1131 970 1211">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="970 1131 1185 1211">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1185 1131 1423 1211">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="587 1211 754 1252"></td> <td data-bbox="754 1211 970 1252"></td> <td data-bbox="970 1211 1185 1252"></td> <td data-bbox="1185 1211 1423 1252">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi IV.3</b> <b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit</b>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Institucioni UPT edhe për njësinë bazë DTM siguron mjediset e përshtatshme dhe të mjaftueshme për zhvillimin e veprimtarive përkatëse dhe specifike mësimore. Kjo në lidhje si me mësimdhënien teorike, praktike dhe në përputhje me natyrën specifike programit të studimit e po ashtu edhe me numrin e studentëve e grupeve mësimore. Për realizimin e programit të studimit të BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode për mësimdhënien teorike përdoren sallat e leksioneve dhe seminareve (të cilat janë të përbashkëta për FIM dhe UPT), ndërsa pjesë e DTM janë laboratorët specifike, zyra e informacionit për studentët, mjediset hidrosanitare për studentët. Në bazë të nevojave për mjediset realizohen edhe bashkëpunime me Departamentet e tjera.</p> <p><b>Ref. 4.05: Relacion mbi zonimin e ambienteve në shfrytëzim të FIM</b></p>

	<b>në korpusin qendror)</b>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Mjediset mësimore, për zhvillimin e programit mësimor BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode, të tilla si klasa, laboratorë, etj., janë të pajisura me pajisje të teknologjisë së informacionit për të garantuar realizimin e preocesit mësimor teorik e praktik pëmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Mjediset e leksioneve janë të pajisura kryesisht me videoprojektor, ndërsa në sallat që mungon përdoret një videoprojektor portabël (pajisje të cilën e disponon departamenti për nevojat e mësimdhënies apo veprimtarive të tjera). Këto mjedise dhe pajisjet përkatëse u verifikuan edhe gjatë vizitës së grupit të punës së Vlerësimit të Jashtëm. Gjithashtu bëhen parashikimet e buxhetit në bazë të nevojave të njëjësive bazë për pajisjet e nevojshme për procesin mësimor dhe aprovimi i tyre. Këtu përfshihen pajisje laboratorike, mjete audio-vizive, etj.</p> <p><b>Vizita në institucion</b>  <b>Ref. 4.06: Parashikimi i buxhetit nga DTM).</b>  <b>Ref. 2.12 Rregulbre e mirembajtjes dhe infrastruktures laboratorike</b>  <b>Ref. 3.06 Inventaret e laboratorëve të DTM</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për nga vetë natyra specifike e programit të studimit të Inxhinjerisë së Tekstilit dhe Modës, DTM në mjediset përfshin edhe: 1) Laboratorin fiziko-mekanik dhe 2) kimik të tekstilit dhe lëkurës, i akredituar sipas standardit ISO/IEC 17025; 3) Laboratori i projektimit dhe dizajnit; 4) Laboratori i prodhimit dhe projektimit CAD/CAM të tekstilit dhe këpucëve dhe 5) Laboratori kimik i tekstileve. Çdo laborator përmban pajisjet bazë sipas specifikave përkatëse për zhvillimin me sukses të veprimtarisë mësimore, kërkimore-shkencore, praktikave mësimore për studentët e po ashtu testimet laboratorike për subjekte të tretë (shërbime). Mbështetur edhe në vizitën e bërë në institucion dhe bisedën me stafin akademik u pohua se laboratorët pajisen herë pas here me pajisje të reja bashkëkohore, kjo sipas sipas nevojave e kërkesave dhe mundësive financiare të vetë institucionit.</p> <p><b>(Ref. 1.18: Çertifikata e akreditimit të laboratorit);</b>  <b>(Ref. 3.06: Inventaret e laboratorëve të DTM)</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>Laboratori i prodhimit dhe projektimit CAD/CAM të tekstilit dhe këpucëve i ngritur tërësisht në shërbim të specifakave të programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Mode, është i pajisur me 12 kompjutera (poste pune për studentët). Kompjuterat janë të pajisur me programin e licënsuar Electra Modaris, licensë që e disponon DTM.</p> <p><b>Ref. 3.06: Inventaret e laboratorëve DTM</b>  <b>Ref. 4.07: Licensa e Modaris për DTM</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të</p>	<p>Institucioni UPT, me qëllim zhvillimin e praktikave profesionale apo veprimtarive të tjera praktike të nevojshme për realizimin e programeve në të gjitha fakultetet dhe si rrjedhojë edhe të njëjësive bazë (në këtë rast DTM), përveç mjediseve të veta të vëna në dispozicion të procesit mësimor, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione</p>

përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.	private dhe shtetërore. (Gjithashtu përveç marrëveshjeve institucionale, ekzistojnë edhe marrëveshje në nivel Fakulteti (FIM). DTM zotëron pesë laboratore në ambientet përkatëse të cilat janë në dispozicion të programit të studimit të njësisë bazë për aktivitetin mësimdhënës-mësimnxënës, punën kërkimore-shkencore, praktikat mësimore dhe profesionale dhe të aktiviteteve të tjera mbështetëse. <b>Ref. 3.06: Inventaret e laboratorëve të DTM)</b> <b>Ref. 1.13: Marrëveshje UPT-PEA</b> <b>Ref. 1.24: Marrëveshje të UPT</b> <b>Ref. 6.06: Vendimi Nr. 2</b>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <tr> <td><b>Plotësisht përmbushet</b></td> <td><b>Përmbushet pjesërisht</b></td> <td><b>Përmbushet kryesisht</b></td> <td><b>Përmbushet plotësisht</b></td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>	<b>Plotësisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>				X
<b>Plotësisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>						
			X						

<b>Standardi IV.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Në dispozicion të studentëve të programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Mode është edhe biblioteka shkencore e UPT. Kjo bibliotekë është ndër më të mëdhatë në UPT për nga fondi i madh i saj dhe nga shumëllojshmëria e literaturës. Hapësira e saj fizike është e konsiderueshme referuar numrit të përdoruesve dhe vendeve të studimit, po ashtu edhe cilësia e studimit dhe llojet e shërbimit që kjo bibliotekë iu ofron studentëve për të siguruar literaturën e nevojshme. Kjo bibliotekë është më e pasura në vend për sa i përket literaturës tekniko-shkencore që ajo mbart. Fondi i saj mbart rreth 121 mijë tituj me vlera të veçanta studimore dhe historike. Fondi i bibliotekës shkencore të UPT, gjatë periudhës 2017-2020, është zgjeruar me 2105 njësi bibliotekare dhe 605 tituj të rinj. Çdo vit, njësitë bazë, bëjnë kërkesat e reja për literaturë pranë bibliotekës, për të krijuar përputhshmëri me literaturën e kurrikulave mësimore dhe të kërkimit shkencor (si një nevojë kjo e përditësimit të kurrikulave me shvillimet e reja në shkencë dhe teknologji). <b>Ref. 4.08: Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore 2017-2020</b>
<b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Biblioteka shkencore në UPT ka zgjeruar fondin e saj me 2105 njësi bibliotekare dhe me 605 tituj të rinj, duke disponuar kështu rreth 121 mijë tituj. (. Rrjeti i bibliotekave në UPT përbëhet nga Biblioteka Shkencore me tre degët e saj në fakultete dhe nga tre biblioteka që administrohen nga jësitë kryesore (FIE, FAU, IGJEUM). Totali i kapacitetit të bibliotekave është 341 vende studimi dhe koleksionin prej 121mijë titujsh në shkencat teknike dhe programet e studimit që ofron UPT. Literatura e Bibliotekës së UTP, që u ofrohet studentëve, është multidisiplinare ( <a href="https://biblioteka-shkencore.edu.al/">https://biblioteka-shkencore.edu.al/</a> ). Pasurimi i bibliotekës i shërben procesit mësimor dhe kërkimit shkencor në UPT. Literatura në gjuhën shqipe dhe të huaj pasurohet nëpërmjet blerjeve, shkëmbimeve ndërbibliotekare, projekteve dhe dhuratave me biblioteka

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 72



	<p>universitare dhe bibliotekave të institucioneve nga vende të ndryshme të botës. Biblioteka Shkencore e UPT ka siguruar edhe një sasi të konsiderueshme titujsh digjitalë për të plotësuar nevojën dhe kërkesat për literaturë shkencore. për këtë i referohemi Portalit të Bibliotekës Digjitale. Gjithashtu çdo department ka një minibibliotekë ku sistemon literaturën që disponon.</p> <p><b>Ref. 4.08: Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore 2017-2020),</b>  <b>Ref. 4.09: Informacion mbi Bibliotekat në UPT)</b>  (<a href="https://ulibrari.rash.al/">https://ulibrari.rash.al/</a>),  COBISS: <a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries">https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries</a> ).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Në mënyrë për të krijuar kushte për akses të barabartë dhe pa pagesë për studentët, në UPT është funksional sistemi online COBISS. Ky system përfshin një rrjet të gjerë bibliotekash dhe bën të mundur krijimin e një sistemi të përbashkët katalogimi. Në këtë mënyrë përdoruesi mund të aksesojë online secilën bibliotekë dhe ta shfrytëzojë katalogun në distancë. Ky system është i aksesueshëm në (<a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries">https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries</a>). Ky system katalogimi dhe kërkimi (Co-operative Online Bibliographic System and Services) është funksional prej vitit 2019. Gjithashtu ofrohet shërbimi i bibliotekës digjitale (<a href="https://ulibrari.rash.al/">https://ulibrari.rash.al/</a>). Kjo bibliotekë në formë digjitale mundëson aksesin me një databazë prej mbi 193 mijë libra akademikë, mbi 50 mijë revista shkencore, mbi 200 milion lajme shkencore, 30 paketa për mësimin e gjuhëve të huaja. Nëpërmjet COBISS studentët mund të lidhen online edhe me 15 biblioteka universitare, 10 biblioteka publike dhe 3 biblioteka speciale në 11 qytete të Shqipërisë (<a href="https://ulibrari.rash.al/">https://ulibrari.rash.al/</a>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Njësisia bazë DTM ka vënë në dispozicion të studentëve dhe të stafit pedagogjik ambientet e laboratorit për përdorimin e kompjuterave me qëllim shfrytëzimin e literaturës në Portalin e Bibliotekës Digjitale të ofruar nga UPT. Gjithashtu studentëve u mundësohet shfrytëzimi i literaturës shtesë që zotëron vetë departamenti e po ashtu edhe shfrytëzimin e arkivës ndër vite të diplomave, detyrave të kursit apo projekteve.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Biblioteka, ashtu siç edhe pohuam më sipër ka një fond të pasur me tituj shkencorë. Gjithashtu planifikimi për pasurimin dhe përditësimin me zëra të rinj është një prioritet që pasqyrohet edhe si zë i buxhetit të Universitetit. Kërkesat për titujt e rinj mbledhen çdo vit në njësitë kryesore në bazë të nevojave dhe përditësimeve të nevojshme shkencore dhe metodike. Pasurimi i fondit të bibliotekës me 605 tituj të rinj dhe zgjerimi i tij me 2105 njësi bibliotekare Brenda një periudhe 2017-2020 e dëshmon më së miri këtë. Gjithashtu, tekste mësimore bazë, të hartuara nga stafi akademik i DTM, apo monografi, shkrime akademike, etj., janë bërë pjesë e fondit të bibliotekës të depozituara aty me dëshirë nga vetë pedagogët.</p> <p><b>Ref. 3.07: Tekste të miratuara të programit Bsc në Inxhinjeri Tekstile e Modë)</b>  <b>Ref. 4.08: Pasurimi i koleksionit të Bibliotekës shkencore 2017-2020).</b></p>

<p><b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>UPT ka një rrjet bibliotekash që përbëhet nga Biblioteka Shkencore dhe shtatë prej tyre janë të vendosura pranë njësive kryesore. Kapaciteti i ofruar prej tyre arrin deri në 341 vende dhe 121 mijë titujt që ofron janë të profilizuara në fushat e studimit që ofron UPT. Studentët pajisen me kartelën e regjistrimit nga biblioteka dhe oraret e Bibliotekës shpallen në institucion dhe janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre. Për t'ju përgjigjur më mirë nevojave të studentëve, përtej kohës së procesit mësimor, Biblioteka Shkencore ofron mundësinë e materialeve të ndryshme në rrugë elektronike online. (<a href="https://ulibrari.rash.al/">https://ulibrari.rash.al/</a>) (COBISS: <a href="https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries">https://plus.al.cobiss.net/opac7/libraries</a>) Gjithashtu për studentët vihet në dispozicion edhe literatura e minibibliotekës së DTM. <b>Ref. 4.09: Informacion mbi Bibliotekat në UPT</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

<p><b>Standardi IV.5</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Administrimi i të gjithë informacionit në lidhje me studentët dhe aktivitetin apo ecurinë e tyre që nga regjistrimi e deri në diplomim kryhet nga Sekretaria mësimore e FIM e cila manaxhon dhe informacionin nga Departamenti me Institucionin e UPT. Sekretaria mësimore e FIM mban në formë të shkruar rregjistrin themeltar të studentëve. Përveç shkresave, fletëve të detyrimeve dhe fletëve të provimeve, studentët mund të përdorin systemin elektronik të të dhënave për marrjen e informacionit mbi datat e provimeve, notat dhe vlerësimet në provime, datat e mbrojtjes së diplomave apo mbi detyrimet e pashlyera. Departamenti DTM afishon në tabelat e jashtme ekspozitore të FIM (Kati 3, godina qendrore) temat e ofruara për punimet e diplomave, sipas të cilave çdo student ka të drejtë përzgjedhjen e deri 3 temave sipas prioriteteve të veta. Më pas DTM, bën ndarjen dhe aprovimin përfundimtar të temave të diplomave dhe nëpërmjet shkresës së në dijeni dekanatin e FIM dhe sekretarinë mësimore. Dekanati në çdo sezon të mbrojtjes së diplomave informon departamentet mbi datat e mbrojtjes së diplomave dhe departamenti cakton datat në bazë të komisioneve të ngritur dhe numrit të studentëve të lejuar për mbrojtje diplome. Gjithashtu, sekretaria dhe departamenti i financës në FIM bëjnë edhe verifikimin e shlyerjes së detyrimeve përfundimtare të studentëve. Vendorsja e platformave digjitale Microsoft Teams, të aktivizuara me rastin e pandemisë edhe nga UTP për zhvillimin e procesit mësimdhënës dhe mësimnxënës shërbeu edhe për komunikime të tjera me studentët si: komunikimin dhe njoftimin e</p>

	<p>orareve të leksioneve, seminareve, seanceve laboratorike, literaturën bazë, oraret e provimeve, regjistrimet, notat e provimeve, etj. Gjithashtu, sekretaria mësimore, stafi akademik dhe studentët përdorin platformën digjitale të sekretarisë mësimore. (<a href="https://www.upt.pitagora.rash.al/">https://www.upt.pitagora.rash.al/</a>)</p> <p>UPT dhe FIM u mundëson si personelit akademik, ndihmës akademik dhe studentëve adresa zyrtare të e-mailit. Nëpërmjet të cilave mundësohet aksesi për platformën Microsoft Teams. Faqja zyrtare e FIM dhe UPT u ofron studentëve informacion të gjerë dhe të përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet e nevojshme.</p> <p>(<a href="https://fim.edu.al/">https://fim.edu.al/</a>)</p> <p>(<a href="https://www.upt.al/">https://www.upt.al/</a>)</p> <p><b>Ref. 4.11: Regjistri themeltar i studentëve); regjistrin e arritjeve akademike</b></p> <p><b>Ref. 4.12: Regjistri i arritjeve akademike); Regjistrin e lëshimit të diplomave</b></p> <p><b>Ref. 4.13: Regjisti i lëshimit të diplomave</b></p> <p><b>Ref. 4.14: Ngritja e komisioneve të provimeve</b></p> <p><b>Ref. 4.15: Ngritja e komisioneve të mbrojtjes së diplomave</b></p> <p><b>Ref. 3.01: Udhëzues për zhvillimin e mësimin online</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Sistemi i brendshëm i menaxhimit në UPT, administron informacionin, dokumentacionin, aktivitetet e personelit akademik, ndihmës akademik, atij administrative dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit, nëpërmjet dy strukturave të paralele të menaxhimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. Këto struktura janë menaxhimi akademik dhe menaxhimi ekonomiko-financiar që bashkëpunojnë për arritjen e objektivave strategjike të përcaktuara në Planin Strategjik të UPT për vitet 2019-2024, si në nivelin e organeve kolegjiale ashtu edhe në nivelin e autoriteteve respektive. Në mbyllje të çdo viti akademik, DTM si njësi bazë përditëson aktivitetet mësimore, aktivitetet kërkimore-shkencorë të stafit akademik, pasqyrimin e ngarkesës mësimore sin ë auditor edhe jashtë tij, pjesëmarrjen në aktivitete shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare, botimi i atikujve në aktivitete kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrja në projekte individuale ose në grup brenda departamentit ose jashtë tij.</p> <p><b>Ref. 2.07 FIM-P004- deklarimi i ngarkesës.</b></p> <p><b>Ref. 1.21 Analiza vjetore mesimore-kerkimore e DTM.</b></p> <p><b>Ref. 2.01 CV e personelit akademik.</b></p> <p><b>Ref. 4.16 Raport i aktivitetit mësimor (në nivel njësis dhe universiteti Ref. 4.17 Raport i aktivitetit kërkimor shkencor (në nivel njësis dhe universiteti.</b></p> <p><b>Ref. 1.02: Plani strategjik i UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Pajisja me adresë e-maili (fim.edu.al) dhe me kode të aksesimit të sistemit elektronik të të gjithë personelit dhe e studentëve tregon qartë se sistemi i menaxhimit (sekretaria mësimore) siguron akses të informacionit. Sistemi i menaxhimit përmban informacione rreth programeve lëndore, kurseve, sezoneve të provimeve, orareve, listave të</p>

	studentëve të regjistruar etj. Nëpërmjet sistemit bëhet e mundur edhe aksesimi i dokumentave e procesverbaleve për studentët për sezonet e caktuara.								
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Përdorimi i platformës digjitale Microsoft Teams ka sjellë edhe një komunikim më intensiv midis personelit akademik dhe studentëve. Komunikimi i studentëve me titullarët e lëndëve bën të mundur shkëmbimin realizimin e konsultave, dhënien e literaturës, dorëzimin e detyrave, oraret e leksioneve, seminareve, laboratorëve, oraret e provimeve, notat e provimeve, etj. Kjo platformë mundëson komunikimin interaktiv të personelit me studentët. <b>Ref. 4.18 Llogari në MS Teams pedagogu dhe studenti).</b>								
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	Nëpërmjet platformës digjitale Microsoft Teams, llogarive personale (fim.edu.al), faqeve zyrtare, sistemi i menaxhimit garanton monitorimin në kohë reale aktivitetit akademik dhe administrative. Kjo bën të mundur edhe raportimet individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtues dhe titullarët. ( <a href="https://fim.edu.al/">https://fim.edu.al/</a> ) ( <a href="https://www.upt.al/">https://www.upt.al/</a> )								
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në faqen zyrtare të UPT dhe FIM të gjitha informacionet që publikohen në lidhje me programin e studimit, personelit akademik, aktivitetet të ndryshme janë në dy gjuhë, në gjuhën shqipe dhe në anglisht. ( <a href="https://fim.edu.al/">https://fim.edu.al/</a> ), ( <a href="https://www.upt.al/">https://www.upt.al/</a> ) Vetë Departamenti i Inxhinjerisë së Tekstilit dhe Modës si njësi bazë e FIM/UPT, disponon faqen e vetë zyrtare në ëeb. ( <a href="https://www.upu-tekstimoda.org/ep/sq/kryesore/">https://www.upu-tekstimoda.org/ep/sq/kryesore/</a> ). Po ashtu informacioni mbi DTM gjendet edhe në faqen zyrtare të FIM dhe UPT. ( <a href="https://upt.al/fakultete-dhe-institute/fim">https://upt.al/fakultete-dhe-institute/fim</a> ). DTM ka edhe faqen e saj në Facebook ku publikon informacionin i cili është i aksesueshëm për studentët dhe të gjithë të interesuarit. ( <a href="https://www.facebook.com/tekstildhemode">https://www.facebook.com/tekstildhemode</a> ) Gjithashtu Departamenti ka botur edhe një broshurë informuese e cila përditësohet herë pas here. <b>(Ref. 3.08 Broshurë informuese e DTM)</b>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të

Institucioni i UPT, harton një raport financiar të kostove ku përfshihet edhe programin i studimit të Inxhinjerisë së Tekstil Modës (si njësi bazë) duke u bazuar në ligjin 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij, Ligjin Nr. 9720, dt. 23.04.2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe aktet nënligjore në

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)


Faqe 76

<p>paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>zbatim të tij., në Statutin e UPT, rregulloret e brendshme të UPT dhe rregulloren për funksionimin e Bordit të Administrimit të UPT.</p> <p>Struktura e posaçme për menaxhimin financiar dhe zbatimin e politikës financiare është Drejtoria Ekonomike në UPT, e cila bazuar në Ligjin 80/2015, Ligjin Nr. 9936 datë 26. 06. 2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe Udhëzimin Nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ndjek zbatimin e të gjitha procedurave financiare që lidhen me planifikimin dhe realizimin e buxhetit në UPT. Drejtoria Ekonomike mbështet me shërbime financiare realizimin e procesit mësimor dhe të programeve të studimit. Në faqen zyrtare ëeb të UPT dhe në portalin U-Tansparenca, publikohen të dhënat mbi aktivitetin financiar të institucionit. (<a href="https://www.upt.al/rreth-nesh/programi-i-transparences">https://www.upt.al/rreth-nesh/programi-i-transparences</a>), (<a href="https://u-tansparenca.al/">https://u-tansparenca.al/</a>). Tarifat e shkollimit miratohen çdo vit nga Bordi i Administrimit (). Tarifat vendosen brenda tavanit të përcaktuar nga VKM Nr. 638 më datë 22.07.2015 e ndryshuar. DTM si njësi bazë, harton plan buxhetin çdo vit akademik mbështetur në nevojat financiare për mbarëvajtjen e programeve të studimit që ofron.</p> <p><b>Ref. 4.21: Plan buxheti i DTM</b></p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p> <p><b>Ref. 4.19: Rregullore për funksionimin e Bordit të Administrimit të UPT.</b></p> <p><b>Ref. 4.20: VENDIM “Për miratimin e tarifave të rregjistrimit për programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës”</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Në referim të Statutit të UPT, burimet kryesore financiare janë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Buxheti i shtetit;</li> <li>2. Pagesat e studentëve;</li> <li>3. Të ardhurat nga veprimtaria kërkimore dhe shërbimet për të tretë;</li> <li>4. Donacione;</li> <li>5. Administrimi i mjediseve, dhe</li> <li>6. Burime të tjera financimi të ligjshme.)</li> </ol> <p>DTM, si njësi bazë, për t'i ardhur në ndihmë planit të financimit të programeve të studimit që ofron, në parashikimin e buxhetit përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. strukturën mësimore për çdo vit akademik;</li> <li>2. informacionin mbi stafin akademik dhe kadegoritë e titujve, për të bërë reflektimin e saktë të pagës, si pjesë e kostos së planit financiar të programit të studimit;</li> <li>3. parashikimin e ngarkesës mësimore për stafin me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme;</li> <li>4. parashikimin e projekteve shkencore;</li> <li>5. materialet laboratorike;</li> <li>6. parashikime për nevojat e procesit mësimor dhe punën kërkimore shkencore.</li> </ol> <p>Buxheti për blerjen e literaturës dhe pasurimin e Bibliotekës Shkencore dhe të bibliotekave që ka në varësi parashikohet nga Rektorati sipas kërkesave të Fakulteteve.</p> <p>Mobiliteti i pedagogëve dhe i studentëve, drejt universiteteve me të cilat</p>

	<p>ka marrëdhënie bashkëpunimi, është rritur shumë edhe në DTM, ashtu si në UPT në përgjithësi. Nga viti 2017 deri në 2019, në tre vite, nga UPT janë mbështetur rreth 380 mobilitete të personelit për mësimdhënie, kërkim shkencor dhe trajnim. Këto mobilitete janë bërë nëpërmjet marrëdhënieve të bashkëpunimit Erasmus+ dhe nga Buxheti UPT, me prej 13 milionë lekësh në vit. Në rastin e nevojave të reja për financime, apo kur fondet e dhëna nuk janë realizuar, bëhet kërkesa me shkrim për alokim apo rialokim të fondeve nga njësitë bazë. Këto kërkesa, shpenzimet për alokim/rialokim të shpenzimeve korente miratohen nga Administratori i UPT, ndërsa ato që lidhen me investimet miratohen nga organet kolegjiale. (Senati Akademik i UPT dhe Bordi i Administrimit i UPT) <b>Ref. 4.21: Plan buxheti i DTM</b></p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifatat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Përveç auditimit të kryer ndër vite nga auditimi i Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit, UPT referuar strukturës së saj organizative dhe duke u mbështetur në zbatimin e Ligjit për Arsimin e Lartë, ka ngritur në strukturën e tij, Sektorin e Auditit të Brendshëm. Ky sektor është nën varësinë e Bordit të Administrimit. Auditimi i Brendshëm realizohet sipas kërkesave në Ligjin Nr. 114/2015 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik” dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij. Të dhënat mbi veprimtarinë financiare, prokurimet, buxhetet në UPT, publikohen në programin e transparencës në faqen zyrtare të Institucionit:</p> <p>(<a href="https://www.upt.al/rreth-nesh/programi-i-transparencës">https://www.upt.al/rreth-nesh/programi-i-transparencës</a>),</p> <p>(<a href="https://u-transparenca.al/">https://u-transparenca.al/</a>) Raporti përfundimtar për auditimin “Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare” në Universitetin Politeknik të Tiranës është i aksesueshëm në linkun: <a href="https://www.klsh.org.al/ëeb/250_3832.pdf">https://www.klsh.org.al/ëeb/250_3832.pdf</a></p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>Institucioni UPT dokumenton raportet financiare në lidhje me vitet akademike, duke respektuar aktet ligjore dhe nënligjore për arkivë-protokollin. Në këto dokumentime përfshihen raportet financiare për vitet e kaluara akademike si dhe planifikimin e vitit në vijim, për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të programeve të studimit.</p> <p>Programi i transparencës në UPT: <a href="https://www.upt.al/images/stories/phd/scan-20151110093432-0000.compressed.pdf">https://www.upt.al/images/stories/phd/scan-20151110093432-0000.compressed.pdf</a>.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme</p>	<p>Në statutin e UPT, një sërë nenesh lidhur me mbarëvajtjen financiare dhe administrative, dëshmojnë se Institucioni mban përgjegjësinë dhe garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimit. Gjithashtu Institucioni dëshmon dhe garanton se ka kapacitete financiare të nevojshme për përmirësimin e situatës apo gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme, duke ndjekur këtë rrugë: Fakultetet, mbështetur edhe në nevojat e njëjësive bazë, hartojnë kërkesat buxhetore, kërkesë e cila hartohet sipas strukturës së modelit të Buxhetit të Shtetit të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe</p>

në të ardhmen.	<p>Ekonomisë; Projekt-Buxheti vjetor hartohet nga Administratori mbi bazën e këtyre kërkesave e propozimeve, mbështetur në planin strategjik të zhvillimit të UPT dhe në planin buxhetot afatmesëm, për të arritur objektivat strategjike, si dhe realizimin e misionit.</p> <p><b>Ref. 4.21: Plan Buxheti i DTM</b></p> <p><b>Ref. 4.22: Projekt Buxheti Afatmesëm 2020-2022</b></p> <p><b>Neni 10; Neni 13; Neni 21; Neni 22; Neni 23; Neni 24; Neni 25; Neni 26; Neni 27; Neni 28; Neni 29</b></p> <p><b>Ref. Statutiti i UPT</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X




## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e hartuara dhe zbatuara nga UPT, mbulojnë ciklin e plotë të programit të studimit Bsc në Inxhinjeri Tekstile dhe Modë. Këto politika ofrohen në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë, aktet e tjera nënligjore në fuqi si dhe aktet rregullatore të nxjerra nga UPT, që kanë lidhje me politikat studentore. Programi studimit Bsc në Inxhinjeri Tekstile dhe Modë është i organizuar në ECTS dhe kohëzgjatja është 3 vite akademike. Politikat dhe procedurat e hartuara nga institucioni synojnë:</p> <p>Përzgjedhjen e kandidatëve me rezultate sa më të larta; regjistrimi; përparimin e studentëve dhe ecurinë e tyre; vlerësimin e dijeve dhe diplomimin e studentëve; Transferimin e studimeve.</p> <p>Çdo student që regjistrohet në programin e studimit Bsc Inxhinjeri Tekstili e Mode, regjistrohet pranë sekretarisë mësimore me të gjithë dokumnetacionin e nevojshëm sipas udhëzimeve të MASR.</p> <p>Në rregulloren e programit të studimit, parashtrihen të gjitha kërkesat e programit, elementet mësimore të programit dhe procedura e diplomimit.</p> <p>“Elementet që përbëjnë strukturën e programeve të ciklit të parë të studimit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>k) Kreditet, sipas sistemit European të Transferimit të Krediteve (ECTS);</li> <li>l) Kontrollin e dijeve dhe instrumentet e vlerësimit;</li> <li>m) Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale;</li> <li>n) Veprimtaritë formuese dhe komponentët mësimorë të programit të studimit;</li> <li>o) Kadegoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi;</li> <li>p) Planin mësimor;</li> <li>q) Kuotat e pranimit dhe grupet mësimore;</li> <li>r) Programin mësimor (Syllabus-et);</li> <li>s) Profilin e programit;</li> <li>t) Diplomën dhe suplementin.</li> </ul> <p>Këto politika dhe procedura janë të ligjëruara si në statutin e dhe rregulloren e UPT, statutin dhe rregulloren e FIM dhe statutin e rregulloren e DTM.</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b>  <b>Ref. 6.08: Takime informuese të zhvilluara nga ASCAL</b>  <b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc në Inxhinjeri</b></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 80



	<b>Tekstili e Mode</b>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e hartuara nga institucioni, në Statutin e UPT, garantojnë të drejta të njëjta dhe barazi për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. Statuti dhe të drejtat dhe detyrat e studentëve përshkruhen përkatësisht në:</p> <p>Neni 48 (Statusi i studentit të UPT)  Neni 49 (Të drejtat e studentëve të UPT)  Neni 50 (Detyrimet e studentëve të UPT)</p> <p>Po ashtu barazia dhe të drejtat e njëjta për të gjithë kandidatët për studentë të programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstili dhe Mode, pasqyrohen në Rregulloren e programit të studimit në:</p> <p>Neni 11 (Kriteret dhe kuaotat e pranimit)  Dekani FIM miraton kriteret e pranimit të kandidatëve të programit të studimit, të propozuara nga njësi bazë që ofron studimin, në këtë rast DTM. Po ashtu njësi bazë propozon komisionet e diplomimit, temat e diplomave, realizon procedurën e mbrojtjes dhe të vlerësimit të studentëve. Dekani i FIM, miraton komisionet dhe temat e diplomave, nënshkruan diplomatat dhe organizon ceremoninë e shpërndarjes së tyre.</p> <p>Në Neni-n (51 Organizmat e studentëve të UPT) të Statutit përshkruhet qartë e drejta e studentëve në këshilla studentorë, të drejtën e kandidimit, promovimin e pjesëmarrjes dhe koordinimin e përfaqësimit të tyre në organet kolegjiale të UPT dhe të njësive kryesore.</p> <p><b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë.</b>  <b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 2.10: Procedura FIM-P006_Konceptimi dhe mbrojtja e diplomës për programet e ciklit të parë të studimit në FIM</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Në Statutin, në rregulloren e UPT dhe në rregulloren programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstili dhe Mode janë përcaktuar qartë dhe lehtësisht të kuptueshme objektivat, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë programit të studimit, të transferimit, vlerësimit të dijeve dhe diplomimit. (<b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>), (<b>Ref. 1.04 Rregullorja e UPT</b>), (<b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë</b>). Në rregulloren programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstili e Modë shprehen dhe shpjegohen shumë qartë, në nene të veçanta: Elementet që përbëjnë programin e studimit; sistemi i krediteve; Kontrolli i dijeve dhe instrumentat e vlerësimit; Objektivat formues dhe kompetencat profesionale; komponentët e programit të studimit; Kategoria të veprimtarive formuese; Kriteret dhe kuaotat e pranimit; praktika profesionale; mbrojtja e diplomës. (Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit Bsc Inxhinjeri Tekstile dhe Modë), (Ref. 1.04 Rregullorja e UPT) . Plani mësimor, programet lëndore vihen në dispozicion të studentëve për tu njohur prej tyre nëpërmjet burimeve të ndryshme të informacionit, Ato mund t'ju shpërndahen studentëve dhe të interesuarve nëpërmjet fletpalosjeve, guaidave ose posterave por janë të aksesueshme edhe online. <a href="https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit">https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit</a>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton</p>	<p>Hartimi dhe publikimi i kriterëve të veçanta për përzgjedhjen e</p>

<p>dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>kandidatëve për ciklin e parë të studimit bëhet përpara çdo viti akademik duke u mbështetur në kriteret dhe afatet e përcaktuara, në përputhje me aktet e nxjera nga MASR. Departamenti harton kriteret sipas kërkesës së MASR, që pastaj miratohen në dekanatin e fakultetit dhe në senatin akademik të UPT. Për këtë i referohemi Neni-t 19 dhe Neni-t 20 (Ref. 5.01: Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies e UPT). Kriteret e pranimit shpallen nga UPT dhe vihen në dispozicion të QSHA-së dhe në portalin e rrjetit Akademik Shqiptar.</p> <p><b>Ref. 5.02: Miratimi i kriteve të pranimit në UPT</b></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen nga UPT në përputhje me legjislacionin në fuqi të sanksionuara në rregulloret e brendshme. (Ref. 5.01: Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mesimdhënies e UPT)</p> <p>Kuotat specifike të pranimit të studentëve janë hartuar nga DTM, ndërsa ato të përgjithshmet janë të zbatueshme për çdo kandidat që aplikon në një program studimi. (Ref. 1.10: Kuotat).</p> <p>Kuotat e pranimit, në këtë program studimi, parashikojnë kandidatët sipas kategorieve të tilla si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kandidatët Brenda vendit;</li> <li>- Kandidatët nga trojet shqipfolëse (Kosovë, Mal i zi, Maqedoni, Preshevë, Bujanovc, Medvegj);</li> <li>- Kandidatë shtetas të huaj;</li> <li>- Kandidatë me statusin e personave me aftësi ndryshe;</li> <li>- Kandidatë me statusin e jetimit;</li> <li>- Kandidatë romë dhe ballkano-egjiptiane;</li> <li>- Kandidatë që aplikojnë për transferim studimesh;</li> <li>- Kandidatë që aplikojnë për program të dytë studimi.</li> </ul>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Ditët e informimit për nxënësit maturantë janë pjesë e veprimtarisë udhëzuese për publikun, të organizuara tashmë në çdo fillim viti akademik nga UPT/FIM. Kalendari i kësaj veprimtarie shpallet online në adresën: <a href="https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1069-njoftim-ditet-e-informimit-te-maturanteve">https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1069-njoftim-ditet-e-informimit-te-maturanteve</a>. Ndër format e informimit të publikut të përdorura nga FIM dhe DTM është edhe ajo online, nëpërmjet faqes elektronike. Në këtë faqe jepen informacione në lidhje me programin e studimit, organizimin e institucionit, jeta studentore dhe organizimi studentor, etj. (<a href="https://fim.edu.al/">https://fim.edu.al/</a>), (<a href="https://fim.edu.al/info/panairi-ëork-study">https://fim.edu.al/info/panairi-ëork-study</a>). Gjithashtu informacioni për kriteret e përgjithshme dhe specifike të programit të studimit, gjendet në <a href="https://fim.edu.al/info/bachelor">ëeb-site-in e FIM</a>. (<a href="https://fim.edu.al/info/bachelor">https://fim.edu.al/info/bachelor</a>), (<a href="https://fim.edu.al/media/210923134108X99622902LAX81.pdf">https://fim.edu.al/media/210923134108X99622902LAX81.pdf</a>).</p> <p>Nëpërmjet pjesëmarrjes në panairin “Ëork&amp;study”, nga njësia bazë planifikohen ditët e karrierës për të informuar maturantët nëpërmjet fletëpalosjeve dhe broshurës. Zhvillohen edhe prezantime të organizuara nga zyra e karrierës. (Ref. 3.08: Broshurë informuese e DTM)</p> <p><b>Ref. 1.14: Veprimtaritë e zyrës së karrierës).</b></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p>X</p>

**Standardi V.2**

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe të kalimit nga një vit akademik në tjetrin janë të përcaktuara nga DTM në rregulloren e programit të studimit, dhe janë të publikuara edhe në faqen elektronike të FIM. (Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Mode), (<a href="https://fim.edu.al/fim/departamenti-i-tekstilit-dhe-modes">https://fim.edu.al/fim/departamenti-i-tekstilit-dhe-modes</a>) Rregullorja e programit të studimit dhe faqja online, përmbajnë informacionin e plotë për studentët e programit të studimit Bsc të Inxhinjerisë tekstile dhe Mode mbi :</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Planin mësimor për të drejtë vitet e zhvillimit të programit të studimit. (Ref. 1.17: Plani Mesimor), (<a href="https://www.upt.tekstilmoda.org/ep/sq/deget/">https://www.upt.tekstilmoda.org/ep/sq/deget/</a>);</li> <li>- Kërkesat e çdo lënde dhe mënyra e vlerësimit (Ref. 1.09: Syllabuset e disiplinave në BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode);</li> <li>- Vlerësimin me notë sipas pikëve të marra;</li> <li>- Sezonet e riprovimeve, periudha dhe kriteret;</li> <li>- Detyrimet për marrjen e diplomës;</li> <li>- Numri i krediteve që i duhet një student të kalojë nga njëri vit akademik në tjetrin. (<a href="https://www.upt.al/kreditet-frekuentimi">https://www.upt.al/kreditet-frekuentimi</a>);</li> <li>- Diplomimin. (<a href="https://fim.edu.al/info/precresi/procesi-i-diplomimit">https://fim.edu.al/info/precresi/procesi-i-diplomimit</a>)</li> </ul> <p>Një formë tjetër e shpërndarjes së informacionit studentëve është edhe guida e fakultetit (<a href="https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit">https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit</a>), (<a href="https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1456-njoftim-publikohet-guida-studentore-2021-2022">https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1456-njoftim-publikohet-guida-studentore-2021-2022</a>). Po ashtu, ditën e parë të shkollës në çdo fillim viti akademik, organizohet takime me Përgjegjësit e Departamentit, bëhet njohja e studentëve të rinj me godinat e FIM, udhëzuesin e përdorimit të postës elektronike, emrin e sallave, oraret. (Ref. 5.03: Njoftim për fillimin e vitit të ri akademik).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Në Nenin 62 “Transferimi i studimeve” dhe në Nenin 63 “Ndjekja e një program të dytë studimi”, në Statutin e UPT, sqarohen kriteret dhe procedurat në lidhje me njohjen e kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Njohje e cila bëhet nëpërmjet komisioneve të ekuivalentimit të lëndëve. (Ref. 1.01: Statuti i UPT) Gjithashtu tabela me “Kategoritë e veprimtarive formuese”, Neni 10 dhe “Kriteret dhe kuotat e pranimit” Neni 11, në Rregulloren e programit të studimit japin të dhëna mbi kadeqorizimin e lëndëve, peshën e tyre, kreditet dhe përqindjen gjë që i bën procedurat e transferimeve apo njohjen e studimeve të pjesshme transparente për të interesuarit. (Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili e mode)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësisimit të studentëve janë të shprehura qartë në syllabuset e çdo lënde në këtë program studimi. Pedagogët e lëndëve u japin gjithashtu informacion dhe sqarime kriteret e</p>

<p>e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>vlërësimin në lëndët e tyre. E pohuar kjo edhe nga vetë studentët e programit të studimit në takimet e zhvilluara nga grupi i vlerësimit të jashtëm. (Ref. 1.09: Syllabuset e disiplinave të BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Mode). Këtë informacion studentët e marrin edhe nga sekretaria mësimore. Studentët informohen mbi vlerësimet e zhvilluara gjatë semestrit, ku hyjnë detyrat e kursit apo provimet e ndërmjetme, vlerësimin e aktivizimit në seminare dhe vlerësimin përfundimtar. Këto vlerësime zhvillohen sipas afateve të përcaktuara në kalendarin akademik i bërë publik dhe që janë të detyrueshme për tu zbatuar si nga pedagogët ashtu edhe nga studentët. (<a href="https://fim.edu.al/info/struktura-mesimore">https://fim.edu.al/info/struktura-mesimore</a>) Mbas provimit përfundimtar, studenti ka të drejtë të njihet me vlerësimin që ka marrë me pikët totale por edhe me pikët e çështjeve apo pyetjeve të veçanta. Ka të drejtën e ankimit Brenda afateve sipas rregullores së programit të studimit. (Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Procedura e mbrojtjes së diplomës në programet e ciklit të parë të studimeve në Fakultetin e Inxhinjerisë Mekanike, pjesë e të cilës është edhe programi i studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Mode, është përcaktuar në (Ref. 2.10: Procedura FIM-P006- Konceptimi dhe mbrojtja e diplomes për programet e ciklit të parë të studimeve në FIM). Në këtë material studentët njihen me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objektin, qëllimin dhe fushën e veprimt;</li> <li>- Referencat ligjore;</li> <li>- Rregullimet e brendshme;</li> <li>- Përkufizime;</li> <li>- Përgjegjësitë;</li> <li>- Sezonet e mbrojtjes së diplomave;</li> <li>- Fondin e temave së diplomës dhe përcaktimi i studentëve;</li> <li>- Realizimin e punimit të diplomës;</li> <li>- Aspektet teknike;</li> <li>- Organizimin e mbrojtjes së diplomës;</li> <li>- Vlerësimin e punimit të diplomës;</li> <li>- dhe formularët.</li> </ul> <p>Ky informacion përcillet te studentët edhe nëpërmjet pedagogëve/kujdestarëve të studentëve dhe nga sekretaria mësimore. Gjithashtu janë të aksesueshme online. (<a href="https://fim.edu.al/info/procesi-i-diplomimit">https://fim.edu.al/info/procesi-i-diplomimit</a>),</p> <p><b>Ref. 4.10: informimi i studentëve nëpërmjet platformave online),</b>  <b>Ref. 3.04: Lista e tutorëve për secilin vit të BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi</p>	<p>Në mënyrë periodike, përpara fillimit të vitit akademik UPT, FIM dhe njësitë bazë, organizojnë në bashkëpunim me Drejtoritë Arsimore ditët e informimit për studentët. (<a href="https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1069-njoftim-ditet-e-informimit-te-maturanteve">https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1069-njoftim-ditet-e-informimit-te-maturanteve</a>) Takimet me studentët zhvillohen në qytete të ndryshme të Shqipërisë dhe sipas një kalendari të përcaktuar nga Drejtoritë Rajonale të Edukimit. Në këto takime marrin pjesë përfaqësues</p>

programin e studimit.	të zyrës së karrierës, drejtoria e kurrikulës dhe stafi akademik të UPT, FIM dhe DTM. Takimet zhvillohen me të interesuarit, në këtë rast gjimnazistët dhe prindërit. Ata informohen për programet e studimit, mundësitë e zhvillimit të karrierës, interest personale të tyre, mundësitë e punësimit, etj. Gjithashtu shpërndahen broshura informuese për programet e studimit që ofron DTM. <b>Ref. 3.08: Broshurë informuese e DTM</b> <b>Ref. 1.14: Veprimtaritë e zyrës së karrierës</b>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Në fillim të vitit të ri akademik, FIM organizon takim informues për studentët e vitit të parë, lidhur me organizimin e ciklit të parë të studimit, kreditet, rregullat e kalimit në vitin pasardhës, mënyrën dhe organizimin e provimeve, praktikat mësimore, frekuentimin, tabelat informuese, projektet, etj.. Më pas takimet organizohen nga Departamenti i tekstilit dhe modës për të dhënë një informacion më specifik dhe të detajuar për studentët e vitit të parë të programit të studimit të Inxhinjerisë së tekstilet e Modës. Këtu studentët njihen me stafin mësimdhënës, me mjediset e departamentit dhe laboratorët. Në periudhën e pandemisë së Covid 19, këto takime janë zhvilluar online, përmes platformës Microsoft Teams, në mënyrë që studentëve të mos u mungojë ky informacion. Gjithashtu sekretaria mësimore mban një peshë të veçantë në lidhje me angazhimin e saj informativ ndaj studentëve. Ky angazhim fillon që me regjistrimin e studentëve në vit të parë e vazhdon deri në diplomimin e tyre. Kujdestarët e studentëve janë në kontakt të vazhdueshëm me studentët e ciklit të parë të studimeve, për të informuar studentët por edhe për këshillimin e tyre. Gjithashtu këtë informacion në formë të plotë, studentët e këtij program studimi, mbi rregulloren, zhvillimin e procesit mësimor, infrastrukturën, shërbimet në funksion të realizimit të programit, studentët e gjejnë të publikuar në faqen zyrtare të FIM, për Departamentin e Tekstilit dhe Modës. ( <a href="https://fim.edu.al/info/rregullore-dhe-procedura">https://fim.edu.al/info/rregullore-dhe-procedura</a> ) <b>Ref. 1.17: Plani mësimor</b> <b>Ref. 1.09: Syllabuset e disiplinave të BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b> <b>Ref. 3.04: Lista e tutorëve për secalin vit të BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit	DTM ka përgatitur një informacion të posaçëm për studentët e programit të studimit BSc në Inxhinjeri tekstili e Mode, të quajtur guida e studentit dhe e ka vënë në dispozicion të studentëve duke e publikuar në

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 85

<p>informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p><a href="https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit">https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit</a>, dhe në <a href="https://www.upt-tekstilmoda.org/ep/sq/deget/">https://www.upt-tekstilmoda.org/ep/sq/deget/</a>. Ky informacion, përveç informacionit të përgjithshëm, përmban rregulloren e programit, planin mësimor me lëndët përkatëse, përmbajtjen dhe veprimtarinë formuese.. Prezantimi i programit të lëndës dhe rubrikat e tij specifike si, kreditet, temat e leksioneve dhe të seminareve, laboratorët, vlerësimi, literature bazë dhe ajo ndihmëse, bëhet nga çdo pedagog në leksionin e parë.</p> <p><b>Ref. 3.08: Broshurën informuese e DTM)</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b>  <b>Ref. 1.17: Plani mësimor)</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.</p>	<p>Një nga çështjet e rëndësishme, pjesë e informacionit që institucioni përgatit për të informuar studentët e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili se Modë, është edhe mundësia e punësimit si dhe orientimi drejt tregut të punës. Një pikë e fortë e institucionit UPT/FIM është bashkëpunimi me industrinë, biznesin, kompanitë dhe institucionet. Këto bashkëpunime mbështeten në marrëveshje të institucionalizuara duke filluar që nga viti 2016. Këto marrëveshje shërbejnë për të bërë të mundur realizimin e praktikave mësimore të studentëve, duke e parë këtë edhe sin je mundësi punësimi pas mbarimit të studimeve. Në panairin e punës, të organizuar nga UPT, shumë kompani pjesëmarrëse u treguan të gatshme për bashkëpunim në lidhje me praktikën profesionale dhe punësimin. Panairë të tjerë, ku UPT ka qenë pjesëmarrëse, janë edhe “Eork and study” 2020, i organizuar nga Dhoma e Tregëtisë dhe e Industrisë dhe në panairin e Ndërtimit, Arkitekturës dhe Planifikimit Urban 2018. (Ref. 1.14: Veprimtaritë e zyrës së karrierës).</p> <p>Rrjeti Alumni, tashmë i ngritur në FIM mbledh të dhëna mbi punësimin e studentëve dhe mban kontakte me ta. (<a href="https://fim.edu.al/fim/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim">https://fim.edu.al/fim/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim</a>). Nëpërmjet rrjetit Alumni, UPT identifikon dhe ndjek zhvillimin e karrierës së studentëve. Institucioni ka krijuar një database me mbi 200 të diplomuar, që kanë qenë të interesuar për tu bërë pjesë e këtij rrjeti. Nëpërmjet pyetësorit dhe databas-it të krijuar, figurojnë të punësuar aktualisht në masën 88%, prej të cilëve 78% punojnë në profesionin e tyre. 57% janë punësuar për herë të parë pa mbaruar studimet dhe 36% janë punësuar vitin e parë mbas diplomimit.</p> <p>UPT ndjek politika për punësimin brenda universitetit të studentëve ekselentë si personel akademik efektiv dhe me kontratë, si staf ndihmës akademik apo administrativ. Një shembull i qartë i punësimit të studentëve ekselentë është edhe DTM, ku kryesisht pedagogët e lëndëve karakterizuese dhe lëndëve ndërdisiplinore kanë qenë ish studentë. Gjithshtu DTM bën përpjekje të vazhdueshme për të ndihmuar studentët në lidhje me punësimin në kompanitë prodhuese të konfeksioneve, firma të ndryshme, atelie mode apo institucione të ndryshme. DTM i kushton shumë rëndësi praktikave profesionale që nga gjetja e kompanive të ndryshme dhe bashkëpunimi i ngushtë në monitorimin e studentëve, si një rrugë që ndihmon në mënyrë efektive punësimin e studentëve mbas mbarimit të studimeve. Një argument ky i prekur dhe i aprovuar, si nga</p>

	<p>stafi akademik ashtu edhe nga vetë studentët, gjatë vizitës në institucion të grupit të vlerësimit të jashtëm.</p> <p><b>Ref. 1.24: Marrëveshje të UPT</b>  <b>Ref. 6.06: Vendimi Nr. 2</b>  <b>Ref. 1.13: Marrëveshje UPT – PEA</b>  <b>Ref. 2.01: CV e personelit akademik</b>  <b>Ref. 5.05: CV Elona Hidri</b>  <b>Ref. 4.04: Përzgjedhja e kandidatëve fitues</b></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Informacioni i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor, vihet në dispozicion për studentët e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstile dhe Mode, nga FIM/DTM dhe është lehtësisht i aksesueshëm nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Faqes zyrtare të institucionit (<a href="https://fim.edu.al/info">https://fim.edu.al/info</a>)</li> <li>- Faqes elektronike të Departamentit (<a href="https://www.upt-tekstilmoda.org/ep/sq/kryesore/">https://www.upt-tekstilmoda.org/ep/sq/kryesore/</a>)</li> <li>- Sistemit MS Teams, ku çdo student është ka llogarinë personale me të cilën pajisen në fillim të studimeve në UPT. Nëpërmjet kësaj platforme informohen mbi kurrikulën e programit, rezultatet e provimeve, etj.</li> <li>- Sekretarisë mësimore</li> <li>- Stendës me informacionet e përditësuara e cila gjendet në katin e tretë të godinës qendrore të UPT.</li> </ul>								
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Mode mbart informacionin në lidhje me programin e studimit.</p> <p>Në çdo fillim viti akademik, përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm, UPT/FIM dhe DTM informojnë studentët rreth programit të studimit, akreditimin e programit të studimit dhe atë institucional, mbi vlefshmërinë e diplomës së lëshuar, infrastrukturën dhe shërbimet. (<a href="https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1576-njoftim-universiteti-politeknik-i-tiranes-akreditohet-per-6-vite-nga-bordi-i-akreditimit">https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1576-njoftim-universiteti-politeknik-i-tiranes-akreditohet-per-6-vite-nga-bordi-i-akreditimit</a>), (<a href="https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit">https://fim.edu.al/info/guida-e-studentit</a>)</p> <p>Gjatë dy viteve të pandemisë, stafi IT ka bërë të mundur zhvillimin e mësimin në distancë online, ku studentët kanë pasur akses të plotë nëpërmjet platformës MS Teams. Ky staf ka zhvilluar trajnime dhe është përgjigjur nevojave të studentëve edhe nëpërmjet manualeve të përdorimit të kësaj platforme për të siguruar cilësinë e programit të studimit.</p> <p><b>Ref. 3.01: Udhëzues për zhvillimin e mësimin në distancë),</b>  <b>Ref. 3.02: Trajnim për platformën TEAMS)</b>  <b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode).</b></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="600 1742 767 1821">Përbushet plotësisht</th> <th data-bbox="767 1742 983 1821">Përbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="983 1742 1198 1821">Përbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1198 1742 1439 1821">Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="600 1821 767 1859"></td> <td data-bbox="767 1821 983 1859"></td> <td data-bbox="983 1821 1198 1859"></td> <td data-bbox="1198 1821 1439 1859">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

<b>Standardi V.4</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.	Mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë Nr. 80/2015 dhe të pasqyruar në Rregulloren e UPT, dokumentacioni mësimor dhe baza e të dhënave të studentëve mbahet nga sekretaria mësimore e FIM në formë të shkruar, si më poshtë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Regjistri themeltar i studentëve</li> <li>- Regjistri i arritjeve akademike të studentit</li> <li>- Regjistri i lëshimit të diplomave</li> </ul> DTM është e angazhuar në mbledhjen e të dhënave nga sekretaria mësimore, për arsye studimore si, fletët e provimit, procesverbalet e diplomave, etj. Në evidencat individuale të stafit akademik me kohë të plotë dhe të pjesshëm, pasqyrohet numri i diplomave të mbrojtura në të gjitha ciklet e studimit. <p><b>Ref. 5.06: Tabelë përmbledhëse për orët mësimore diploma.</b></p> <p><b>Ref. 4.11: Regjistri themeltar i studentëve</b></p> <p><b>Ref. 4.12: Regjistri i arritjeve akademike</b></p> <p><b>Ref. 4.13: Regjistri i lëshimit të diplomave</b></p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Sekretaria mësimore ruan në arkivin e saj: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dosjet e regjistrimit të studentëve, me dokumentacionin sipas udhëzimeve të përvitshme nga MASR.</li> <li>- Procesverbalet e provimeve</li> <li>- Dosjet e transferimeve prej dhe në programin mësimor</li> <li>- Statistikat e frekuentimit të studentëve;</li> <li>- Statistikat e studentëve që e humbasin statusin e studentit;</li> <li>- Statistikat e studentëve që ç'rrregjistrohen, etj.</li> </ul> Këto dokumenta janë të arkivuara dhe mbahen në sekretarinë mësimore në formën e materialeve origjinale. Në bazën e këtyre dokumentave lëshohen vërtetimet në sipas kërkesave të studentëve, administratës së UPT-së dhe MASR. <p><b>Ref. 5.09: Shembull i dosjes së studentit</b></p> <p><b>Ref. 5.07: Procesverbal provimesh</b></p> <p><b>Ref. 5.08: Procedurë transferimi studimesh</b></p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.	Dokumentat e arkivuara në sekretarinë mësimore për çdo student, që nga regjistrimi dhe gjatë gjithë kohës së zhvillimit të programit të studimit e deri në diplomimin e tyre, janë tregues që UPT/FIM disponon të dhëna të plota dhe të rregullta për çdo student. Referuar të dhënave të Raportit të vetvlerësimit dhe të dhënave pranë sekretarisë mësimore: <p>Për vitin akademik 2018-2019 janë diplomuar 42 studentë në programin e studimit BSc në Inxhinieri Tekstili dhe Mode.</p> <p>Për vitin akademik 2019-2020 janë diplomuar 38 studentë në programin e studimit BSc në Inxhinieri Tekstili dhe Mode.</p>



	Për vitin akademik 2020-2021 janë diplomuar 24 studentë në programin e studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili dhe Mode.			
<b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat në lidhje me regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit, etj., administrohen nga sekretaria mësimore në çdo njësi kryesore. Të dhënat përdoren përmes strukturave të brendshme të menazhimit siç janë arshivat, sekretariatë mësimore, zyrat e financës, departamentet, për qëllime që janë në funksion të veprimtarive të institucionit. Çdo student ka dosjen personale në sekretarinë e universitetit. Në dosje ruhen të dhëna lidhur me arsimin, kontakti, gjendjen ekonomike, gjendjen shëndetësore, statusin e veçantë (nëse e ka). Këto të dhëna shërbejnë si kusht për përfitimin e bursës ose përjashtimin nga tarifa shkollore. Sekretaria mësimore ka një "database" ku hedh, ruan dhe menaxhon të dhënat e studentëve të programit të studimit. Pedagogët e lëndëve, gjithashtu mbajnë evidencat e tyre, specifike për çdo lëndë. Vlerësimi i studentëve pasqyrohet në procesverbale të cilat sekretaria mësimore i vë në dispozicion të pedagogut të lëndës në sezonin e provimeve, të cilat dorëzohen dhe ruhen në sekretari. Në sekretarinë mësimore plotësohen, menazhohen dhe ruhen të dhënat e studentëve të pasqyruara përkatësisht të: Regjistri themeltar; Regjistri i arritjeve akademike dhe Regjistri i diplomave. <b>Ref. 4.11: Regjistri themeltar i studentëve</b> <b>Ref. 4.12: Regjistri i arritjeve akademike</b> <b>Ref. 4.13: Regjistri lëshimit të diplomave</b> <b>Ref. 5.09: Shembull i dosjes së studentit</b> <b>Ref. 5.10: Model evidence të një disipline</b>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nëpërmjet hartimit të planit të punës vjetore në lidhje me kërkimin shkencor, në zbatim kjo edhe të Udhëzimit të MASR, UPT dhe DTM si njësi bazë synon të vlerësojë veprimtarinë mësimore dhe shkencore e po ashtu edhe ecurinë e ritjen e cilësisë së programit të studimit. Raporti periodik, i cili hartohet bazuar në evidencat dhe raportet e njesive kryesore/bazë dhe rektoratit, përmban profilin dhe cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve. Shkalla e cilësisë së punësimit të studentëve është realizuar nëpërmjet ngritjes së rrjetit Alumni në nivel UPT dhe nivel FIM. Raportet shoqërohen me rekomandimet e duhura në drejtim të përmirësimit dhe rritjes së cilësisë në hyrje dhe në dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre. Tregues i cilësisë së mësimdhënies në analizë është edhe mesatarja e shkollës së mesme të regjistruarit në program, si dhe kalueshmëria dhe cilësia e vlerësimit sipas lëndëve. <b>Ref. 5.11: Udhëzimi i MASR</b> <b>Ref. 5.12: Plani vjetor i aktivitetit kërkimor-shkencor në njësi bazë dhe kryesore</b> <b>Ref. 5.04: Pyetëtori dhe databaza Alumni)</b>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 89

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>UPT parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore rregullatore në përputhje ligjin e arsimit të lartë dhe të parashikuar në Nenin 49 pika 1a, në Statut. Ndërsa Neni 51 i Statutit, përcakton Organizmat e Studentëve të UPT. Studentët kanë 4 përfaqësuesit e tyre si anëtarë të Senatit Akademik të UPT, të cilët zgjidhen me votat e studentëve. Studentët kanë krijuar këshillat studentorë në nivel institucioni dhe organizojnë aktivitetet e tyre. (Gjithashtu studentëve u garantohet përfaqësimi në vlerësimin e programeve akademike si dhe në vlerësimin institucional si pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm.</p> <p><b>Ref. 5.17: Urdhër i brendshëm Nr. 40 datë 28. 03. 2022 “Për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit BSc në FIM</b></p> <p><b>Ref.101: Statuti i UPT</b></p> <p><b>Ref. 5.16: Këshilli Studentor (Aktivitete</b></p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b></p> <p><b>Ref. 5. 13: Rezultatet e zgjedhjeve për Senatit Akademik Përfaqësuesit e studentëve janë edhe në Këshillin e Etikës në Këshillat e programeve të studimit.</b></p> <p><b>Ref. 5.14: Kodi i Etikës në UPT</b></p> <p><b>(Ref. 5.15: Këshillat e Programeve të Studimit dhe Koordinatorët).</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në organet drejtuese studentët shprehin mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të UPT/ FIM si: për planet mësimore, programet e studimeve, rregulloret e studimeve, aktivitetin shkencor, problematika që lidhen me jetën sociale studentore. Kjo e parashikuar edhe në Nenin 7 të rregullores së DTM, ku Këshilli i Programit të Studimit (KPS) BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode, njërin prej pesë anëtarëve e ka student. (<b>Ref. 1.07: Rregullorja e DTM</b>). Vlen për tu vlerësuar edhe rritja e përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor dhe pjesëmarrjen e tyre në konferenca ndërkombëtare. (<b>Ref. 2.09: Artikuj shkencorë me autorë studentë</b>). Gjithashtu pjesëmarrjen reale të studentëve në procesin e vlerësimit të mësimdhënies, evidentohet edhe nëpërmjet pyetësorëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2018-2019. (<a href="https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202018-2019%20(SEM%20II).pdf">https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202018-2019%20(SEM%20II).pdf</a>;</li> <li>- Raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2019-2020. (<a href="https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20I).pdf">https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20I).pdf</a>;</li> <li>- Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimdhënies online 2019-2020. (<a href="https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20">https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20</a></li> </ul>

	<a href="#">ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Mbështetur në përcaktimet e VKM Nr. 41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, hartimi dhe përmirësimi i mundshëm i tyre bëhet duke mbajtur parasysh shpërdarjen e ngarkesës së punës së studentëve brenda dhe jashtë auditorit. Njohja e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme behet përmes transferimit të krediteve të mbartura nga një institucion tjetër i arsimit të lartë, gjë e cila është e parashikuar në aktet e brendshme rregullatore.</p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT,</b>  <b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b>  <a href="https://www.upt.al/transferime"> (https://www.upt.al/transferime)</a>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit, bazuar në Nenin 70 të Rregullores së UPT dhe Nenin 51 pika 5, të Statutit të UPT, e po ashtu edhe në rregulloren e brendshme të FIM, ku theksohet se studentët si pjesë e komisioneve të përhershme institucionale kanë të drejtë të japin mendime dhe të përfshihen në procesin e hartimit apo të ndryshimit të kurrikulës, të përmirësimin të programeve të studimit, duke dhënë kontributin e tyre. Studentët mund të japin kontributin me sygjërimet e tyre nëpërmjet pyetësorëve për vlerësimin e procesit akademik:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2018-2019. (<a href="https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202018-2019%20(SEM%20II).pdf">https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202018-2019%20(SEM%20II).pdf</a>;</li> <li>- Raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2019-2020. (<a href="https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20I).pdf">https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20I).pdf</a>;</li> <li>- Raport mbi anketimin studentor cilësia e mësimdhënies online 2019-2020. (<a href="https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://www.upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>).</li> </ul> <p>Gjithashtu studentët janë të lirë dhe të mirëpritur të shprehin sygjërimet e tyre edhe gjatë takimeve me kujdestarët.</p> <p><b>Ref. 3.04: Lista e tutorëve për secilin vit të BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b>  <b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b>  <b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/</p>	<p>Institucioni UPT/ FIM ka sanksionuar të drejtën e barazisë dhe të ndershmërisë në kryerjen e procesit të vlerësimit të kontrollit të dijeve, e po ashtu edhe mundësinë e ankimimit të rezultatit në Nenin 35 të Rregullores së UPT dhe në Nenin 49 të rregullores së FIM. Studenti ka të drejtën e ankimimit nëse mendon se janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të mësimin ose nuk është dakord me vlerësimin që i është bërë. Ankimimi ndjek rregullin si më poshtë: Ankesa duhet të depozitohet me shkrim në sekretarinë e dekanit, Brenda një afati 3 ditë nga shpallja e rezultatit. Ankesa shqyrtohet nga decani, i cili mund të thërrasë edhe</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 91

pedagogut përgjegjës.	<p>drejtuesin e njësisë bazë përkatëse, komisionin e provimit dhe vetë studentin. Pas gjykimit të çështjes, merr vendimin përkatës të formës së prerë, Brenda tri ditëve. Kur ankesa e studentit është e drejtë, decani e shpall të pavlefshëm rezultatin e vlerësimit, për të cilin student është ankuar dhe vendos që student të rivlerësohet ose të rijapë provimin, me të njëjtin komision, por të plotësuar edhe me anëtarë të tjerë. Procedura e ndjekur për zgjidhjen e ankesës, po ashtu edhe vendimi i marrë, dokumentohen. Gjatë takimit të studentëve me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, ata treguan se pedagogët mbas provimit e bëjnë transparent vlerësimin për çdo student, duke shërbyer kjo edhe si një lloj analize e punës së përbashkët të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Po ashtu studentët theksuan se, pedagogët janë të hapur për konsultime, rishikime dhe reflektime në lidhje me vlerësimin.</p> <p><b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT</b>  <b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>  <b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>DTM në bashkëpunim me njësitë e posaçme siç janë sekretaria mësimore, sekretaria e Dekanit, zv. Dekanin për anën mësimore, kujdestarët, specialistin e IT, zyrën e financës, informon studentët mbi programin e studimit, përmbajtjen dhe organizimin e tij, kohëzgjatjen e studimeve në programin e studimit, akreditimin dhe mundësitë për punësim pas diplomimit, kalendarin akademik, sezonet e provimeve, datat e pushimeve dhe festat, etj. Informacioni përcillet në mënyra të ndryshme, prej të cilëve përmendim emailin, faqet elektronike dhe rrjeteve sociale të FMI dhe DTM.</p> <p><b>Ref. 3.04: Lista e tutorëve për secalin vit të BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b>  (<a href="https://fim.edu.al/fim/teknologjia-e-informacionit-dhe-komunikimit">https://fim.edu.al/fim/teknologjia-e-informacionit-dhe-komunikimit</a>),  (<a href="https://www.facebook.com/tekstildhemode/">https://www.facebook.com/tekstildhemode/</a>).  (<a href="https://www.facebook.com/Fakulteti-i-Inxhinjerise-Mekanike-Sekretaria-Mesimore-1434243359969727/">https://www.facebook.com/Fakulteti-i-Inxhinjerise-Mekanike-Sekretaria-Mesimore-1434243359969727/</a>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Ngritja e zyrës së Këshillimit të karrierës FIM, i shërben përmbushjes së këtij kriteri në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (UPT) dhe DTM. Ky system i posaçëm i shërben informimit, këshillimit dhe ndjekjes së përparimit të studentëve, po aq edhe pjesëmarrjes së tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Studentëve u vihet në dispozicion informacuin i duhur dhe i përditësuar mbi rregulloret, zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 22-43423

web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

Faqe 92

	<p>shërbimet në funksion të realizimit të procesit mësimor. Përparimi i studentëve, ndjekja në mënyrë të vazhdueshme dhe ndihma e nevojshme në çështje të procesit mësimor dhe programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili e mode, kryhet nëpërmjet tutorazhit dhe konsultimeve me pedagogët e lëndëve për secilin vit të programit. Në ndihmë të këtij procesi, studentëve u vjen edhe informacioni nëpërmjet faqes zyrtare dhe rrjeteve sociale të FIM.  <a href="https://fim.edu.al/info"> (https://fim.edu.al/info)</a>, <a href="https://www.facebook.com/tekstildhemode/"> (https://www.facebook.com/tekstildhemode/)</a>.  <a href="https://www.facebook.com/Fakulteti-i-Inxhinjerise-Mekanike-Sekretaria-Mesimore-1434243359969727/"> (https://www.facebook.com/Fakulteti-i-Inxhinjerise-Mekanike-Sekretaria-Mesimore-1434243359969727/)</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/ njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Nëpërmjet Drejtorisë së Sigurimit të brendshëm të Cilësisë (UPT) dhe Zyrës së Këshillimit të Karrierës (FIM), Institucioni angazhohet në mbështetje të studentëve përgjatë gjithë ciklit të studimeve. Orientimi në karrierë, këshillimi i duhur për të ndërmarrë zgjedhje strategjike në karrierën e tyre, është edhe fokusi i këtij shërbimi. Këto struktura në shërbimet e tyre përfshijnë ndërveprimin e drejtpërdrejtë me studentët, për t'i njohur ata me pritshmëritë, kërkesat dhe standardet e tregut, si një lloj parapërgatitje për prezantimin me punëdhënësin, orientimin për praktikën profesionale në institucione të ndryshme, orientimin në tregun e punës, si dhe informacione të ndryshme që kanë lidhje me procesin mësimor. Zyra e Karrierës ka realizuar takime informative mbi Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, mbi platformën online të punësimit GRDUA, mbi garën Alabania ITC Aëards dhe mbi mundësitë e bashkëpunimit dhe aplikimit në universitetet partnere.</p> <p>Panairi i Punës, i organizuar nga UPT, ku marrin pjesë kompani të ndryshme, të cilat kanë vullnetin e mirë të bashkëpunimit sin ë lidhje me praktikën mësimore apo edhe punësimin, është një shembull i punës së mirë që institucioni kryen në lidhje me orientimin e studentëve drejt tregut të punës. Do të theksojmë këtu edhe pjesëmarrjen e UPT në panairin Eork and Study 2020 të organizuar nga Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë dhe në Panairin e Ndërtimit, Arkitekturës dhe Planifikimit Urban 2018. (Dy Guidat studentore (2019-2020 dhe 2020-2021) të botuara nga Zyra e Karrierës në bashkëpunim me studentët, paraqesin informacion mbi UPT, programet e studimit, organizimin, shërbimet studentore, etj. Rrjeti Alumni, i ngritur nga zyra e karrierës në UPT ka tashmë një database me mbi 200 të diplomuar.  <a href="https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1019-njoftim-botohet-guida-studentore/"> (https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1019-njoftim-botohet-guida-studentore)</a>, <a href="https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1456-njoftim-publikohet-guida-studentore-2021-2022"> (https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/1456-njoftim-publikohet-guida-studentore-2021-2022)</a></p> <p><b>Ref. 5.04: Pyetësori dhe databaza Alumni).</b>  <b>Ref. 1.14: Veprimtaritë e zyrës së karrierës</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të</p>	<p>Zyra e karrierës, nëpërmjet rrjetit Alumni, ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon dhe mban të dhënat mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit duke krijuar kështu një databazë me mbi 200 të diplomuar që kanë shprehur interes për të qenë pjesë e këtij rrjeti në UPT. (Ref. 5.04: Pyetësori dhe databaza Alumni). Tashmë edhe</p>

programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.

Fakulteti i Inxhinjerisë Mekanike ka ngritur rrjetin Alumni (<https://fim.edu.al/fim/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim>) Në bazë të pyetësorit është krijuar një databazë, ku rezulton të jenë të punësuar aktualisht në masën 88%. 78% e numrit të të anketuarve punojnë në profesionin e tyre. 57% e të anketuarve janë punësuar për herë të parë ende pa mbaruar studimet dhe 36% e tyre janë punësuar Brenda vitit të parë të diplomimit. Punësimi brenda universitetit është një formë e aplikuar nga UPT për të favorizuar punësimin e studentëve. Studentë ekselentë të UPT janë punësuar si staf akademik efektiv dhe si staf akademik ndihmës, apo edhe në administratë. Pjesë e strategjisë së DTM, në lidhje me punësimin e studentëve, është edhe ndihma që u jep studentëve për të krijuar lidhje me kompanitë prodhuese, firma të ndryshme, atelie dhe institucione ku ata mund të punësohen. Praktikant profesionalë luajnë një rol të rëndësishëm në aftësimin praktik të studentëve në njohjen me prodhimin dhe profilet e punës, por si edhe si një pikënisje e mirë për punësimin e tyre.

**Ref. 5.05: CV Elona Hidri**

**Ref. 4.04: Përzgjedhja e kandidatëve fitues.**

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nëpërmjet Planit Strategjik UPT, tregon angazhimin e tij në lidhje me Sigurimin e Brendshëm të Cilësinë në të gjitha fushat e veprimtarisë së tij. Gjithashtu në Nenin 78-81, Kreu IX, të Statutit janë parashikuar strukturat dhe parimet e funksionimit të Sigurimit të Cilësisë.</p> <p>Strukturat përkatëse në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të sigurimit të cilësisë së mësimdhënies në UPT janë: Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC), Drejtoria e Kurrikulave (DK) (Ref. 1.16: Organigrama e FIM), dhe NJSC në çdo njësi kryesore të UPT. Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UPT, është ngritur me vendim të Senatit Akademik të UPT më datë 26.03.2009 dhe varet nga Rektori i UPT. DSBC funksionon në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikës e Shqipërisë”.</p> <p>Njësia përgjegjëse për zhvillimin e programit të studimit është Departamenti. DSBC dhe DK, nëpërmjet fakulteteve, kordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Senati Akademik ka hartuar edhe rregulloren e zhvillimit kurrikular dhe mësimdhënies në shërbim të cilësisë (Ref. 5.01: Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT). UPT ka të institucionalizuar dhe aktive njësinë e brendshme të sigurim të cilësisë, e cila merr informacion nga çdo njësi kryesore dhe njësi bazë dhe monitoron zbatimin e kodit të cilësisë në to. Ajo ndjek dhe koordinon proceset e akreditimit dhe prozon plane veprimi për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Në kuadër të monitorimit të cilësisë, DSBC ka organizuar rregullisht anketime semestrale adresuar studentëve për vlerësimin e cilësisë në mësidhënie. Në këto anketime përfshihen të gjithë indikatorët e mësimdhënies, çdo student i jepet mundësia të shprehë mendimin e tij mbi procesin mësimor dhe personelin akademik. Vlerësimet janë transparente dhe të aksesueshme në faqen e UPT. <a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20I).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20I).pdf</a></p> <p>Në planin strategjik 2020-2024 të FIM, theksohet rëndësia e respektimit të standarteve për sigurimin e cilësisë në veprimtaritë akademike dhe administrative të fakultetit, sin ë planin afatshkurtër ashtu edhe në planin afatgjatë.</p> <p><b>Ref. 6.01: Plani Strategjik FIM</b>  <b>Ref. 1.02: Plani strategjik i UPT</b>  <b>Ref. 1.01: Statuti i UPT.</b></p>

<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>UPT për të garantuar sigurimin e standardeve të cilësisë së institucionit ka ngritur strukturat përgjegjëse të ngarkuara nga Senati Akademik si: Drejtorinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) dhe Drejtorinë e Kurikulave (DK). Gjithashtu edhe sektori i statistikave bën të mundur një kontroll më efikas në lidhje me cilësinë. (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>). Nëpërmjet anketimit semestral, gjatë periudhës 2018-2020, të organizuar nga DSBC, studentët kanë shprehur mendimin e tyre mbi mësimdhënien dhe veprimtarinë akademike në UPT. Nëpërmjet të dhënave të mbledhura nga anketimet, DSBC ka hartuar raporte për rezultatet e personelit akademik dhe analiza për treguesit e anketimit për çdo program studimi. Analizat janë bërë të njohura si për njësitë kryesore ashtu edhe ato bazë dhe janë bërë publike edhe për studentët. (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>) raport mbi anketimin studentor “cilësia e mësimdhënies online” sem ii 2019-2020 raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2019-2020 (sem i) raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2018-2019 (sem i) raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2018-2019 (sem ii) raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2017-2018 (sem ii) Njëri nga anketimet i është kushtuar metodave të mësimdhënies online në periudhën e pandemisë <a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a> në bazë të të dhënave të mbledhura nga anketimi në UPT dhe sondazhit kombëtar të studentëve, organizuar nga ASCAL, është hartuar një plan veprimi mbi problematikat e evidentuara. Zyra e karrierës e ngritur në FIM, është ngritur si pjesë e sistemit të sigurimit dhe vlerësimit të brendshëm. Kjo zyrë është në varësi të Dekanit të FIM dhe operon me një punonjëse me kohë të plotë. <a href="https://fim.edu.al/sigurimi-i-cilesise-ne-fim">https://fim.edu.al/sigurimi-i-cilesise-ne-fim</a>.</p> <p><b>Ref. 1.16: Organigrama e FIM</b> <b>Ref. 6.02: Plan veprimi mbi problematikat e konstatuara në Anketimet Studentore</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Instrumentat kryesorë për sigurimin e jashtëm të cilësisë në UPT janë Akreditimi Institucional dhe Akreditimi i Programeve të studimit të cilat janë edhe detyrim ligjor për çdo IAL, në bazë të Nenit 104 të LAL Nr. 80/2015. Në 07.04.2017 UPT ishte objekt i vlerësimit të jashtëm institucional me qëllim vlerësimin e shkallës së përmbushjes së Standardeve Shqiptare Shtetërore të Cilësisë. <a href="https://www.upt.al/images/stories/menu/Certifikata%20e%20Akreditimit%20institucional%20UPT.NPG">https://www.upt.al/images/stories/menu/Certifikata%20e%20Akreditimit%20institucional%20UPT.NPG</a> Ky proces periodik akreditimi institucional i UPT, përfundoi me vlerësimin përfundimtar pozitiv dhe akreditimin institucional me kohëzgjatje prej 6 vite akademike, nga vendimi i mbledhjes së Bordit të Akreditimit në 7 janar 2022. <a href="https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-07-janar-2022">https://www.ascal.al/sq/bordi-i-akreditimit/vendimet/vendimet-e-mbledhjes-07-janar-2022</a>. UPT planifikon përgatitjen e raportit vjetor mësimor-kërkimor, analizën e programeve të studimit dhe kurikulave,</p>



	<p>përmirësimin e tyre deri në masën 20%, analizën e programeve lëndore dhe përmirësimin e tyre, përdorimin e dokumentacionit të unifikuar të vlerësimit, etj. DSBC dhe DK bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën me njësitë bazë për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Për të mundësuar vlerësimin e brendshëm FIM, fton studentët në mënyrë periodike të plotësojnë pyetësorët për të bërë vlerësimin e lëndëve të programit.</p> <p><b>Ref. 4.16: Raport i aktivitetit mësimor (në nivel njësisish dhe universiteti)</b></p> <p><b>Ref. 4.17: Raport i aktivitetit kërkimor shkencor (në nivel njësisish dhe universiteti)</b></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë UPT ka hartuar politika të qarta dhe ndjek në mënyrë periodike procedura për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit që ofron. Në Statutin e UPT, në Kreun IX, janë përshkruar shumë qartë procedurat e posaçme për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve që ofrohen. Edhe në rregulloren e sigurimit të cilësisë janë përcaktuar procedurat, afatet, instrumentat dhe burimet për sigurimin e brendshëm të cilësisë.</p> <p><b>Ref. 5.01: Rregullorja e zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b> <b>(Ref. 1.01: Statuti i UPT).</b></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				X

#### Standardi VI.2

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njëjësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>Për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit, UPT ka ngritur njësi dhe struktura të posaçme. Këto struktura janë Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (DSBC) dhe Drejtoria e kurrikulave (DK) (<b>Ref. 1.16: Organigrama e FIM</b>). Në nivel njësie bazë, është ngritur dhe funksionon koordinatori i programit të studimit (KPS), për çdo program studimi të ofruar nga departamenti dhe që ka për detyrë të merret me organizimin dhe menaxhimin e programeve të studimit. Kordinatori i programit të studimit (KPS), është përgjegjës për hartimin e draft-propozimit të një program të ri studimi, rishikimin dhe përmirësimin e programeve ekzistuese, përgatitjen e raporteve të analizës vjetore të programit të studimit dhe për mbështetjen e procesit të sigurimit të cilësisë. Gjithashtu KPS ka për detyrë të raportojë në departamentin përgjegjës për të gjitha propozimet për përmirësimin e programit të studimit. DSBC dhe DK në bashkëpunim me fakultetet koordinojnë punën me departamentin, për përmirësimin e</p>

	<p>cilësisë së mësimdhënies, standartit të përgatitjes së planeve mësimore, syllabuseve të lëndëve si dhe të gjithë dokumentacionit të programeve të studimit. Përgjegjësit e Departamenteve komunikojnë me Zëvendës dekanin për anën mësimore dhe me Zëvendës dekanin për anën kërkimore shkencore, për të koordinuar dhe planifikuar raportimet e punës mësimore dhe kërkimore. Këto rezultate pasqyrohen në Raportet Vjetore të Njësisë Kryesore bazuar në raportet vjetore të Njësisë Bazë. Komisioni i Mësimit i SAUPT analizon dosjen dhe raporton pranë senatit në lidhje me shkallën e plotësimit të standardeve të cilësisë të programit të studimit të rishikuar. Më pas Senati shprehet me vendim për miratim ose jo të ndryshimeve të propozuara.</p> <p><b>Ref. 6.05: Praktika për riorganizimin dhe rishikimin e Programeve të studimit</b></p> <p><b>Ref. 4.16: Raport i aktivitetit mësimor (në nivel njësisë dhe universiteti)</b></p> <p><b>Ref. 4.17: Raport i aktivitetit kërkimor shkencor (në nivel njësisë dhe universiteti)</b></p> <p><b>Ref. 6.03: Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b></p> <p><b>Ref. 6.04: Këshillat e Programeve të Studimit dhe Koordinatorët</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>Në lidhje me mekanizmat që përdor FIM/DTM për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, do të listonim si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Miratimi i planeve mësimore nga zyra e kurrikulave, pasi janë dërguar nga departamenti. Në rastin kur Zyra e kurrikulave ka vërejtje, ato duhen pasqyruar nga departamenti/njësia bazë. (Ref. 1.17: Plani mësimor);</li> <li>- Hartimi i raporteve vjetore mbi veprimtarinë akademike, nga njësitë bazë dhe kryesore të UPT. Në këto raporte evidentohen arritjet dhe problematikat duke u mbështetur në statutin e UPT (Ref. 1.01: Statuti i UPT), (Ref. 4.16: Raporti i aktivitetit mësimor (në nivel njësisë dhe universitetit), (Ref. 4.17: Raporti i aktivitetit kërkimor shkencor (në nivel njësisë dhe universiteti). Këto raporte vendosen në dispozicion të programeve të studimit dhe grupeve kërkimore. Raporti i veprimtarisë akademike të brendshme dhe të jashtme të UPT diskutohet dhe miratohet në Senatin Akademik të UPT. Më pas, raporti përfundimtar paraqitet në ministrinë MASR, e cila është përgjegjëse për Arsimin e Lartë, dhe bëhet publik.</li> <li>- Planifikimi i përgatitjes së raportit vjetor mësimor-kërkimor, analiza e programeve të studimit dhe kurrikulave, përmirësimi i tyre në masën 20%, analiza e programeve lëndore dhe përmirësimi i tyre, përmirësimi i dokumentacionit të unifikuar i instrumentave të vlerësimit dhe i sigurimit të cilësisë, etj., është pjesë e punës që kryhet rregullisht nga DTM, në kuadër të shqyrtimit, miratimit dhe mbikëqyrjes herëpashershme të programeve të studimit në nivelin BSc.</li> <li>- Hartimi dhe plotësimi i pyetësorit për studentët, në lidhje me cilësinë</li> </ul>

	<p>e mësidhënies, është një tjetër mekanizëm që UPT përdor në lidhje me shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e programeve të studimit. Pyetësori realizohet për lëndët e çdo program studimi, në fund të çdo semestri, përpara sezonit të provimeve. Rezultatet e pyetësorit shërbejnë për të hartuar dhe zbatuar një plan masash për përmirësimin e mëtejshëm të programeve të mësimore.</p> <p><b>Ref. 5.01: Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b></p> <p><b>Ref. 4.16: Raporti i aktivitetit mësimor (në nivel njësisish dhe uniersiteti</b></p> <p><b>Ref. 4.17: Raport i aktivitetit kërkimor shkencor (në nivel njësisish dhe universiteti</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Strukturat përgjegjëse për të garantuar standardet e cilësisë të institucionit dhe programeve të studimit janë DSBC dhe DK, të ngarkuara nga Senati Akademik. (<b>Ref. 1.16: Organigrama e FIM.</b> Është pikërisht DSBC që përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për mbarëvajtjen e programeve të studimit. (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>). DSBC dhe DK bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë punën me njësitë bazë për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel njësie kryesore. Njësia kryesore, FIM, organizon në mënyrë periodike plotësimin e pyetësorëve nga studentët, në mënyrë që të bëjnë vlerësimin e lëndëve të programit. Këta pyetësorë shërbejnë si instrumenta të rëndësishëm për njësitë kryesore dhe ato bazë, për përmirësimin e mëtejshëm të veprimtarisë akademike dhe programeve mësimore, aty ky shihet e nevojshme. (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>) raport mbi anketimin studentor “cilësia e mësimdhënies online” sem ii 2019-2020</p> <p>raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2019-2020 (sem i)</p> <p>raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2018-2019 (sem i)</p> <p>raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2018-2019 (sem ii)</p> <p>raport mbi anketimin studentor për vitin akademik 2017-2018 (sem ii)</p> <p>Kordinatori i programit të studimit (KPS) analizon elementet si: Mbulimi me materiale studimore, realizimi i formave të kontrollit të vazhdueshëm dhe prvimit përfundimtar të lëndëve, realizimi i praktikave profesionale, realizimi i punimeve të diplomave, dhe më pas bën propozimet për ndryshimet përkatëse. Për të realizuar analizën, KPS mbështetet edhe në sygjërimet e stafit mësimdhënës, anketimet e studentëve, si dhe në të dhëna të tjera nga sekretaria mësimore. Raportet e hartuara nga KPS, shqyrtohen nga DTM dhe përcillen në Dekanat raportin e analizës mësimore të departamentit. (Ref. 1.21: Analiza vjetore mësimore-kërkimore e DTM). Raportin e analizës mësimore të fakultetit e harton Dekani dhe e përcjell në rektorat. Duke u mbështetur në këto raporte, senati akademik harton raportin e punës mësimore të UPT, të cilin e miraton në mbledhje. Raporti, së bashku me analizën e punës kërkimore dhe atë financiare përcillen në MASR.</p> <p><b>(Ref. 4.16: Raport i aktivitetit mësimor (në nivel njësisish dhe universiteti).</b></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Raportet e hartuara nga DTM, në fund të çdo viti akademik, përdoren për hartimin e raporteteve në nivel fakulteti. Këto raporte përmbajnë vlerësimin e mbarëvajtjes së programeve të studimit dhe elementët matës si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Numri i studentëve të regjistruar për çdo vit akademik;</li> <li>- Numri i studentëve të diplomuar për çdo vit akademik;</li> <li>- Studentë të shkëlqyer;</li> <li>- Student të ç' regjistruar;</li> <li>- Plotësimi i standardeve të stafit akademik (artikuj të botuar, pjesëmarrja në konferenca, projekte, etj.;</li> <li>- Sponsorizimet për konferencat dhe artikujt;</li> <li>- Përmirësimi i standardeve të ambjenteve (didaktikës laboratorike, përmirësimi i strukturës laboratorike);</li> <li>- Përqindja e kalueshmërisë;</li> <li>- Përqindja e të diplomuarve;</li> <li>- Ngarkesa mësimore e stafit akademik.</li> </ul> <p>Gjithashtu, Drejtoria e Kurrikulës verifikon përputhshmërinë e programit të studimit të rishikuar me standartet e cilësisë dhe dokumentacionin shoqërues të propozimit për ndryshim. Më pas DK harton një raport Teknik në lidhje me mangësitë e konstatuara, i cili i përcillet senatit akademik për shqyrtim dhe miratim. Analizën e dosjes dhe raportimin pranë senatit, në lidhje me shkallën e plotësimit të standardeve të cilësisë së programit të rishikuar e bën Komisioni i Mësimit i SAUPT. Është pikërisht senati që miraton ose jo ndryshimet e propozuara. (Ref. 6.05: Praktika për riorganizimin dhe rishikimin e Programeve të studimit).</p> <p>Anketimi semestral studentor mbi cilësinë e mësimdhënies, kryhet rregullisht nga DSBC, ku studentët plotësojnë pyetësorët për çdo pedagog. Rezultatet e pyetësorëve përcillen te Rektori të shoqëruara me një analizë statistikore mbi indikatorët. Në bazë të rezultateve individuale nga personeli akademik, hartohen analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Analizat e bëra përmbledhen në një raport dhe përcillen në njësitë kryesore dhe ato bazë për të vijuar punën në përmirësimin e cilësisë. Raportet janë të aksesueshme online.</p> <p><a href="https://www.upt.al/cilesia-nc-upt">https://www.upt.al/cilesia-nc-upt</a></p> <p><a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.</p>	<p>Raportet vjetore të vlerësimit të veprimtarisë së brendshme dhe të jashtme (mësimore dhe kërkimore shkencore), të hartuara nga të hartuara nga të gjitha njësitë kryesore të UPT, evidentojnë arritjet dhe problematikat. Kjo duke u mbështetur në Statutin e UPT. (Ref. 1.01: Statuti i UPT). Raportet mbi veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore të çdo njësie bazë dhe kryesore, vendosen në dispozicion të këshillave respective të programeve të studimit dhe grupeve kërkimore, prej të cilave dalin përfundimet dhe vendimet që dërgohen në rektorat. Në bazë të tyre hartohet raporti i veprimtarisë akademike të brendshme dhe të jashtme të UPT. Raporti vendoset në dispozicion të Senatit të</p>

	<p>UPT, i cili pasi e diskuton merr vendimin merr vendimin miratues dhe e paraqet atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Raportet vjetore në nivel fakulteti dhe raportet analitike të pyetësorëve të hartuara nga DSBC dhe DK, përfshijnë rezultatet e pritshme dhe ato të vlerësimit. Gjithashtu në këto raporte adresohen edhe mangësitë dhe përmirësimi në vijim i cilësisë së programeve. Raportet vjetore bëhen të njohura nga DSBC dhe DK.</p> <p>(<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>)  (<a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>)</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3	
Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>Pjesë e vlerësimit të brendshëm të programit të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të gjitha raportet vjetore që hartohen në nivel fakulteti;</li> <li>- raport analizat e përvitshme të pyetësorëve të hartuara dhe të realizuara nga DSBC dhe DK</li> <li>- raportet vjetore të të DSBC të cilat bëhen publike në faqen elektronike të UPT</li> </ul> <p>Këtë informacion, institucioni e ka përfshirë në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit, ashtu edhe në vetëvlerësimet e brendshme periodike.</p> <p><b>Ref. 3.05: Raportet vjetore të DTM</b>  <b>Ref. 4.16: Raporti i aktivitetit mësimor (në nivel njësisht dhe univeristëti</b>  <b>Ref. 4.17: Raporti i aktivitetit kërkimor shkencor (në nivel njësisht dhe universiteti</b>  (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>)  (<a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të akreditimit të UPT, grupi i punës i Vlerësimit të Brendshëm ka hartuar raportet e vetëvlerësimit, që kanë shërbyer si një burim i rëndësishëm informacioni për të gjitha strukturat institucionale të angazhuara në përmirësimin e cilësisë. Pjesë e instrumentave, për kryerjen e vlerësimit të përdorura janë edhe anketimet semestrale studentore të kryera nga DSBC dhe DK. Gjithashtu për kryerjen e vlerësimit, janë përdorur metoda në përshtatje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të prgramit të studimit, siç është metoda sasiore dhe cilësore nëpërmjet instrumentit të pyetësorit. Pyetësori plotësohet nga çdo student për secalin pedagog duke dhënë indikatorë të perceptimit të performancës së tyre nga studentët. Këto rezultate të pyetësorit për çdo pedagog i</p>

	<p>përcillen Rektorit së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët. Mbi këto rezultate individuale të personelit akademik, hartohet analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Të gjitha këto instrumenta përdoren për vlerësimin dhe përmirësimin e programeve të studimit të ofruara nga Institucioni I Arsimit të Lartë, në këtë rast UPT.</p> <p>(<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>)</p> <p>(<a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes dhe cilësisë së programit të studimit, FIM dhe DTM, përdor këto metoda:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- hartimin e raporteve vjetore për çdo vit akademik, në të cilat pasqyrohet veprimtaria institucionale, analiza e procesit mësimor dhe kërkimit shkencor me të gjitha komponentët përbërës. (Ref. 4.16: Raporti i aktivitetit mësimor (në nivel njësisish dhe univeristëti), (Ref. 4.17: Raporti i aktivitetit kërkimor shkencor (në nivel njësisish dhe universiteti)</li> <li>- Rishikimet dhe ndryshimet e planeve mësimore në masën 20%. (Ref. 4.16: Raporti i aktivitetit mësimor (në nivel njësisish dhe univeristëti), <b>(Ref. 4.17: Raporti i aktivitetit kërkimor shkencor (në nivel njësisish dhe universiteti)</b>)</li> <li>- Kontrolltet mbi zhvillimin e procesit mësimor të ushtruara nga Dekani. <b>(Ref. 6.07: Rregullore e sekretarisë mësimore e FIM)</b></li> <li>- Hartimi dhe realizimi i pyetësorëve të përvitshëm të studentëve dhe analizës përkatëse. (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>) (<a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>)</li> <li>- Mbikqyrja dhe monitorimi i respektimit të programeve të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe veprimtarive të tjera, nga titullarët e grup-lëndëve të njësisive bazë në bashkëpunim me përgjegjësit e departamenteve. Për këtë, ata ndjekin veprimtaritë mësimore dhe shkencore të stafit akademik, ndihmës-akademik, vëzhgojnë studentët gjatë zhvillimit të seancave laboratorike, detyrave të ndryshme mësimore apo edhe testimeve gjatë vitit akademik.</li> <li>- Praktika e mbrojtjes së diplomave nëpërmjet punës kërkimore shkencore të studentëve, është një praktikë e mirë dhe e konsoliduar për të matur dhe vlerësuar cilësinë e udhëheqjes dhe të arritjes së rezultateve. Mbrojtja zhvillohet përpara një komisioni të përbërë nga tre deri në pesë anëtarë.</li> </ul> <p><b>Ref. 2.10: Procedura FIM-P006_Konceptimi dhe mbrojtja e diplomës për programet e ciklit të parë të studimeve në FIM)</b></p> <p><b>Ref. 4.02: Ndarja e grupeve mësimore në DTM</b></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Në kuadër të vlerësimin të realizimit, mbarëvajtjes së cilësisë së programit të studimit, UPT/FIM përdor metoda dhe instrumente të tërthorta. Për këtë shërben ngritja e mekanizmave institucionale për komunikim me studentët dhe për të asistuar në veprimtarinë e tyre siç janë Zyra e Karrierës dhe</p>

<p>përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Alumni në Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit, të cilat duket të kenë përmirësuar ndjeshëm përcjelljen e informacionit të studentët, si dhe veprimtaritë që zhvillohen në kuadër të promovimit të karrierës së tyre. (Ref. 1.16: Organigrama e FIM). Ngritja e rrjetit Alumni, filloi nëpërmjet një pyetësori për identifikimin dhe mbledhjen e të dhënave në lidhje me punësimin dhe karrierën e tyre profesionale. Si rrjedhojë, UPT ka krijuar një databazë me mbi 200 të diplomuar, që kanë shprehur interesin të jenë pjesë e rrjetit Alumni. Të diplomuarit i përkasin periudhës kohore 2002-2019 dhe janë të punësuar në masën 88%. 78% e numrit total të të anketuarve punojnë sot në profesionin e tyre. 57% e të anketuarve janë punësuar për herë të parë pa mbaruar studimet. Ndërsa 36% e tyre janë punësuar vitin e parë që kanë mbaruar studimet. Identifikimi i partnerëve potencialë dhe lidhja e marrëveshjeve të bashkëpunimit me ta, ka sjellë afrimin e UPT me tregun e punës dhe identifikimin e nevojave të këtij tregu në lidhje me programet e studimit të ofruara. Organizimi dhe realizimi i panairëve të punës në UPT dhe pjesëmarrja e shumë kompanive, por edhe pjesëmarrja në panairë të tjera i ka shërbyer intensifikimit dhe strukturimit të marrëdhënieve me tregun e punës. Pjesëmarrja e UPT në projektin GRADUA ka krijuar një database të rëndësishme të studentëve dhe kompanive. Studentët regjistrohen dhe publikojnë CV në këtë database, duke rritur kështu më shumë mundësinë e punësimit. Specialisti i karrierës dhe Alumnit në FIM, ka për qëllim forcimin e lidhjeve dhe krijimin e një rrjeti me të diplomuarit në fushat që mbulon FIM. Shoqata Alumni në FIM u krijua më 26 maj 2021(Alumn/ae Inxhinjeria Mekanike). <a href="https://fim.edu.al/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim">https://fim.edu.al/alumniae-inxhinjeria-mekanike-aim</a>. <b>Ref. 1.13: Marrëveshje UPT-PEA</b> <b>Ref. 1.24: Marrëveshje të UPT</b></p>		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
			X

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në statutin e UPT, parashikohet përfshirja e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm për sigurimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit. (Ref. 1.01: Statuti i UPT), (Ref. 1.02: Plani strategjik i UPT). Në statut parashikohen gjithashtu, të gjitha procedurat, përgjegjësitë dhe detyrat për kontrollin dhe sigurimin e cilësisë: - Neni 9 Senati Akademik i UPT – vlerëson, garanton dhe mban përgjegjësi për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UPT. n) miraton standardet institucionale të cilësisë; - Neni 13 Dekanati/Drejtoria e Institutit të Kërkim-zhvillimit –</p>

	<p>shqyrton programet e reja të studimit, të propozuaranga njësitë bazë, për përputhshmërinë e tyre me standardet e cilësisë dhe i dërgon për miratim në Senatin Akademik të UPT;</p> <p>- Neni 53 Ciklet dhe programet e studimeve – Programet e studimeve hartohen nga njësitë bazë të UPT dhe miratohen në Senatin Akademik të UPT, pasi kanë kaluar në procesin e vlerësimit të cilësisë së hartimit/riorganizimit të kurrikulës, në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë, misionit dhe strategjisë së UPT.</p> <p>Në këto dokumenta përcaktohen qartë përgjegjësitë dhe detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p>Pedagogët në UPT/FIM janë jo vetëm realizues së procesit mësimor, por janë edhe një faktor i rëndësishëm për rritjen e nivelit të cilësisë, nëpërmjet angazhimit të tyre në përpunimin e rregulloreve dhe standarteve të cilësisë.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në lidhje me sigurimin e brendshëm të cilësisë, UPT ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike të brendshme me qëllim përmirësimin e vzhdueshëm të cilësisë së programeve të studimeve që ofron. Në Statutin e UPT përshkruhen qartë procedurat e posaçme për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit që ofrohen. Gjithashtu UPT përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programeve të studimit. Studentët janë angazhuar në sigurimin e brendshëm të cilësisë duke qenë pjesë si e komisioneve në vlerësimin e programeve akademike dhe në vlerësimin institucional si pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm, ashtu edhe në krijimin e KPS e po ashtu funksionet e KPS dhe detyrat e Koordinatorit të programit të studimit, detyrat konkrete për njësitë, individët, studentët, pedagogët dhe palë të tjera të angazhuara për garantimin e cilësisë së programit të studimit përcaktohen në Rregulloren e zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies, në Rregulloren e brendshme të FIM si dhe në Rregulloren e DTM për programin e studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode.</p> <p><b>Ref. 1.08: Rregullorja e programit të studimit BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode</b></p> <p><b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b></p> <p><b>Ref. 6.03: Rregullorja e zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b></p> <p><b>Ref. 1.01: Statuti i UPT).</b></p> <p><b>Ref. 5.17: Urdhër i brendshëm Nr. 40 datë 28.03.2022 “Për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit BSc ne FIM</b></p> <p><b>Ref. 6.06: Vendimi Nr. 2.</b></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe</p>	<p>DTM është e përfshirë në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Përfaqësuesit e DTM janë të angazhuar si anëtarë të komisioneve, si në vlerësimin institucional si pjesë e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm ashtu edhe në krijimin e Këshillave të</p>



<p>kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>programeve të studimit që ofrohen. Për të garantuar dhe siguruar cilësinë e programeve të ciklit të parë dhe të dytë të studimit në nivel FIM, është ngritur zyra e karrierës, ku specialistja merret me sigurimin e cilësisë në FIM. Studentët përfshihen në procesin /systemin e sigurimit të cilësisë së programit mësimor nëpërmjet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Anketimeve periodike Nga DSBC;</li> <li>- Marrjes së mendimeve dhe propozimeve nga Këshilli studentor;</li> <li>- Takimeve me tutorët e programit BSc në Inxhinjeri Tekstili e Mode.</li> </ul>
<p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Në kuadër të respektimit të integritetit akademik dhe të shmangjes së çdo lloj diskriminimi apo pabarazie, gjatë procesit të sigurimit të cilësisë nëpërmjet strukturave përkatëse me qëllim vlerësimin e programeve të studimit, UPT respekton lirinë dhe etikën akademike duke u mbështetur edhe në Ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. UPT garanton ruajtjen e konfidencialitetit të studentëve duke ruajtur anonim emrin e tyre në anketimet e bëra gjatë vlerësimit të cilësisë së programit të studimit. Anketimi kryhet nëpërmjet përdorimit të sistemit PITAGORA me numrin e identifikimit që kamë çdo student. Kontrolli i procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies ka garantuar barazinë e plotë midis anëtarëve të stafit akademik si dhe midis studentëve. Respektimi i integritetit akademik nga institucioni u pohua si nga anëtarët e stafit akademik ashtu edhe nga studentët, në takimet gjatë vizitës së Grupit të punës së Vlerësimit të Jstëm. Në FIM dhe DTM nuk ka ndonjë praktikë ankimi nga ana e studentëve apo e stafit akademik, ndihmës akademik, administrative, në lidhje me diskriminimin apo pabarazinë.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Në kuadër të përmirësimit të programeve të studimit dhe rritjes së cilësisë dhe përshtatjes së tyre me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës, UPT konsideron si bashkëpunëtorë edhe ekspertë të jashtëm për të dhënë ekspertizën e tyre konkrete. Në lidhje me këtë një rol të madh luan edhe organizimi nga UPT, FIM i Panairit të Punës në të cilin morrën pjesë rreth 30 kompani të cilat paraqitën edhe ofertën e tyre për bashkëpunim, punësim dhe realizimin e praktikave profesionale. Një panair tjetër ku UPT ka marrë pjesë, është edhe ai Eëork and Study 2020, organizuar nga Dhoma e Tregëtisë dhe Industrisë dhe në Panairin e Ndërtimit, Arkitekturës dhe Planifikimit Urban 2018 Këto panairë vijnë në ndihmë të studentëve duke sjellë më afër dhe në mënyrë më konkrete tregun e punës, për ta parë atë si një mundësi punësimi apo internshipi për të fituar një eksperiencë në aftësitë praktike. Kompanitë private apo subjektet publike, që marrin pjesë në këto panairë japin edhe ekspertizën dhe mendimin e tyre në lidhje me cilësinë e programit apo përmirësimit të tij. Ekspertiza e bashkëpunëtorëve të DTM, nga industria apo ekspertë të jashtëm ka qenë e vlefshme më së shumti në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies në aspektet e lidhjes së teorisë me praktikën. Ekspertët janë ftuar nga DTM, jo vetëm në mësimdhënie por edhe në takime e biseda të ndryshme, leksione të hapura ose eëorkshope, etj. (Ref. 1.14: Vepërimtaritë e zyrës së karrierës). (Ref. 2.08: Mobilitetet Erasmus të stafit të huaj),</p>


	(Ref. 3.10: Leksione të hapura), (Ref. 2.11: Konferenca Ndërkombëtare të Tekstilit_DTM).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5	
Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>UPT dhe FIM, në kuadër të sistemit të Sigurimit të brendshëm të cilësisë së programeve të studimit, bën transparente dhe publike si për studentët dhe për të gjithë të interesuarit, të gjitha politikat, strategjitë dhe veprimtaritë. Këtë e shohim të sanksionuar në Planin Strategjik të UPT. UPT gjithashtu ka krijuar programin e transparencës, (<a href="https://www.upt.al/images/stories/phd/scan-20151110093432-0000.compressed.pdf">https://www.upt.al/images/stories/phd/scan-20151110093432-0000.compressed.pdf</a>) që mundëson publikimin nëpërmjet postimeve në faqen zyrtare të UPT/FIM, në të cilën gjendet Analiza e Pyetësorëve. (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>) (<a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>)</p> <p>Kjo transparencë pasqyrohet edhe nëpërmjet Statutit, Rregulloreve, apo edhe nëpërmjet shkresave zyrtare tek të gjitha Njësitë Bazë duke krijuar kështu një institucion të hapur për të gjithë aktorët e brendshëm e të jashtëm. <b>Ref. 1.01: Statuti i UPT</b> <b>Ref. 1.04: Rregullorja e UPT</b> <b>Ref. 1.06: Rregullorja e FIM</b> <b>Ref. 1.02: Plani strategjik i UPT</b></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>UPT publikon, në faqen zyrtare, rezultatet e vlerësimeve të programeve të studimit, të cilat janë përpiluar në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 531 datë 11.09.2018 “Për Miratimin e Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”. Gjithashtu ky informacion i publikuar në raporte, respekton lirinë dhe etikën akademike duke u mbështetur në Ligjin Nr. 9887 datë 10.03.2008, ndryshuar në Ligjin Nr. 48/2012 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>) (<a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>)</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash të tilla si: Anketimet semestrale me studentët mbi cilësinë e mësimdhënies të kryera rregullisht nga DSBC, që nga 2018 dhe rezultatet e pyetësorit për çdo pedagog i përcillen Rektorit, së bashku me një analizë statistikore mbi indikatorët. Në bazë të rezultateve individuale të personelit akademik, hartohet edhe analiza për të evidentuar pikat e forta dhe problematikat specifike në çdo program studimi. Analizat e bëra përmblidhen në formë raporti dhe i përcillen njësisë keyesore dhe atyre</p>

	<p>bazë për të zhvilluar analiza të mëtejshme, në mënyrë që të vijohet puna me përmirësimin e cilësisë. Ndërsa rezultatet e vlerësimit të pyetësorëve janë të shoqëruara me planin e masave që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangasive dhe dobësive të evidentuara. Raportet janë publike dhe të aksesueshme në: (<a href="https://www.upt.al/cilesia-ne-upt">https://www.upt.al/cilesia-ne-upt</a>) (<a href="https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf">https://upt.al/images/stories/ngjarje/RAPORTI%20I%20ANKETIMIT%202019-2020%20(SEM%20II).pdf</a>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Ndër objektivat kryesorë të UPT është përmirësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit, kjo e shprehur qartë edhe në planin strategjik të tij. Për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në programet e studimit, DTM parashikon nevojat për pajisje të reja laboratorike, forcimin e lidhjeve me biznesin dhe industrinë në mënyrë që studentët të kryejnë praktikatat profesionale, rishikimin e orëve laboratorike për lëndët me karakter praktik, etj. Ky plan siguron efektivitet për cilësinë e mësimdhënies në lëndët e çdo program studimi që ofron.</p> <p>KPS dhe Koordinatorin e programit të studimit, kanë për detyrë të merren me organizimin dhe menaxhimin e programeve të studimit. Ndër funksionet kryesore të KPS është rishikimi i programit të studimit i cili mbështetet në këto pika si: në nevojat e tregut të punës, zhvillimet në rajon dhe në botë, tendencat e zhvillimit të programeve të studimit të ngjashme në Europë apo edhe më tej., propozimet për përmirësim nga stafi akademik, analizën e procesit mësimor, anketimet e studentëve, ndryshimet në infrastrukturën laboratorike, rezultatet e projekteve të ndryshme të mbështetura nga Bashkimi Europian ose nga vende të tjera, kërkesa që vijnë nga biznesi ose nga qeveria, kërkesat e tregut të punës, etj. KPS më pas raporton në departament për të gjitha gjetjet dhe propozimet për përmirësimin e programit të studimit. Gjithashtu DSBC dhe DK, nëpërmjet fakulteteve koordinojnë punën me departamentet për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.</p> <p><b>Ref. 3.05: Raportet vjetore të DTM</b>  <b>Ref. 4. 16: Raport i aktivitetit mësimor (në nivel njësisht dhe universiteti)</b>  <b>Ref. 6.03: Rregullorja e Zhvillimit Kurrikular dhe Mësimdhënies e UPT</b>  <b>Ref. 6.04: Këshillat e Programeve të Studimit dhe Koordinatorët</b>  <b>Ref. 1.02: Plani strategjik i UPT.</b></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Në kuadër të sigurimit dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit, DSBC dhe DK organizojnë aktivitete dhe leksione informuese me personelin akademik dhe studentët në bashkëpunim me Këshillin studentor, të cilat synojnë ndërgjegjësimin e studentëve mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së tyre në procesin e përmirësimin të cilësisë së programeve të studimit dhe shërbimeve administrative që ata marrin në universitet. DSBC organizon trajnime dhe takime me punonjësit e NJSC-ve në fakultete, siç janë takimet e zhvilluara me ASCAL. Takime me studentët janë realizuar edhe nga NJSC të e fakulteteve, në kuadër të realizimit të anketimit semestral.</p> <p>Disa prej trajnimeve të organizuara nga personeli i DSBC janë:</p>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Trajnime pranë ASCAL (organizuar nga ASCAL);</li> <li>- Trajnime në universitetet partnere (në programet e trajnimit në kuadër të Erasmus+ apo vizitave të punës)</li> </ul> <p>Në kuadër të procesit të akreditimit, DSBC ka trajnuar individualisht edhe në grup specialistët e NJSC-ve në fakultete mbi procesin e akreditimit dhe mbi realizimin e anketimit studentor.</p> <p>Me studentët DSBC ka kontaktuar përmes email-eve, në kuadër të anketimit studentor dhe përmes përfaqësuesve të studentëve në çdo fakultet (për realizimin e sondazhit kombëtar të studentëve) (<a href="https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/897-njoftim-mbi-zhvillimin-e-sondazhit-kombetar-te-studenteve">https://www.upt.al/bashkepunime/aktivitete/897-njoftim-mbi-zhvillimin-e-sondazhit-kombetar-te-studenteve</a>)</p> <p><b>Ref. 6.09: Trajnime nga DSCB për grupet e punës për akreditimin</b> <b>Ref. 6.10: Njoftime për studentët.</b> <b>(Ref. 6.08: Takime infomuese të zhvilluara nga ASCAL)</b></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor “Inxhinieri Tekstile e Modë” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti Politeknik i Tiranës”**

**Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Gjatë gjithë historisë së tij DTM ka patur vetëm ngritje përsa i përket organizimit strukturor, potencialeve njerëzore dhe atyre drejtuese kjo si rezultat i plotësimit të të gjitha kriterëve të vendosura nga Ligji i Arsimit të Lartë për organizimin strukturor të një institucioni të Arsimit të Lartë. Organizimi i studimeve në FIM (cikli i parë, cikli i dytë dhe cikli i tretë), në përputhje të plotë me Ligjin e Arsimit të Lartë, mbyll ciklin e plotë të shkollimit të studentëve, duke përgatitur specialistë me kualifikime të ndryshme në fushat inxhinierike, nga niveli bachelor deri në nivelin e doktoraturës.
2. Niveli i kualifikimit të stafit akademik efektiv si dhe eksperiencia e gjatë në mësimdhënie është një pikë mjaft e fortë që garanton implementimin me sukses të programeve të studimit në të gjitha ciklet e studimit.
3. Kërkimi shkencor, pjesëmarrja në projekte kërkimore, organizimi i shkollës së doktoraturës, etj., garanton pjesëmarrjen dhe aftësimin e pedagogëve në procesin e kërkimit shkencor, angazhimin e tyre sa më të gjerë në botime e studime shkencore, organizimin periodik të konferencave shkencore, botimin e monografive, artikujve shkencorë, teksteve mësimore apo studimeve të realizuara nga pedagogët, etj.
4. Laboratori i akredituar i tekstit, konsulencat ndaj biznesit si dhe trajnimet/përditësimi i njohurive që organizohen nga DTM, FIM për të tretë, janë ura lidhjeje dhe bashkëpunimi ndërmjet departamentit, FIM dhe biznesit e komunitetit, ndaj të cilës kontributi i stafit është i madh. Institucioni ka laboratorë të ndryshëm që impaktojnë më së miri në zhvillimin e lëndëve laboratorike, si dhe përfitim të njohurive teorike nëpërmjet praktikës.


**Pika të dobëta:**

1. Mungesa e database të mëparshëm për punësimin e studentëve të diplomuar (gjurmimi i studenteve të diplomuar) në vite tregon se ruajtja e lidhjeve me këtë masë të madhe specialistësh është kryer mbi baza sporadike, njohjesh personale apo edhe rastësore në bazë departamenti, gjë që ka krijuar vështirësi për të patur një perceptim më të plotë të punësimit të studentëve gjatë viteve. **(Standarti II.4, pika 8)**
2. Mosndjekja e tregut të punës dhe e tendencës së zhvillimit të arsimit të lartë në Shqipëri, rajon e më gjerë, dhe mosreflektimi i ndryshimeve në filozofinë, strategjinë, menaxhimin e institucionit, kurrikulat, programet e lëndëve, dhe gjithë dokumentacionin ku mbështetet veprimtaria e departamentit dhe FIM, rrezikon të vendosë në vështirësi rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të programit. **(Standardi I.3, kriteri 2)**

3. Ndonëse se infrastruktura në dispozicion të FIM siguron kushte të duhura pune për studentët dhe pedagogët, përsëri hapësirat në mjediset e fakultetit që i takonin një studentit kanë qenë shumë më të vogla se ato që garantohej në raport nga universitetet homologe jashtë. Rikonstruksioni i godinës së FIM, që ka përfunduar këtë vit, ka sjellë përmirësime në lidhje me hapësirën e vënë në dispozicion të programit të studimit. (Standardi III.3, kriteri 7)

#### **Rekomandime:**

1. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, institucioni ka kryer një studim të tregut të punës që në fillimet e tij, por jo në mënyrë specifike, gjë që është paraqitur dhe në pikat e dobëta të programit. Nisur nga kjo, GVJ rekomandon krijimin e një Bordi të tregut të Punës, me anëtarë nga biznese, studiues, dizajner, antropologë, gjë që do ndihmonte të merrte një feedback nga nevojat e tregut dhe sfidat e reja.
2. Pavarësisht se përdorimi i metodave të reja, inovative që përdoren në këtë program studimi, GVJ rekomandon Design thinking jo vetëm si metodologji të mësuarit, një strategji, një metodë për të kuptuar konsumatorin e tregun. Për këtë GVJ rekomandon krijimin e lidhjet e bashkëpunimeve me institucione, apo trajnime ose ëorkshope në fusha të dizajnit, të cilat do të mundësonin tek studentët një qasje më inovative drejt nevojave, trendeve të reja të tregut, me një fokus të orientuar drejt target grupeve të caktuara.
3. GVJ, rekomandon mbulimin e të gjitha disiplinave me tekste bazë, në gjuhën shqipe, pasi sic është paraqitur dhe në GVB, jo të gjitha lëndët kanë literaturë bazë në gjuhën shqipe.





**Conclusions of the Evaluation of the first cycle Bachelor's study program "Textile and Fashion Engineering" of the Higher Education Institution "Polytechnic University of Tirana"**

**Strengths and Affirmations:**

1. Throughout its history, DTM has been grown in terms of structural organization, of human and leadership potentials, because of meeting all the criteria set by the Law on Higher Education. The organization of studies at FIM (first cycle, second cycle and third cycle), in full accordance with the Law on Higher Education, encompasses the full cycle of students' education, preparing specialists with various qualifications in engineering fields, from bachelor level to doctoral level.
2. The level of qualification of the effective academic staff as well as the long experience in teaching is a strong point that guarantees the successful implementation of study programs in all study cycles.
3. Scientific research, participation in research projects, organization of doctoral school, etc., guarantees the participation and training of lecturers in the process of scientific research, and their engagement as widely as possible in publications and scientific studies, scientific conferences, publication of monographs, scientific articles, textbooks or studies carried out by lecturers, etc.
4. The accredited textile laboratory, business consultancy as well as training/updating of knowledge organized by DTM, FIM for the third, are the bridge of connection and cooperation between the department, FIM and the business of the community, to which the contribution of the staff is big. The institution has different laboratories that have the best impact on the development of laboratory subjects, as well as the acquisition of theoretical knowledge through practice.

**Weak points:**


1. The lack of a previous database for the employment of graduate students (tracking of graduate students) over the years shows that the maintenance of connections with the large number of students was carried out on a sporadic basis, personal acquaintances or even casual on a departmental basis, which has created difficulties to have a more complete perception of student employment over the years. **(Standard II.4, point 8)**
2. The lack of the tracking the labor market and the development trend of higher education in Albania, in the region and beyond, and not reflecting the changes in the philosophy, strategy, management of the institution, curricula, course programs, risks putting the further growth and development of the program into difficulties. **(Standard I.3, criterion 2)**
3. Although the infrastructure available at FIM provides adequate working conditions for students and lecturers, again the spaces in the faculty premises belonging to a student have been much smaller than those guaranteed in the report by counterpart universities abroad. The



reconstruction of the FIM building, which was completed this year, has brought about improvements regarding the space made available to the study program. (**Standard III.3, criterion 7**)

**Recommendations:**

1. Based on the presented documentation, the institution has conducted an empirical study of the labor market since its beginnings, but not a detailed analysis, which is also presented in the weak points of the program. Based on this, the commission of external evaluation recommends the creation of a Labor Market Board, with members from businesses, researchers, designers, anthropologists, which would help to receive feedback from market needs and new challenges.
2. Despite the use of new, innovative methods used in this study program, commission of external evaluation, recommends Design thinking method not only as a learning method, and as a strategy, to understand the consumer and the market. For this, it is recommended the creation of cooperation links with institutions, or trainings or workshops in the field of design, which would enable students to have a more innovative approach to the needs, new market trends, with a focus oriented towards various target groups.
3. The commission of external evaluation recommends covering all disciplines with basic texts, in the Albanian language, since, as it is resented in the GVB, not all subjects have basic literature in the Albanian language.





Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X

*Handwritten signature*

*Handwritten signature*

